

Tetor 2012
Numri: 55
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 150 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den



AI

ËSHTË ME TY, TI ME KË JE?





Editorial

Nuk ka dyshim se njeriu jeton në këtë botë dhe krijon një sërë lidhjesh dhe marrëdhëniesh të domosdoshme...

Ai krijon marrëdhënie me organet e tij të trupit, me njerëzit e tjerë dhe me objektet e tjera...

Madje, disa prej këtyre lidhjeve, me kalimin e kohës shndërrohen në lidhje shumë jetike për të.

Një pikë uji, kur e ka kapluar etja, një rrishtë bukë, kur është i uritur, çdo gjë që i fal shpresën e shpëtimit në një moment kur i bëjnë padrejtësi, një mjek apo një ilaç gjatë një sëmundjeje, një degë në humnerë, një trung kur bie në det... ngushëllimi përballë një dhimbjeje të madhe, pozita, posti, fëmijët dhe të afërmit, të dashurit e zemrës...çdo gjë, nga më e vogla deri te më e madhja... nëna, babai, fëmija... Të gjitha këto janë lidhjet tona me këtë botë.

Në qoftë se ndonjëra prej këtyre që numëruam kalon para varësisë ndaj Allahut, kjo do të thotë se njeriu ka filluar të përjetojë një problem në varësinë e tij ndaj Zotit dhe ka filluar të ngatërrojë koordinatat e tij të orientimit.

Çfarë nënkuptojmë kur themi se një gjë mund të bëhet më e rëndësishme se varësia ndaj Allahut?

Ndoshta duhet të kalojmë nëpër një filtër analize një e nga një të gjitha ato gjëra me të cilat kemi krijuar një lidhje në jetën tonë.

- Të gjitha lidhjet që zëvendësojnë apo dalin para lidhjes me Allahun,

- që të bëjnë ta harrosh Allahun,

- që të largojnë nga varësia ndaj Zotit

- ndaj të cilave janë të orientuara të gjitha shpresat, dashuritë dhe frika që në të vërtetë **“duhen orientuar ndaj Allahut”**...

Çdonjëra prej tyre është një situatë specifike për njeriun, i cili mund të përballlet me këtë lloj situatë mëndore në fusha të ndryshme sprovimi.

Në Kuran, teksa flitet në lidhje me një grup të caktuar njerëzish, thuhet se ata **“i duan ashtu siç duan Allahun”** disa krijesa të caktuara. Kurani e përkufizon këtë lloj dashurie si **“barazim të krijesave me Allahun”**. Po në Kuran thuhet se **“besimtarët e duan Allahun më shumë se çdo gjë tjetër.”** (Bekare, 165)

Do të lexoni:

4

Ahmet Tashgetiren



- Ahmet Tashgetiren / 4** Jeta që pëlqen Allahu
Dr. Durak Pasmaz / 8 Të bëhesh çelës për të mirën dhe kyç për të keqen
A. Jasin Demirxhi / 11 "Puna e mirë" dhe "Jeta e bukur"
Evans Drishti / 12 Kushti i gjashtë i Islamit Të dish detyrimet e tua
Edison Çeraç / 15 Transplanti ideor
Nuredin Jëlldëz / 16 Çfarë kongresi është haxhi?
Dr. Ali Akben / 18 Cili është ushqimi i shpirtit?
Rabia Christine Brodbeck / 20 Mos bëj që ta humbim afrimitetin me ty
Durmush Koç / 23 Rruga drejt shpresës
Mustafa Tuna / 24 6 faktorët që ligështojnë zemrën
Sadik Dana / 27 Çfarë është pasuria?
Prof. dr. Hasan K. Jëllmaz / 28 Të qenët me Allahun mes takvasë dhe ihsanit
Prof. dr. Enbija Jëlldërëm / 31 Besimi ka nevojë për veprim
Sami Bujukajnak / 34 Mbrujtja e zemrës me adhurim
/ 36 Fotoja e Muajit
/ 38-39 Një ajet - Një hadith

24

Mustafa Tuna



31

Prof. dr. Enbija Jëlldërëm



Viti: VI | Numri: 55 | Tetor 2012

Drejtor & Kryeredaktor:

Alban Kali

albankali@yahoo.com
+355 67 20 86767

Redaktor:

Zija Vukaj

Korrektore:

Dr. Irida Hoti

Përkthyesit:

Albert Halili / Arjan Ymeraj
Artur Tagani / Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

Dizajn-Grafik:

Bledar Xama

bledar_xama@hotmail.com

Për artikuj:

e-mail: revistaetika@progresibotime.com

Tetor 2012

40

Osman Nuri Topbash



Të shohësh me syrin e urtësisë
për të marrë mësim

Agimi është koha
e pastrimit të besimtarit

Duhani dukuri vrastare
për veten dhe të tjerët

Dynjaja dhe gjërat e tjera
të përkohshme

Ringjallja e rrugëve shpirtërore
të Islamit

Përgjegjësia

E vërteta e paralajmërimit Hyjnor

Aventura e njeriut në tokë

Të themi Allah para se të themi obobo

Kryengritja e trupit

Disa nga urtësitë e Haxhit

Një raport sekret i vitit 1891 në lidhje
me lëvizjen kombëtare shqiptare

Artit i Ebrusë

Historia e dheut si dhe shtim'i i njerzisë
bashkë me ligjët Hyjnore

40 / Osman Nuri Topbash

46 / Dr. Kerim Bulladë

48 / Ali F. Iljazi

51 / M. Sami Ramazanogllu

52 / Vehap Kola

54 / Nihat Tyzyn

56 / Xhafer Durmush

58 / Abdurrahman Xhandan

60 / Ali Riza Temel

62 / Bilal Atis

64 / Naim Drijaj

66 / Ma. Ermal Nurja

68 / Ma. Artur Tagani

70 / Zani i s'kaluemes

48

Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi



64

Naim Drijaj



PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

**L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania**

Tel: +355 22 254 634
Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 4411 98 48

Çmimi:

**Shqipëri: 150 Lekë
Abonim (një vjetor): 1500 Lekë
Kosovë: 1 Euro
Abonim (një vjetor): 10 Euro
Maqedoni: 60 DEN
Abonim (një vjetor): 720 DEN
Europë: 2 Euro
Abonim (një vjetor): 24 Euro**



Jeta që pëlqen Allahu

Ahmet Jashgetiren

Myslimani duhet të tregojë kujdes të mos dalë përpara Zotit në fushën e llogarisë së madhe, ku çdo njeri synon të vërtetojë “varësinë e tij ndaj Zotit” në librin e tij të jetës, me një libër jete tërë plagë, të mbushur me ngjarje që nuk mund t’i justifikojë dhe që nuk ka asnjë argument që të mund t’i legjitimonte ato.

Kjo është filozofia e pandryshueshme për një mysliman...

Ajo duhet të përfshijë dy gjëra:

- Një jetë ku *Jo*-të (La) të jenë të qarta.
- Një jetë ku *përveç*- i (il-la) është pjekur deri në ndër-gjegjësim.

Kur themi që *Jo*-të duhet të jenë të qarta, me këtë nënkuptojmë:

Të gjitha lidhjet që zëvendësojnë apo dalin para lidhjes me Allahun, që të bëjnë ta harrosh Allahun, që të largojnë nga varësia ndaj Zotit dhe ndaj të cilave janë të orientuara të gjitha shpresat, dashuritë dhe frika që

në të vërtetë “**duhen orientuar ndaj Allahut**”...

Situata kur *përveç*-i arrin gjendjen e ndër-gjegjësimi shpreh faktin se:

Allahu është Zoti i vetëm. Vetëm Ai meriton të adhurohet. Vetëm prej Tij mund të kërkohet ndihmë. Ai, Ai dhe vetëm Ai...

E parë nga ky aspekt, të flasësh rreth një **jete të varur pas Allahut**, do të thotë të na shqetësojë vazhdimisht ndjenja e frikës se mos vallë në një mënyrë apo tjetrën kemi rënë nën **varësinë e ndonjë gjëje tjetër përveç Allahut**.

Po kështu, të flasësh rreth një **jete të varur pas Allahut**, do të thotë të na shqetësojë vazhdimisht ndjenja

e frikës se mos vallë kemi përjetuar humbje të ndër-gjegjësimin tonë në lidhje me varësinë e jetës sonë ndaj Allahut.

Këto të dyja janë treguesit se në dimensionet **La** dhe **il-la** të fjalës së dëshmisë, pra shprehjes **La ilahe illah**, e cila është shprehja më përmbledhëse e besimit islam, mund të përjetohet problemi. Përjetimi i një problemi të tillë do të thotë se fjala e dëshmisë, me fjalë të tjera, rrënjët e besimit të një myslimani janë dëmtuar.

Kur themi **La ilahe**, themi se **nuk ka Zot**. Këto fjalë e shpjen njeriun drejt mohimit, abstragimit dhe izolimit në emër të hyjnisë. Mendja e njeriut i këput të gjitha lidhjet e kësaj bote në emër të hyjnisë.

Në mënyrë që në vend të tyre të formohet një lidhje dhe marrëdhënie e re.

Në mënyrë që mbi themelet e dëlira dhe të purifikuara të mendjes të lidhet besa dhe të jepet zotimi për një varësi të re.

Këtë kushtëzojnë fjalët **ila-llah**, që kanë kuptimin **për-veç Allahut**.

Ky zotim duhet të mbetet i vlefshëm për çdo çast.

I vlefshëm edhe me dimensionin e **La**-së edhe me dimensionin e **Il-la**-së.

Kjo do të thotë rishikim i vazhdueshëm i lidhjeve që krijojmë në këtë botë, me qëllim distancimi nga çdo lloj orientimi që do të përpiqet të zërë vendin e varësisë ndaj Allahut, si dhe mbajtja gjallë e zotimit të varësisë ndaj Allahut...

Nuk ka dyshim se njeriu jeton në këtë botë dhe krijon një sërë lidhjesh dhe marrëdhëniesh të domosdoshme...

Ai krijon marrëdhënie me organet e tij të trupit, me njerëzit e tjerë dhe me objektet e tjera...

Madje, disa prej këtyre lidhjeve, me kalimin e kohës shndërrohen në lidhje shumë jetike për të.

Një pikë uji, kur e ka kapluar etja, një rrishtë bukë, kur është i uritur, çdo gjë që i fal shpresën e shpëtimit në një moment kur i bëjnë padrejtësi, një mjek apo një ilaç gjatë një sëmundjeje, një degë në humnerë, një trung kur bie në det... ngushëllimi përballë një dhimbjeje të madhe, pozita, posti, fëmijët dhe të afërmit, të dashurit e zemrës...çdo gjë, nga më e vogla deri te

më e madhja... nëna, babai, fëmija... Të gjitha këto janë lidhjet tona me këtë botë.

Në qoftë se ndonjëra prej këtyre që numëruam kalon para varësisë ndaj Allahut, kjo do të thotë se njeriu ka filluar të përjetojë një problem në varësinë e tij ndaj Zotit dhe ka filluar të ngatërrojë koordinatat e tij të orientimit.

Çfarë nënkuptojmë kur themi se një gjë mund të bëhet më e rëndësishme se varësia ndaj Allahut?

Ndoshta duhet të kalojmë nëpër një filtër analize një e nga një të gjitha ato gjëra me të cilat kemi krijuar një lidhje në jetën tonë.

- Të gjitha lidhjet që zëvendësojnë apo dalin para lidhjes me Allahun,

- që të bëjnë ta harrosh Allahun,

- që të largojnë nga varësia ndaj Zotit

- ndaj të cilave janë të orientuara të gjitha shpresat, dashuritë dhe frika që në të vërtetë **"duhen orientuar ndaj Allahut"...**

Çdonjëra prej tyre është një situatë specifike për njeriun, i cili mund të përballet me këtë lloj situatë mendore në fusha të ndryshme sprovimi.

Në Kuran, teksa flitet në lidhje me një grup të caktuar njerëzish, thuhet se ata **"i duan ashtu siç duan Allahun"** disa krijesa të caktuara. Kurani e përkufizon këtë lloj dashurie si **"barazim të krijesave me Allahun"**. Po në Kuran thuhet se **"besimtarët e duan Allahun më shumë se çdo gjë tjetër."** (Bekare, 165)

Në Kuran, për shembull, kur bëhet ftesa për sprovim me pasuri dhe me shpirt për betejën e Tebukut, tregohet se pati nga ata që mbetën pas në përmbushjen e kësaj sprove dhe si arsye e kësaj situatë përmenden koha e nxehtë dhe stina gjatë së cilës mblidheshin hurmat, që ishin baza ushqimore për arabët.

Në Kuran jepet si shembull i **"varësisë ndaj Allahut"** gjatë **"sprovës me jetë"**, qëndrimi i magjistarëve, të cilët i besuan thirrjes së profetit Musa. Faraonit, i cili iu hakërrye atyre me fjalët **"Si guxoni të besoni një Zot tjetër pa më marrë leje mua?!"** dhe pastaj shtoi fjalët **"Do t'ju var të gjithëve, ndërsa duart dhe këmbët do t'ju pres në mënyrë tërthore"**, magjistarët iu



përgjigjën me fjalët: **“Ti mund të sundosh vetëm në këtë botë!”** Pra, frika nga dënimi me vdekje nuk qe për magjistarët më e rëndësishme se varësia e tyre ndaj Allahut.

- Teksa na mëson se cilin gjykim duhet të marrim për bazë, në rastet kur biem në kontradiktë në lidhje me një çështje, Kurani thekson faktin se edhe në këtë rast njeriu do të kalojë një provë të varësisë së tij me Zotin. Harmonia e **La** dhe **Illā**-së, në këtë rast është e mundur të krijohet vetëm në qoftë se vendimi që do të merret nuk do të na orientojë drejt idhullit si simboli i fuqisë që përfaqëson të gjithë vatrat e pushtetit përjashta Allahut, por do të na orientojë drejt Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Nëpërmjet personalitetit të profetit Nuh njeriu merr mësimin se si ai mund të tejkalojë **“lidhjen e tij me fëmijët”**.

Në personalitetin e profetit Ibrahim ai gjen një tjetër shembull të **“sprovës me fëmijën”**.

Në personalitetin e profetit Lut bëhet fjalë për sprovën në lidhje me bashkëshorten.

Në personalitetin e profetit Jusuf përjetohet një llogari mes urdhrat të Allahut dhe ndjenjave e pshore.

Kurani na paralajmëron disa herë dhe me anë të shembujve të ndryshëm se marrëdhënia që ka njeriu me pasurinë e tij nuk duhet të bëhet më e rëndësishme se varësia e tij ndaj Allahut.

Kur Kurani ia tërheq vëmendjen njeriut se **“sadakatë i merr Allahu”**, teksa përcjell tek ai urdhrin hyjnor **“dhuroni nga begatitë që Zoti ju ka dhënë juve”**, kërkon të ndërtojë tek ai vetëdijen e varësisë ndaj Allahut.

...

Në themelet e përpikmërisë për një **“jetë të varur nga Allahu”**, gjendet e vërteta e ekzistencës dhe mos-ekzistencës së njeriut dhe faktet se ai vjen prej Allahut dhe do të shkojë prapë tek Ai.

“Inna lillah ve inna ilejhi raxhiun – Ne vijmë prej Allahut dhe tek Ai do të kthehemi.”

Ky ajet ka zbritur për të na mësuar “qëndrimin prej besimtarit” që duhet ekspozuar në rastin që ballafaqohemi me një fatkeqësi.

“Ne gjithsesi do t’ju sprovovjmë me diçka nga frika

dhe uria edhe me humbje të pasurisë, të jetës dhe të të mbjellave. Ti përgëzoji durimtarët.” (Bekare, 155)

Ajeti që kemi cituar më lart, vjen menjëherë pas ajetit që sapo shkruam.

Mirëpo çfarë bëjnë vallë **“durimtarët”**?

Ata thonë **“Inna lillah ve inna ilejhi raxhiun”**

Durimi vjen si rezultat i besimit se çdo gjë që ndodh, realizohet brenda kornizave të vendimeve të Allahut, se asnjë lloj vullneti nuk ka kuptim përpara vullnetit të Fuqisë së Madhërishme dhe për këtë arsye, nuk ka shpëtim tjetër përveç dorëzimit ndaj vendimit hyjnor.

Dorëzim përpara Allahut.

Pasi varësia absolute i takon vetëm Allahut.

Pasi edhe një gjethe që bie në tokë, varet prej vullnetit dhe fuqisë së Zotit.

Kurani e rrëfen marrëdhënien mes Allahut të Lartësuar dhe të së vërtetës së krijesës, a thua se dëshiron që ta endë fije për pe mendjen e njeriut:

Pyeti: “E kujt është toka dhe gjithë çfarë ka në të, nëse e dini?” “Të Allahut!” – do të përgjigjen, por ti thuaju: “Po pse pra nuk vini në vete?” Pyeti: “Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i gjithësisë?” “Allahu” – do të thonë ata, kurse ti thuaju: “E pse pra nuk ia keni frikën Atij?” Thuaj: “Kush është Ai, në duart e të cilit është pushteti mbi të gjitha, e që merr në mbrojtje dhe nuk ka nevojë për t’u marrë në mbrojtje, nëse e dini?” “Allahu!” – do të përgjigjen, e ti thuaju: “Po pse pra jeni si të magjepsur?” (Muminun, 84-89.)

Njeriu që e kupton këtë të vërtetë, arrin të kuptojë se Kurani pret prej tij të ndërjegjësohet se:


- Kemi ardhur prej Zotit dhe tek Ai do të kthehemi.

- Zoti ka krijuar qiellin dhe tokën dhe siguron rregullin mes tyre.

- Urdhrat dhe vendimet i jep vetëm Allahu. Çdo gjë i përket vetëm Atij.

- Allahu e di të panjohurën (gajb).

- Allahu e ka bërë milingonën milingonë, gurin gur dhe njeriun njeri.



- Allahu i dha formë syve, veshëve, mendjes dhe zemrës sonë. Ai bëri që gruaja të bëhet nënë dhe mashkulli baba. Ai vendosi ligjin e përgjithshëm në zemrat e prindërve për dashurinë e tyre ndaj fëmijëve, fuqinë e durimit të vështirësive gjatë rritjes së tyre, duke siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë e njerëzimit.

-Çdo gjë do të shkatërrohet me përjashtim të Zotit. Vendimi i takon vetëm Atij dhe çdo gjë do të kthehet tek Ai një ditë.

- Edhe krijimi, edhe administrimi i çdo gjëje i përket vetëm Atij.

- Ekzistenca është e pamundur pa Të.

Kur të gjithë këto që numëruam janë të vërteta, atëherë edhe frymëmarrja jonë realizohet falë Zotit...

E gjithë jeta jonë, duke përfshirë edhe frymëmarrjet, duhet të na bëjë të jemi të lidhur çdo çast me Të.

Meqenëse varësia e njeriut ndaj Zotit është kaq jetike, atëherë përse njeriu ecën duke u lëkundur?

Me fjalë të tjera,

Nga buron problemi gjatë krijimit të një **"jete të varur me Zotin"**?

Thelbi i problemit konsiston në shpërqendrimin e njeriut brenda lidhjeve që krijon në jetën e tij, nga fakti se ai bëhet indiferent (**gafil**) ndaj urdhrave të Zotit dhe kështu shkëputet nga urtësia e ekzistencës.

Njeriu e harron Zotin.

Ai harron se Zoti është pranë tij çdo çast, se është pranë tij më afër se damari i qafës, se çdo gjë ndodhet nën kujdesin e Zotit dhe se edhe fleta e gjethit nuk mund të luajë pa e ditur Zoti.

Ai harron se jeta e kësaj bote është fusha e provës e përcaktuar nga ana e Allahut.

Ai harron ditën që do të takohet me Zotin.

Ai harron se ka për të dhënë llogari përpara Zotit për jetën e tij në këtë botë.

Çfarë përgjigjeje i pati dhënë Ubej bin Kab Umerit, kur ai e pati pyetur se çfarë ishte devocioni (takva)?

"Devocioni është gjendja shpirtërore e ngjashme me rastin kur njeriu ecën në një fushë me gjemba dhe bën

kujdes të mos shkelë mbi to."

Përse është i domosdoshëm devocioni? Përse ai është shprehja më e rëndësishme e besimtarit në fenë islame?

Pasi devocioni është korniza e varësisë së besimtarit ndaj Allahut. Frika dhe shqetësimi se mos Allahu nuk është i kënaqur me punët që ai bën.

"Jeta me devocion", është jeta në të cilën "vetëdija e varësisë ndaj Allahut" është e gjallë.

Në qoftë se shkel një limit në varësinë tënde ndaj Allahut, dije se në këmbë do të të ngulet një gjemb, dhembjen e të cilit do ta ndjesh thellë në zemër. Zemra do të plagoset.

Do ta ndjesh në shpirt dhimbjen që të shkaktohet, sepse zemra jote është e pajisur me aftësinë e vetëdijes së varësisë ndaj Allahut, prandaj gjembi që të ther ka hyrë thellë në vetëdijen tënde.

Për këtë arsye, zemra e besimtarit është e ngopur me perceptimin se "kudo që të gjendet, Zoti është bashkë me të". Ky lloj ndërjegjësimi, përcillet nga zemra tek të gjitha pjesët e tjera të trupit


Synimi i "jetës që varet nga Allahu", e ngarkon besimtarin me detyrën e filtrimit të gjithë jetës së tij.

Në çdo fushë të jetës njeriu është i vetëdijshëm për varësinë e tij ndaj Zotit, është në koherencë me mësimet e Tij, në çdo fushë të jetës ka pësuar tensionime, asgjëja ka zënë vendin e varësisë ndaj Zotit, ku kanë hyrë në mes rolet përcaktuese të forcave të jetës, me përjashtim të forcës së Allahut. Të gjitha këto përcaktohen sikur njeriu i ka bërë një rezonancë ndërjegjëse së tij.

Myslimani duhet të tregojë kujdes të mos dalë përpara Zotit në fushën e llogarisë së madhe ku çdo njeri ka hallin të vërtetojë **"varësinë e tij ndaj Zotit"** në librin e tij të jetës, me një libër jete tërë plagë, të mbushur me ngjarje që nuk mund t'i justifikojë dhe që nuk ka asnjë argument që të mund t'i legjitimonte ato.

Zoti ynë mos na e preftë ndihmën hyjnore në rrugën e kësaj përpjekjeje të madhe, duke na lënë në mes të rrugës.

Amin.



Kur të gjithë këto që numëruam janë të vërteta, atëherë edhe frymëmarrja jonë realizohet falë Zotit...

E gjithë jeta jonë, duke përfshirë edhe frymëmarrjet, duhet të na bëjë të jemi të lidhur çdo çast me Të.

Meqenëse varësia e njeriut ndaj Zotit është kaq jetike, atëherë përse njeriu ecën duke u lëkundur?

TË BËHESH ÇELËS PËR TË MIRËN DHE KYÇ PËR TË KEQEN



Dr. Durak Puzmaz

E mira është një fjalë me kuptim të gjerë, që nënkupton çdo vepër të ligjshme, të dobishme dhe të mirë, kurse e keqja është e kundërta e saj, në kuptimin e gjërave jo të ligjshme dhe të dëmshme. Thënë ndryshe, veprat dhe aktet që bëjmë në përshtatje me pëlqimin e Zotit, janë të mira; kurse veprat dhe sjelljet që bëjmë në kundërshtim me pëlqimin e Zotit, janë të këqija.

I Dërguari i Zotit (s.a.s.), thotë në një hadith: *“Ka prej njerëzve që janë çelësi i të mirës dhe kyçi i së keqes. Ka edhe prej atyre që janë çelës për të keqen dhe kyç për të mirën. Lum ata që janë çelës për të mirën! Mallkuar qofshin ata që janë çelës/nxitës për të keqen.”* (Ibn Maxhe, Mukaddime, 19)

Vërejmë se Profeti ynë i dashur (s.a.s.), njerëzit i ka ndarë në dy kategori, në ata që motivojnë të mirën dhe në ata që motivojnë të keqen:

1. Ka njerëz që janë çelës për të mirën dhe kyç për

të keqen. Thënë ndryshe, ata janë të hapur për të mirën dhe të mbyllur për të keqen. Çelësat që kanë në duar, janë çelësat e së mirës, që hapin vetëm dyer të mira dhe mbyllin dyert e së keqes.

Ata janë të lumtur kur bëjnë mirë, kur veprojnë mirë. Ndaj dhe u binden urdhrave të Zotit të Madhëruar: **“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe është përgatitur për të devotshmit.”** (Ali Imran, 133), pra, nxitojnë për të vepruar mirë, si dhe nxisin të bëjnë mirë. Ata nuk lodhen, nuk ndalojnë së punuari, së përpjekuri, së munduari për këtë kauzë. Çdo lloj vështirësie që u del përpara, e mundin, çdo lloj pengese e kalojnë, vetëm për të arritur të bëjnë vepër të mirë.

Janë pikërisht ata që ndjekin fjalën e Zotit: **“Çdokush ka një drejtim nga i cili kthehet. Pra, bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira.”** (Bekare, 148), pra, garojnë me njëri – tjetrin në vepra dhe shërbime të mira.

Kjo është një garë e ëmbël, një sfidë e këndshme, një garë në shërbim, jo për të pasur përfitime të kësaj bote e as për të pasur përfitime materiale.

Kjo është një garë që bëhet për t'i shërbyer njerëzimit, që të fitohet pëlqimi i Zotit.

Në këtë garë nuk ka punë kundër tjetrit, nuk ka nënkëmbëza për tjetrin, nuk ka pengesa për shërbimin e tjetrit.

Përkundrazi, në këtë garë, duke iu bindur urdhrin të Zotit: **“Ndhimoheni njëri-tjetritin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër.”** (Maide, 2), ka punë të mira dhe ka ndihmë për tjetrin lidhur me takvanë. Nga ky ajet kuptohet që ndihma lidhur me veprën e mirë, është tre-gues i takvasë, ashtu sikundër ndihma në të keqe buron nga armiqësia. Besimtarët nuk janë armiqtë, por miqtë e njëri – tjetrit.

Në këtë garë ka ndihmë mes njëri – tjetrit lidhur me gjërat e bukura, që janë të dobishme për njerëzimin dhe për fenë tonë, kështu ka vullnet për të arritur suksese së bashku në punë, që janë të vështira të kryhen vetëm.

Ata që gjenden në këtë garë, janë njerëzit e bamirësisë, ata që kanë flijuar veten që të bëjnë vepra bamirësie.

Ata janë njerëzit e shërbimit, kudo qoftë një veprë e mirë, kudo qoftë një shërbim i mirë, ata atje shkojnë, atje janë.

Ata janë njerëz që dashurojnë shërbimin, nuk ngopen së bëri mirë dhe së shërbyeri. Sa më shumë që bëjnë, aq më shumë dëshirojnë të bëjnë edhe më tepër mirë, edhe më shumë shërbim. Sepse e kanë vënë vësh në vesh thirrjen profetike: **“Besimtari nuk ngopet së bëri vepra të mira që dëgjon, derisa të hyjë në xhenet.”** (Tirmidhi, IIm, 19)

Ata e dinë se lumturia në të dy botët arrihet përmes të qenit afër së mirës dhe larg së keqes.

2. Ka njerëz që janë çelës për të keqen dhe kyç për të mirën. Këta njerëz janë ata që nuk kanë vajtur

asnjëherë në rrugën e mirë e as që kanë trokitur ndonjëherë në dyert e së mirës. Gjithnjë kanë vajtur në rrugë të keqe dhe kanë hapur vetëm dyert të këqija. Janë ata që nxitojnë në vepra që janë të dëmshme për fenë dhe njerëzimin.

Madje, këta nuk mjaftohen vetëm vetë duke bërë vepra të këqija, të shëmtuara dhe të dëmshme, por nxisin edhe të tjerët të vazhdojnë në këtë rrugë të keqe, shqetësohen kur të tjerët bëjnë mirë. Dëshirojnë që edhe të tjerët t'i bëjnë si veten. Ashtu si të parët e mushrikëve të Mekës, që përpiqeshin të pengonin njerëzit që i besuan të Dërguarit të Zotit (s.a.s.).

Veçoritë e besimtarit të vërtetë:

Në ajetin dhe hadithet e mësipërme mësojmë që:

a. Besimtari i vërtetë nxiton për vepra të mira dhe mbështet shërbime të mira.

b. Madje nuk mjaftohet vetëm me mbështetjen e veprave të mira, bëhet çelës për këto shërbime, hap rrugën e shërbimeve, bëhet iniciator. Të bësh mirë, sipas fesë sonë, ashtu sikurse ka sevapin e vet, ka sevap edhe për atë që inicion një vepër të tillë. Ndaj dhe Pejgamberi ynë i dashur (s.a.s.), për atë që është nismëtar i së mirës ka thënë se do të marrë shpërblim, aq sa marrin ata që e bëjnë atë vepër të mirë:

“Kushdo që bëhet nismëtar për një vepër të mirë, bashkë me sevapin që ka, merr edhe aq sa marrin ata që e bëjnë vetë këtë të mirë dhe as që u pakësohet nga sevapet atyre që bëjnë këtë vepër të mirë. Kush bëhet nismëtar i së keqes, bashkë me gjynahun, merr po ashtu edhe aq gjynahe sa marrin ata që e bëjnë këtë të keqe dhe as që u pakësohet nga gjynahet atyre që e bëjnë këtë vepër të keqe.” (Tirmidhi, IIm, 15.)

Lidhur me temën në fjalë, Hudhejfa rrëfen një ngjarje të tillë: “Në kohën e Pejgamberit (s.a.s.), një njeri kërkoi ndihmë. Ata që gjendeshin aty nuk i dhanë asgjë. Më pas, pasi njëri nga ata e ndihmoi, atëherë edhe të tjerët nisën ta ndihmonin. Pas kësaj,

*Kjo është një garë e ëmbël,
një sfidë e këndshme, një garë
në shërbim, jo për të pasur
përfitime të kësaj bote e as për
të pasur përfitime materiale.
Kjo është një garë që bëhet
për t'i shërbyer njerëzimit, që
të fitohet pëlqimi i Zotit.*

Pejgamberi (s.a.s.), tha kështu:

“Kushdo që bëhet nismëtar për një vepër të mirë, bashkë me sevapin që ka, merr edhe aq sa marrin ata që e bëjnë vetë këtë të mirë dhe as që u pakësohet nga sevapet atyre që bëjnë këtë vepër të mirë. Kush bëhet nismëtar i së keqes, bashkë me gjynahun që merr ai, merr po ashtu edhe aq gjynahe sa marrin ata që e bëjnë këtë të keqe dhe asqë u pakësohet nga gjynahet atyre që e bëjnë këtë vepër të keqe.” (Ahmed, Musned, 388)

Siç shihet, Pejgamberi (s.a.s.), nuk motivonte sahabët vetëm që të bënin vepra të mira, por edhe të bëheshin nismëtarë të veprave të mira, shërbimeve të mira. Lidhur me këtë, ka mjaft transmetime që vijnë nga Pejgamberi (s.a.s.). Njëri nga këto transmetime është ky:

Ebu Mes'ud el-Ensari rrëfen:

Një njeri erdhi te Resulullahu (s.a.s.) dhe i tha:

- Më ngordhi kafsha ime, më jep një kafshë.

Resulullahu (s.a.s.), i tha:

- Unë nuk kam.

Një njeri që gjendej aty pranë, i tha:

- O i Dërguar i Zotit, e drejtoj unë për tek një njeri që mund t'i dhurojë kafshë.

Pas kësaj, Resulullahu (s.a.s.), tha kështu:

- *Kush bëhet nismëtar i një vepre të mirë, merr sevap aq sa ai që e bën atë vepër të mirë.* (Muslim, Imare, 133)

c. Besimtari i vërtetë, lidhur me një vepër të mirë nuk thotë: “Pa të shoh një herë, si të sillen ata, sillem edhe unë”, por nxiton të bëjë mirë, ata që gjenden larg së mirës ose nuk merr për shembull ata që e marrin punën me ngadalë, përkundrazi përpiqet të marrë shembujt e mirë për veten e vet. Resulullahu (s.a.s.), ka thënë kështu:

“Mos u bëni si njerëzit e rëndomtë që thonë: nëse të gjithë bëjnë mirë, atëherë edhe ne bëjmë mirë, nëse të gjithë bëjnë padrejtësi, atëherë edhe ne bëjmë padrejtësi. Përkundrazi, përgatiteni veten të bëni mirë për

njerëzit që ju bëjnë mirë dhe mos u bëni keq atyre që ju bëjnë keq.” (Tirmidhi, Birr, 63)

d. I gjithë qëllimi i besimtarit është të arrijë pëlqimin e Zotit. Çdo vepër, akt e sjellje që bëhet për të arritur kënaqësinë e Tij, është vepër e mirë. Ndaj dhe Pejgamberi (s.a.s.), ka thënë:

“Në fakt, është për t'u habitur me punën e besimtarit, sepse çdo punë e tij është e mirë. Kjo gjendje i përket vetëm besimtarit. Nëse besimtarit i vjen qetësi dhe pasuri, për këtë është mirënjohës ndaj Zotit, kështu edhe ajo bëhet vepër e mirë për të. Nëse ka shqetësime, ai duron, kjo gjë po ashtu është e mirë për të.” (Muslim, Zuhd, 64)

e. Besimtari nuk mburret me veprat e mira dhe të bukura që ka bërë, përkundrazi e di se për këtë është Zoti ai që ia ka mundësuar. Ndaj dhe i është mirënjohës Atij dhe i lutet që Ai ta bëjë që të jetë njeri që bën gjithnjë vepra të mira.

Pejgamberi (s.a.s.), në një hadith, thotë kështu:

- *Nëse Allahu dëshiron të mirën për një njeri, atë e përdor (në vepra të mira).*

Ndërkohë, sahabët e pyesin:

- O i Dërguar i Zotit, si e përdor?

Atëherë, Resulullahu (s.a.s.), u përgjigj:

- *Bën të mundur që ai të bëjë vepra të mira, para se të vdesë.* (Tirmidhi, Kader, 8)

Pejgamberi ynë (s.a.s.), në një tjetër hadith thotë kështu:

“Allahu i madhëruar ka njerëz të tillë që i ka krijuar të ndihmojë njerëzit e tjerë. Ata që kanë nevojë, gjithmonë i kërkojnë ata njerëz. Në ditën e kiametit, ata do të jenë të garantuar nga vuajtjet.” (Kudai, Musnedusihab, II, 118)

Zoti i Madhëruar na bëftë të gjithëve prej njerëzve të mirë, të cilët janë çelës për të mirën dhe kyç për të keqen!





Përse nuk pranohen duatë?

Një ditë, kur Ibrahim bin Edhem po shëtiste në pazarin e Basrës, populli i mblidhet pranë dhe e pyet në lidhje me ajetin fisnik: **“Lutmëni Mua, se do t’ju përgjigjem!..”** (el-Gafir, 60) Pastaj u ankuan duke thënë: **“Ne i lutemi Allahut, por Ai nuk na përgjigjet. Përse vallë?”**

Ibrahim bin Edhem tha: Zemra juaj ka vdekur në dhjetë gjëra:

1. Ju e njihni Allahun, por nuk i jepni të drejtën që ka.
2. Ju e lexoni librin e Allahut, por nuk veproni me të.
3. Thoni se iblisi është armiku juaj, por veproni sipas tij.
4. Thoni se e doni shumë të Dërguarin e Allahut, por e braktisni rrugën dhe sunetin e tij.
5. Dëshironi xhenetin, por nuk punoni për të.
6. Keni frikë nga xhehenemi, por nuk ruheni nga gjynahet.
7. E dini se vdekja është e vërtetë, por nuk përgatiteni për të.
8. Merreni me të metat e të tjerëve, por nuk i shikoni të metat tuaja.
9. Hani prej riskut (furnizimit) që ju jep Allahu, por nuk falënderoni.
10. Varrosni të vdekurit tuaj, por nuk merrni mësim prej tyre.

“Puna e mirë” dhe “Jeta e bukur”

A. Jasin Demirxhi

“Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.” (en-Nahl, 97)

Është fakt se pothuajse tek të gjithë, botëkuptimi i “lumturisë” dhe “jetës së bukur” është i ndryshëm. Sipas shumicës, mundësitë e mëdha materiale janë çelësi më i rëndësishëm i një “jete të bukur”. Prandaj, për të arritur këtë “jetë të bukur” në kuptimin material, shpenzohen përpjekje të jashtëzakonshme.

Por krejt ndryshe është çelësi që hap dyert e “jetës së bukur” sipas disa të tjerëve...

Ndërkohë që në Kuranin Kerim, ashtu siç tregon edhe ajeti 97 i sures en-Nahl, që kemi dhënë më sipër, për ata që dëshirojnë një “jetë të bukur” propozohet një çelës ndryshe: “Puna e mirë”.

Puna e mirë; pra adhurimet që bëjnë njeriu për hir të Allahut dhe të gjitha mirësitë e vogla e të mëdha që bëjnë ai për veten, familjen dhe njerëzit e tjerë. Mirëpo, mufesirët (dijetarët e komentimit të Kuranit), të cilët e kanë komentuar konceptin “punë e mirë”, kanë vënë edhe një kusht që një punë të quhet e mirë... Ata kanë nënvizuar se asnjë punë, e cila nuk i ka rrënjët të mbështetura në besim, nuk mund të konsiderohet “punë e mirë”. E shprehur ndryshe, çfarëdo lloj pune qoftë, edhe nëse bëhet në përputhje me udhëzimet e Allahut dhe të Rasulallahut (a.s.), nëse nuk i ka rrënjët në besim, nuk mund të konsiderohet “punë e mirë”. Prandaj dhe në Kuranin Kerim, kudo që përmendet puna e mirë, bashkë me të përmendet edhe besimi.

“Jeta e bukur” që është premtuar, është në këtë botë apo në botën tjetër?

Vallë, “Jeta e bukur”, e cila u është premtuar atyre që bëjnë “punë të mira”, do të jetë në këtë botë apo në botën tjetër? Në lidhje me këtë çështje, shumica e mufesirëve janë të mendimit se jo vetëm në xhenet, por edhe në këtë botë do të mbretërojë jeta e lumtur dhe e qetë.

Përveç “jetës së bukur”, Allahu Teala ka edhe premtime të tjera për ata që bëjnë “punë të mira”.

Disa nga këto premtime, janë:

“Në të vërtetë, atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i Gjithëmëshirshmi do t’u dhurojë dashuri.” (Merjem, 96)

“Për sa u përket atyre që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, ata do t’i pranojë Zoti i tyre në mëshirën e Vet. Kjo është fitorja e lavdishme!” (el-Xhathije, 30)

Shkurtimisht, robërit e mirë e të singertë që besojnë singërisht dhe jetojnë në përputhje me kënaqësinë e Allahut, i pret një “jetë e bukur” në të dyja botët. Në këtë çështje, nuk ka asnjë dyshim, sepse Kurani Kerim, **“është Libri në të cilin nuk ka dyshim”**. (el-Bekare, 2)

Allahu i Madhëruar, na bëftë të gjithëve prej robërve të mirë që bëjnë “punë të mira”, të cilat do të na sigurojnë “jetën e bukur”...

Kushti i gjashtë i Islamit

TË DISH DETYRIMET E TUA

Evans Drishti

Pyetën njëherë një imam:

-Sa kushte ka Islami?

-Gjashtë, - qe përgjigjur.

-Jo imam, janë pesë: fjala e dëshmisë, falja e namazit, agjërimi i muajit të ramazanit, dhënia e zeqatit dhe shkuarja në haxh...

-Nuk i dini të plotë, - qe përgjigjur imami, - ka edhe një të gjashtë, kushti i gjashtë i Islamit është të dish detyrimet e tua.

Pesë kushtet e Islamit janë themelet bazë të ndërtesës së Islamit. Detyrat e myslimanit nuk janë vetëm këto. Ka edhe shumë farze dhe vaxhibe të tjera. P.sh. respekti dhe dashamirësia ndaj prindërve nuk zë vend në këto pesë kushte, por është një detyrë e të qenit mysliman...

Prandaj edhe imami i nderuar kishte shtuar një pikë të gjashtë, e cila i përfshinte të gjitha detyrimet e një myslimani.

TË DISH DETYRIMET QË KE ...

Nëse fëmija i di detyrimet e veta, qëndron përherë pranë prindërve dhe u fal atyre mirësi...

Nëse komshiu i di detyrimet e veta, nuk e mërzit komshiun e tij...

Nëse shitësi i di detyrimet e veta, e bën punën mirë dhe nuk trazon askënd...

Nëse nxënësi i di detyrimet që ka, e dëgjon fjalën e mësuesit, vepron sipas atyre që mëson etj...

Nëse individi i di detyrimet e veta, nuk gënjen...

Nëse dijetari i di detyrimet e veta, jeton me dijen e përvetësuar duke shtuar edhe më shumë përvojën e tij...

Të dish detyrimet që ke, është shumë e rëndësishme... Që njeriu të kuptojë detyrimet që ka, është e nevojshme të njohë vetveten... Është thënë përherë: "Kush e njeh nefsën, njeh edhe Zotin" Që të njohim Zotin, duhet të njohim vetveten.

Haxhi Bajram Veliu, pati thënë: "Njihe veten tënde, njihe." Në mesin e njerëzve kjo është shprehur kështu:

Njihe veten tënde, njihe

Nëse ti nuk e njeh veten tënde,

Ta plasin qafën.

Qëllimi kryesor i dijes, mësimit dhe arsimimit është që njeriu të njohë vetveten dhe të dijë detyrimet e veta, qëllim të cilin edhe Junus Emre e shpreh mjaft bukur në vargjet e mëposhtme:

Dija është të dish shkencë,

Dija është të njohësh veten,

Nëse ti nuk e njeh veten,

Ç'të duhet gjithë ai mësim...

Si mund ta njohë njeriu veten, si mund ta analizojë? A mund ta shohë njeriu fytyrën e tij pa mjetin e duhur? Jo, vetëm nëpërmjet pasqyrës apo të ndonjë mjeti tjetër. Vetëm nëpërmjet një pasqyre mund ta vërë re nëse fytyra e tij është e pastër apo e ndotur, nëse ka njolla apo jo. E tillë është edhe njohja e vetvetes... Njeriu e sheh veten nëpërmjet asaj që pasqyron në rrethin e tij, tek miqtë dhe të afërmit. Për rrjedhojë edhe rrethi i njeriut nuk duhet të jetë mashtrues. Lëvdata e njeriut në sy, në fenë tonë përbën diçka jo të mirë. Njeriu nuk duhet të mashtrohet dhe të bjerë pre e këtyre lëvdatave dhe ta pandehë veten se është i madh, i mirë, i shëndetshëm, i ditur etj. Për këtë arsye, i është dhënë rëndësi modestisë. Sado të të lëvdojnë në sy, ti duhet ta njohësh veten. Duhet t'i përcaktosh qartë se deri ku shkojnë të drejtat dhe detyrimet e tua. Nuk duhet ta vësh veten në lojë. Duhet të dish se je një hiç. Asnjëherë s'duhet të harrosh se aftësia që ke është një dhunti nga Allahu. Në lutjet tona themi:

"O Zoti im, mos na bëj prej robërve që e shohin veten mbi të tjerët!" Nëse veten e sheh mbi të tjerët, kjo do të thotë se ke shkuar përtej të drejtave që ke.

Mos thuj asnjëherë: "Vërtet, nëse nuk do të isha i ditur, i aftë dhe i shkathët, pse të më lëvdojnë!", pasi nuk janë të paktë ata njerëz që për arsye të tilla, bien pre e mashtrimeve dhe humbasin vetveten duke shkuar përtej të drejtave që kanë.

Po ju tregoj një ndodhi mes një shefi dhe punëtorit të tij në Gjermani:

Shefi i drejtohet punëtorit: "Sille këtë e këtë"- dhe punëtori e sjell. Shefi i drejtohet sërish: "Çoje këtë e këtë"- dhe punëtori i çon. Shefi i drejtohet sërish punëtorit dhe i thotë: "Këtë e pake sjellë gabim, çoje këtë dhe më sill atë, as kjo nuk bën, sille edhe atë tjetrën"- dhe me t'i thënë këto fjalë, punëtorit i ngrihen nervat dhe nis t'i bërtasë shefit:

"Ti po luan me ne a si e ke hallin? Me ç'të drejtë na përdhunon në këtë mënyrë? Nuk mendon aspak, çoje, sille, çoje, sille... sido që të jetë ke gjetur njeriun për të bartur dhe natyrshëm nuk lodhet..." Shefi nuk foli asnjë fjalë. Me të mbaruar punën iu drejtua me këto fjalë:

"Më duket se qenke lodhur pak. Prandaj je edhe i nevrikosur. Ke kohë që punon këtu. Po u them atyre drejtuesve të lartë të të bëjnë shef. Kështu, ke mundësi të fitosh diçka më shumë dhe je më i qetë. Pastaj ke të drejtë të urdhërosh kështu si unë."

Punëtori ngeli i habitur dhe bëri një lëvizje me kokë, si për ta aprovuar mendimin. Shefi e mbajti fjalën e dhënë, u tha një fjalë drejtuesve të lartë dhe punëtori u bë shef. Më pas, u ngritën punëtorët e tjerë dhe thanë:

"Ai të bërtiti deri në ofendim dhe ti i bëre një të mirë.

Ne nuk folëm, mos vallë bëmë gabim, po sikur të bërtisnim edhe ne, ç'do të ndodhte?"

Shefi buzëqeshi si nëpër dhëmbë:

"Ju pandehni se i kam bërë një të mirë? Ashtu qoftë! Unë i bëra atij gjënë më të keqe që ekziston në botë, por ai nuk është i vetëdijshëm, as ju nuk jeni të vetëdijshëm."

"Allah, Allah, ç'të keqe i paskeni bërë? Ju u bëtë shkak që ai të bëhet shef."

"Unë atë e bëra shef, edhe pse nuk e meritonte. Tani për pak kohë, do të bëjë punën e drejtuesit. Duke qenë se ai nuk e meriton, nuk është për këtë punë, nuk do mund ta bëjë punën ashtu siç duhet. S'do kalojë shumë kohë dhe atë do ta heqin nga puna. Kur të hiqet nga puna, s'do mund të kthehet sërish si punëtor, megjithëse ai me vete mendon se fundi punëtor isha dhe po i kthehem sërish asaj pune. Ai kërkon të jetë drejtues me mendimin se tani u bë shef. Edhe në këtë drejtim nuk mund të gjejë punë.

Me muaj të tërë vërtitet ashtu kot. Ushqehet me paratë që ka mbledhur. Natyrshëm, nuk ka dëm më të madh se kaq!"

Vërtet, shefi në fakt nuk ka bërë gjë tjetër vetëm se është hakmarrë për një kohë të gjatë ndaj një personi të padurueshëm dhe të pasjellshëm në punë. Çdo gjë kish shkuar siç e kishte planifikuar. E vërteta është se në jetë hasemi shumë me të tilla raste. Postet e pamerituara gjithmonë kanë qenë problem. Pasuritë që të vijnë surprizë, si puna e lotove, siç të vijnë shpejt ashtu edhe shuhen shpejt.

Sa më shpejt të ngrihet njeriu në detyrë, aq e hidhur do të jetë edhe rënia.

Një poet i njohur thoshte: "**Nuk ka pjekuri më të madhe se kur njeriu di mangësitë e veta.**"

Vërtet njeriu duhet të dijë se ku ka gabuar, që mos të përballet më vonë me situata të dhembshura. Kur njerëzit nisin ta shohin veten si më të aftë se të tjerët, atëherë kanë çaluar, mbesin pa punë dhe pa fitesë. Që në atë moment, nisin të hanë të grumbulluarat e tyre. E vërteta është se ngritja në një detyrë duhet bërë shkallë - shkallë. Ata që ngrihen në detyrë me prapaska të ndryshme, duke u mbajtur pas krahëve të të tjerëve, nuk qëndrojnë gjatë. Të ngrihesh në një pikë të lartë, kërkon një aftësi më vete, të mbahesh aty është një mundim më vete. Ndodhia e mëposhtme është një shembull i tillë:

Në një firmë të njohur u mor një person i ri, i cili pohoi se në vendin ku kishte punuar më parë kishte qenë shef. Si i tillë, u pranua edhe aty. Kështu, në këtë firmë do të bënte detyrën e drejtuesit. Në fakt, nuk ishte njeri pa vlerë, por akoma nuk ishte personi i duhur që mund të bënte rolin e drejtuesit, akoma nuk kishte dijen dhe përvojën e kërkuar. Për rrjedhojë, nuk kishin kaluar tri javë dhe njerëzit e firmës e kishin hequr nga puna, duke i thë-



në: "Na vjen keq, por ti nuk vlen!" Në fakt ishte një individ me të cilin mund të punohej, por, i prirur nga dëshira për të qenë drejtues, ngeli pa punë.

Nëse dikush kërkon rolin e drejtuesit, askush nuk i thotë: "Ti nuk vlen për këtë punë, ti puno këtu!" Ata dëshirojnë që këtë gjë ai ta kuptojë vetë, të dijë vetë detyrimet që ka dhe deri ku mund të arrijë. Aty mund të qëndrojë vetëm një mik i ngushtë i vërtetë dhe, nëse mund të kalojë në vendin e tij dhe t'i thotë të vërtetat, por një gjë e tillë është shumë e vështirë... Nëse del në krye dhe thua: "Unë u bëra i tillë!", asgjë nuk mund të bësh. Nëse njerëzit do të mund ta kontrollojnë veten, nëse njerëzit do të mund ta kuptonin veten, çështja do kishte marrë fund.

Po u tregojmë një barcaletë të njohur:

Njëri ishte nisur me makinë në një drejtim të kundërt të rrugës. Ashtu i pavetëdijshëm, kish vijuar rrugën! Kontrolli i trafikut e kishte vënë re një situatë të tillë nëpërmjet kamerave dhe menjëherë kishte ndërhyrë. Kishte nisur lajmërimi nëpërmjet radios.

"Vini re! Vini re! Një mjet ka hyrë në drejtim të kundërt të rrugës!" Personi në fjalë as që e kishte vënë re edhe këtë lajmërim. Dhe ja si qe shprehur: "Çfarë njëri more, që të gjithë, që të gjithë!"

Kështu është edhe njeriu...

Edhe sikur të gjitha shenjat të tregojnë se ai është gabim, sikur të gjitha rezultatet të tregojnë se nuk është i duhur për punën që kërkon, mund të mos shohë të vërtetën. Mund të mendojë edhe që të gjithë janë gabim, ai ka të drejtë. Njerëz të tillë e shohin jetën përherë si një kumar. Ata nuk veprojnë me të vërteta, por me imagjinata. Ata nuk e kuptojnë se edhe puna, tregtia, drejtimi kanë rregulla të caktuara sikurse bota fizike. Si të tillë, ata presin deri sa uji të vlojë në pesëdhjetë gradë dhe fajësojnë ujin pse nuk vlon. Ia hedhin fajin gotës.

Këtu shfaqet mekanizmi i kundërshtimit, që funksionon mjaft mirë tek njeriu.

Nefsi...

Ankesat e nefsit në fakt janë ankesa ndaj vetes...

Ka shumë njerëz sot, obeziteti i të cilëve është kthyer tashmë në një sëmundje dhe e gjithë bota diskuton për një problematikë të tillë, e cila është kthyer në një politikë të kohës.

Ku qëndron problemi?

Të dëgjosh thirrjen e nefsit që të thotë "Ha!", megjithë thirrjet e mendjes, të shpirtit, të mjekëve dhe dietologëve apo njerëzve fjalëdrejtë, që të thonë përherë "Mos ha!" Njeriu ha fshehurazi prej mjekëve. Ha fshehurazi nga bashkëshortja. Në fakt, ata që të thonë "Mos ha!", nuk kanë ndonjë qëllim të keq ndaj teje. Përkundrazi, në të

mirën e shëndetit dhe të jetës tënde të thonë, por mentaliteti është i njëjtë: "Sidoqoftë, nuk ndodh ndonjë gjë e madhe!... Ç'të ha është qar!... Si ai që hëngri, si ai që nuk hëngri, që të dy vdiqën..."

Në jetën e tij sociale në rrethin e punës, njeriu e ka për detyrë të dijë detyrimet e veta, aftësitë, mundësitë, fuqitë përkatëse dhe kreditë. Duhet ta dijë mirë punën e tij, pa u zhytur në imagjinata, në mënyrë që edhe llogaritë të dalin me sukses dhe jo t'u kthehet sërish nga fillimi. Edhe kur është fjala për të mbajtur trupin në formë, këtë nuk duhet ta bëjë me zor, me shpjegimet e mjekut, i fshehur nga gruaja, përkundrazi, duke besuar në vullnetin e tij dhe me dëshirë, në mënyrë që të arrijë në qëllimin që dëshiron. Puna është të mos dëgjosh thirrjet që bien në kundërshtim me nefsin... Të bëhesh i shurdhët ndaj tyre...

Sëmundja e të ngrënit dhe natyrshëm edhe vdekja, nuk vijnë menjëherë, prandaj edhe njeriu i sheh si diçka të largët. Kur njeriu është duke ngrirë në të ftohtë të furishëm, nefsi i thotë "Fli!", por, nëse do flerë, do vdesë... Ka

edhe nga zërat që të thonë "Aman, mos fli!" që duket sikur njeriu e ofendojnë. Dhe në përgjigje u thotë: "Nëse do vdes, le të vdes, dua të fle!" Ka edhe raste kur të detyruar, njerëzit që janë në këtë gjendje i godasin dhe nuk i lënë të flenë, pasi kjo është edhe metoda. Edhe në ushtri ndodh një gjë e tillë.

Në një ngricë të madhe të Ankarasë, ushtarët nuk nxirrshin në stërvitje, por ishte një garnizion që dilte. Në krye të garnizionit qëndronte një oficer i shëndetshëm 90 – 100 kilësh. Që pa gdhirë, kishte ngrënë një pjatë supë të yndyrshme dhe nuk kishte të ftohtë. Ndërsa ushtarët kishin ngrënë supë të payndyrshme, të hollë si uji. Mërdhinin aq shumë, sa dridheshin. Qëndronin të hipur mbi kuaj. Ishin duke ngrirë, por askush nuk mund të thoshte se mërdhinte.

Më në fund, dikush i kuptoi ushtarët, por si! Siç ishte hipur mbi kalë u rrëzua në tokë. Vetëm atëherë e kuptuan se ushtarët mërdhinin dhe ndaluan aktivitetin ushtarak. Ushtarët nuk u çuan menjëherë në një vend të ngrohtë. I sollën në vendin e kuajve. Nuk ishte shumë ngrohtë. Temperatura ishte mesatare. Një vend që ngrohej me frymën e kafshëve. Kur nisën të ngroheshin, filluan të ndjenin edhe dhembje. Kjo situatë zgjati për 20 minuta. Sikur ushtarët të dërgoheshin direkt në një vend të ngrohtë, nuk do të mund ta përballonin nxehtësinë. Sikur t'ua linin në dorë atyre, menjëherë do të preferonin një vend të ngrohtë. Kjo, për arsye se njeriu nuk i di nevojat e trupit, nuk i di se deri ku shkojnë parametrat e tij.

Kush nuk ka dijeni, duhet të dëgjojë atë që di... Kjo arrihet me modesti... me durim... Duhet të dijë që: "Allahu e lartëson atë që është modest." (Hadith)





Edison Çeraj

TRANSPLANTI IDEOR

Era e ndryshimeve të fundviteve '80, të shekullit XX, që preku Europën Lindore, nuk mund të mos shkaktonte turbullime dhe ndryshime edhe në hapësirat shqiptare, qofshin pjesë e shteteve ballkanike apo në Republikën e Shqipërisë. Ndryshimet që po ndodhnin, ngjallën shpresat e masës së përvuajtur të njerëzve për hedhjen pas të së shkuarës 45-vjeçare dhe fillimin e një ere të re për të ndërtuar dhe jetuar jetën me dinjitet në vendin e tyre, në kombin e tyre. "Liri – Demokraci", "Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europa", e plot slogane të tjera, ngrinin dhe mbanin gjallë shpresat për një Shqipëri ndryshe, ku dinjiteti i gjithësecilit si qenie njerëzore dhe jo si një kavie apo levë, do të vendosej përputhshmërisht me meritokracinë dhe jo nëpërmjet sistemit të patronazhit, nepotizmit, nomenklaturës politike. Transformimet ishin jo të lehta, madje një operacion i vështirë që s'mund të shmangej. Axhenda e klasës politike, sidomos pas makabritetit '97, u përcaktua integrimi euroatlantik. Rotacioni i 2005-ës e përforcoi edhe më tej këtë prirje, e cila përbënte dhe vazhdon të përbëjë një sfidë të hapur për klasën politike të Republikës së Shqipërisë. Në emër të integritimit europian janë ndërmarrë dhe vazhdojnë të ndërmerren reforma, në mënyrë që të përplotësohen standartet e kërkuara nga organizmat e BE. I gjithë kuadri ligjor vazhdon të përafrohet me kuadrin ligjor të vendeve të BE, që janë më të zhvilluar dhe përpëruar në këtë drejtim dhe jo vetëm. Duke shpresuar në ecjen me hapa galopantë drejt përafërimit me vendet

e zhvilluara të Europës Perëndimore, janë sjellë dhe vazhdojnë të importohen praktika të cilësuar si më të përparuarat dhe më bashkëkohoret, duke synuar kështu implementimin e një sistemi që do të jetë dorëzanë për respektimin e dinjitetit të njeriut dhe meritokracinë. Deklarata, konferenca, takime të vazhdueshme thuhet e mbahen vetëm e vetëm për të na përforcuar bindjen dhe sigurinë se jemi në rrugën e duhur të ngritjes së sistemit të sipërpërmendur. Aq të shpeshta dhe magjepsëse janë këto deklarata, sa që shpeshherë dhe jo rrallë të duket se vërtet këtu, në këtë vend, meritokracia është në kulmin e lulëzimit. Kështu, ajo çfarë në të vërtetë është ngritur në sistem, për këdo që dita më ditë është në kontakt direkt apo indirekt me sistemin, është kryekëput tjetërfarë nga sa përçohet gojarisht. Duke synuar përputhshmërinë me praktika më të avancuara, në vend të meritokracisë dhe efikasitetit që buron prej saj, kemi përçafur shabllonizmin dhe artifica të nduarduarshme që përdoren dhe instrumentalizohen makiavelisht prej atyre që kanë të drejtën e marrjes së vendimeve dhe e gjithë kjo e fundit, në emër të përmbushjes së standardeve që do të na hedhin në prehërin e integritimit dhe lartësimit të dinjitetit si individë dhe si komb. Jo më larg se 20 – 25 vjet të shkuara besuam se ishim fanar ndriçues i socializmit në botë, sot besojmë se po demokratizohemi gjithnjë e më shumë mbi themelet 45-vjeçare dhe qerrestesë së brishtë demokratike.



Çfarë kongresi është haxhi?

Nuredin Jëlldëz

Ta prezantosh haxhin si kongresin e madh të myslimaneve, nuk është plotësisht e saktë. Në radhë të parë, argumentimi i këtij kongresi është pothuajse i pamundur. Nëse e kanë fjalën për Arafatin si kongres, në Arafat, përveç Haxhit të Lamtumirës, nuk është zhvilluar asnjë kongres tjetër. Nëse e kanë fjalën për ndonjë kongres shpirtëror, atë kongres myslimanët e zhvillojnë pesë herë në ditë. Për të lavdëruar haxhin, nuk ka nevojë ta prezantojmë si kongres. Në të vërtetë, cilësia pastruese që e bën njeriun sikur të ketë lindur përsëri prej nënës, e lartëson haxhin në mënyrë automatike, pa pasur nevojë për cilësi të tjera. Ai është një e pesta e fesë dhe e bën myslimanin të ripërtërihet dhe të ngrihet individualisht.

Ta shohësh haxhin ose umren në këtë mënyrë, pra ta ngushtosh funksionin e tyre thjesht në takimin e myslimaneve me njëri-tjetrin në Mekë dhe Medine, nuk plotëson as takimin, por nuk të jep as mundësi të realizosh qëllimin e vërtetë të haxhit dhe umres. Po! Haxhi dhe umreja, janë evenimente që i japin besimtarit mundësinë për t'u rinovuar dhe shkundur nga gjynahet. Mundësi kjo që besimtari nuk mund ta ketë në vendin e vet. Dhe kështu duhet të jetë. Mirëpo, kjo duhet të realizohet përballë Qabesë ose në qetësinë madhështore të Ravzës¹ dhe jo në hollat e hoteleve, në pazare e qendra tregtare.

Nëse besimtari arrin të qëndrojë vetëm për vetëm me Allahun, në një vend ku ka shkuar si mysafir i Allahut, do të thotë se ka bërë punën më të mirë. Besimtari, i

1. Vendi midis varrit të Profetit tonë (a.s.) dhe minberit që ndodhen në xhaminë e Profetit në Medine.

cili pastrohet nga gjynahet dhe kthehet në vendin e vet me energji të reja, është besimtari më i fituar. Për shkak të mentalitetit të kongresit, gjatë kryerjes së haxhit apo umres bëhen edhe gabime të rënda që mund të qortohen. Edhe pse dy haxhinj që bisedojnë me zë të lartë pranë Ravza-i Sherifit, mund të thonë se "janë takuar si dy anëtarë kongresi", vallë si do t'i komentojnë ajetet e para të sures el-Huxhurat? Shkujdesja që të çon në përgojim, shpërdorimi i kohës nëpër hotele e pazare etj., regjistrohen nga ana e melekëve si punët e ulëta të mysafirëve të një vendi të lartë.

VEESHJA E HAXHIUT

Allahu Teala, kur i fton besimtarët, madje edhe në xhamitë e fshatrave të tyre, i urdhëron të vijnë të stolisur. Pra të shkosh qoftë edhe në xhaminë e lagjes i veshur sa më bukur dhe sa më mirë, është urdhër i Allahut.

Besimtarët që nuk e kanë për gjë të shkojnë me veshjet që flenë gjumë në Qabe, që është kibla e të gjitha xhamive dhe Ravza-i Sherife, që është vendi më i mbushur me emocione, vallë çfarë kuptojnë me konceptet edukatë dhe madhështi? A nuk të bën të habitësh fakti që ata shkojnë pranë Allahut dhe të dërguarit të Tij me veshje, të cilat një njeri nuk do t'i vishte kurrë edhe në një dasmë në fshatin e tij?

Mbrojtja e parë që do të bëjnë ata, të cilët do t'i përgjigjen kësaj pyetjeje, është ankesa ndaj të nxehtit. Por nxehtësia nuk mund të pranohet si shkak i çrregullsisë së tyre, sepse, sipas kushteve të motit, gjenden edhe veshjet e duhura, por ato kurrë nuk mund të jenë këmbisa nate.

SHEJTANËT E MEKËS

Myslimani, i cili kur ndodhet në vendin e vet strehohet tek Allahu prej shejtanit të mallkuar, kur shkon në Mekë për haxh apo për umre, nuk shkon në një vend të ruajtur nga shejtanët. Përkundrazi, shejtani që vjen nga thëllësitë e historisë dhe me projektet e duhura sipas vendeve, pret me padurim t'i shtjerë haxhinjtë dhe umrexhinjtë në rretën e kurtheve të tij. Myslimani që shkon në haxh apo umre pa e kuptuar këtë logjikë, mund të kthehet me humbje të madhe nga një vend në të cilin ka shkuar për të bërë investime të mëdha.

Në ato vende, syfaqësia dhe mburrja, janë dy nga taktikat të cilat shejtani i përdor më shumë. Reklamat e ekzagjeruara të firmave turistike, të cilat ua bëjnë haxhinjve haxhin të pranuar që pa u nisur, bëhen shkak që myslimanët ta shohin veten pa probleme dhe të mos ruhen shumë nga gabimet. Ky mund të jetë edhe fillimi i këtyre kurtheve të shejtanit.

Edhe fiksimi pas ngjyrave dhe veprimave të njerëzve, pra, interesimi ndaj vlerave të tjera në vend të veshjes njëngjyreshe të ihramit në Meke, mund të jetë sinjal për një kurth të tillë. Vizitorët e haxhit dhe umres, duhet të dinë se interesimi ndaj pazareve dhe humbja e kohës me gjërat e ndryshme që ndodhen atje, nuk janë prej gjërave që ata duhet të bëjnë... Myslimanët që vizitojnë Mekën dhe Medinën, duhet të bëjnë vizita në vendet historike, në varrezat e shehidëve dhe në vendet ku kanë ndodhur luftërat që historia islame i ka shkruar me germa të arta. Mirëpo, këto vizita nuk janë as farz dhe as sunet. Mbase për vizitën e xhamisë Kuba mund të themi se është sunet. Mbase edhe vizitën e varrezës Baki mund ta gjykojmë si sunet. Por as këto dy vende nuk mund të krahasohen me faljen e namazit me xhemat në njërin nga xhamitë e shenjta dhe nuk duhen bërë shkas që të humbet ndonjë namaz me xhemat në ato xhami.

Nuk ka ndonjë rit adhurimi që thotë të vizitosh malin e Uhudit dhe të bësh foto për kujtim! Pas faljes së teravive në Mekë nën atmosferën e Ramazanit, të ulesh e të bësh muhabet kurbeti të përzier gra e burra, është një kurth i hapur i shejtanit. Arsytimi i këtij veprimi me muhabet mes vëllazërisë së haxhit dhe umres, nuk e ndryshon përfundimin. Edhe koha që harxhohet në qendrat tregtare, është prej kohës që duhet të harxhohet në Haremin Sherif, konsiderohet shumë e dëmshme.

HAXHIU DHE UMREXHIU DUHET TË DINË SE:

1- Atje duhet të marrin me vete ndonjë libër, me qëllim

që ta lexojnë për t'u çlodhur.

2- Duhet të marrin me vete librin e duave dhe dhikreve dhe ta lexojnë atë vazhdimisht.

3- Në Qabe duhet të bëjnë shumë tavaf.

4- Në Medine, gjuha e tyre duhet të rrijë e lagur me salavate.

5- Si në Mekë, si në Medinë, duhet të lexojnë vazhdimisht Kuran.

6- Brenda kufijve të Mekës dhe Medinës duhet ta harrojnë gjuhën e tyre dhe të përpiqen që të mos flasin për gjëra të kësaj bote.

7- Veçanërisht punëve që janë sunet, duhet t'u japin më shumë rëndësi. Ata duhen t'i zbatojnë me përpikëri të gjitha sunetet, që nga hyrja në ihram e deri tek hyrja në xhami.

8- Duhet të qëndrojnë larg tregtisë dhe pazareve.

9- Në Haremin Sherif nuk duhet të hyjnë me telefon.

10- Duhet të largohen nga veprimet që prishin unitetin e umetit islam, siç janë debatet mbi ndryshimet në medhhebe etj.

11- Nuk duhet të harrojnë se në Mekë, sevapet shkruhen të shumëzuara me njëqindmijë. Gjithashtu, nuk duhet të harrojnë se edhe gjynahet mund të shkruhen të shumëzuara me njëqindmijë.

12- Besimtari që nuk i ngul sytë në vend tjetër përveçse në Qabe, do të kthehet në vendin e tij i fituar dhe i padëmtuar.


13- Nuk duhet harruar se në Mekë, Medinë dhe zona të tjera, lëndimi i njerëzve dhe haku i robit janë shumë të rrezikshme.

DUAJA DHE MEKA

Si mund të mendojmë që duaja të jetë më e dashur për njeriun në një vend tjetër, aq sa është në Mekë dhe Medinë? Madje, mund të themi se është pak edhe nëse në Mekë dhe Medinë shkohet duke ecur vetëm për të bërë dua. Ato janë pikërisht vendet e duave. Prandaj, jemi të detyruar që duanë në Mekë dhe Medinë ta shohim më të rëndësishme.

Në Mekë dhe Medinë, nuk ka asnjë dua që nuk mund të bëhet. Duatë më të bukura janë ato që bëhen për nevojat, hallet dhe ankesat. Gjuha nuk është aspak e rëndësishme. I rëndësishëm është sinqeriteti dhe emocioni dhe, në vend të duave të gatshme, duhet të preferohen duatë që vijnë nga zemra.

*Haxhi dhe umreja,
janë evenimente që i japin
besimtarit mundësinë
për t'u rinovuar dhe shkundur
nga gjynahet. Mundësi kjo
që besimtari nuk mund ta ketë
në vendin e vet.*



CILI ËSHTË USHQIMI I SHPIRTIT?

Dr. Ali Akben

Të gjitha fetë kanë ritualet e tyre të adhurimit. Megjithëse ritualet në fjalë ndryshojnë nga njëri-tjetri, askush nuk mund ta mohojë se ato unifikohen në një qëllim, adhurimi i një fuqie të mbinatyrshme. Adhurim do të thotë të dorëzohesh, të kërkosh. Emëruesi i për-bashkët i botës sonë shpirtërore dhe mendore është nxjerrja në pah e bukurive të shpirtit dhe akteve të bukura. Parakushti themelor i namazit, shtyllës së fesë islame, nëpërmjet të cilit besimtari takohet me Zotin e tij, është abdesti. Pra, është pastrimi. Me pak fjalë,

abdesti është larja e organeve të caktuara të trupit, me qëllim pastrimin fizik dhe shpirtëror.

Në të vërtetë, gjatë marrjes abdest, me larjen me ujë dhe fërkimin e organeve të trupit, siç janë duart, këmbët, koka, qafa, fytyra dhe veshët, njëkohësisht ne i mundësojmë trupit lëshimin e hormoneve që janë shumë të vlefshme për sistemin nervor dhe u bëjmë një lloj masazhi atyre pikave të trupit që janë edhe pikat e metodës së njohur qetësuese me origjinë nga Lindja e

Largët, e quajtur akupunk, duke e bërë trupin tonë më të shëndetshëm dhe më vital. Në këtë mënyrë, pakësohen edhe dhimbjet fizike dhe shqetësimet tona.

Namazi fillon me thirrjen e ezanit, që ka kuptimin e ftesës. Pa të mendojmë një çast ndryshimin që pësojnë ndjesitë tona së bashku me ezanin, thirrjen për kryerjen e namazit, i cili ka një dimension universal. Shkëndijat brenda nesh në gjendjen tonë shpirtërore, shtohen dhe pakësohen në varësi të ndryshimeve tona të brendshme që godasin brenda shpirtit si rrufe të njëpasnjëshme. Bukuritë dhe gjërat e shëmtuara.

Me namazin, shtyllën e fesë islame, dritën e syve të besimtarit, fillimin e çdo veprë të mirë, çelësit të mirësisë, bukurisë, paqes dhe dashurisë, njeriu mund të ndryshojë këndin e shikimit në horizont dhe të pozitës së tij shpirtërore, duke u ngritur nga nefsi emare në nivele dhe shkallë më të larta. Gjatë këtij ndryshimi, njeriu përjeton një situatë të kthimit të gjërave përmbys, veçanërisht në aspektin psikologjik. Kjo situatë përmbysjeje i jep mundësinë njeriut që ta formatojë veten e tij pesë herë në ditë, në kushtet e një jete të mbushur me stres dhe me situata shumë të turbullta.

Për këtë arsye, pararendësit e platformave të ringjalljes shpirtërore me anë të namazit shpërvolën mëngët në vendin dhe në kohën e duhur për të mjekuar miliona njerëz të sëmurë në shpirt, pasi u kishin dhënë diagnozën e duhur. Po, është e vërtetë që ringjallja e shpirtit arrihet vetëm me anë të namazit. Madje, jo vetëm prej sëmundjeve shpirtërore, por njeriu mund të shpëtojë edhe prej defekteve trupore dhe atyre mendore me anë të namazit.

Namazi, agjërimi apo haxhi, nuk ka asnjë dallim mes tyre. Secilën prej tyre, myslimani e kryen për arsyen e vetme se Zoti e ka urdhëruar t'i kryejë ato. Në qoftë se një adhurim nuk kryhet si ibadet i fesë, por për qëllime shëndetësore, atëherë ibadeti i kryer e dëmton personin më shumë sesa i bën mirë. Për këtë arsye, ne myslimanët e kryejmë adhurimin e namazit dhe adhurimet e tjera vetëm se Zoti na ka urdhëruar t'i kryejmë

ato dhe për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Teksa kryejmë detyrat tona, po ashtu me anë të begatisë së mendjes dhe logjikës që na ka dhuruar Zoti, ne hulumtojmë urtësitë e adhurimeve dhe, duke marrë mësim prej tyre, e falënderojmë Zotin. Kështu, në qoftë se do t'i hedhim një vështrim të shkurtër marrëdhënies namaz-shëndet nga ky këndvështrim logjik, do të arrijmë të shohim lehtë shumë lidhje fizike mes tyre. Namazi është tërësia e veprimeve madhështore që e ndihmon çdo organ të trupit tonë të funksionojë në mënyrë të rregullt. Për shembull, në trurin e personit që e vendos ballin në tokë gjatë sexhdes tetëdhjetë herë në ditë, shkon më shumë gjak; kjo falë edhe forcës së gravitetit. Për këtë arsye, qelizat e trurit ushqehen më mirë dhe dukuritë si harresa, humbja e kujtesës dhe prishja e personalitetit, hasen më pak te personat që falin namaz. Përshpejtimi i rrjedhjes së gjakut në tru dhe fakti që truri merr më shumë oksigjen, e ruajnë trurin si të ishte i veshur me korracë ndaj shumë sëmundjeve nervore, siç është edhe trenimi.

Në mjekësinë parandaluese të sëmundjeve u jepet shumë rëndësi lëvizjeve të trupit që kryhen në kohë të caktuara. Kohët e namazeve janë kohët më të përshtatshme për rifreskimin e qarkullimit të gjakut dhe të shtimit të oksigjenit që thithim me mushkëri. Mjekësia parandaluese e sëmundjeve sapo ka nisur të kuptohet mirë në mjekësinë e sotme moderne, ndërsa këshillat e profetit tonë Muhamed, në lidhje me mjekësinë parandaluese të sëmundjeve të periudhës së tij, nuk janë kuptuar ende plotësisht.

Namazi është një nga faktorët që rregullon edhe gjumin. Në të vërtetë, sahati biologjik i njeriut është i kurdisur sipas kohëve të namazeve...jeta që fillon bashkë me namazin e sabahut, përfundon me namazin e jacisë për t'u programuar kështu dita e nesërme. Ky rregull është një fillim i mbarë për shëndetin dhe vitalitetin tonë fizik dhe na përgatit për të dy botët, duke na hijeshuar shpirtërisht.

Pas gjithë këtyre rreshtave mund ta pohojmë pa drojë se: namazi është ushqimi i shpirtit.





Mos bëj që ta humbim afritetin me

Rabia Christine Brodbeck

Jemi të kënaqur për ujin e ndotur. Megjithatë, në jemi ftuar të pimë nga biseda e velive, nga burimi më i kthjellët.

Hazreti Rumi ka thënë: "Çdo bisedë, përveç bisedës me Zotin e Madhëruar, është një vuajtje e vërtetë. Është vuajtje të shkosh drejt vdekjes dhe të mos pish ujin e jetës."

Në Natën e Miraxhit u bë një bisedë mjaft interesante, e cila shfaqti një thesar të pashtershëm të muajit të mrekullueshëm të Ramazanit. Zoti i Madhëruar e ka pyetur Profetin tonë të dashur (s.a.s.): "A e di se çfarë shpërblimi do t'ju jap njerëzve të mi që kanë zgjedhur të qëndrojnë të heshtur?" Resullahu iu përgjigj: "Nuk e di, o Zoti im!" Atëherë, Zoti i tha: "Është urtësi të agjërosh, të heshtësh dhe të mos flasësh. Kurse trashëgimia e urtësisë është një dituri e fshehtë. Fundi i diturive të fshehta është të qenit pranë Meje. Për atë njeri që flijon veten e tij për respektin Tim dhe për të fituar kënaqësinë Time, kam tre shpërblime: do t'ju jap një mendje të tillë, që ai nuk do të harrojë më. Do t'ju jap një dashuri të tillë, që nuk do të dashurojë asgjë tjetër përveç Meje."

Zemra e njerëzve të Mi do të mbushet aq shumë me dashuri ndaj Meje, sa që nuk do të ngelë vend për diçka tjetër. Ata që më duan Mua, edhe Unë do t'ju dua. Madje, do të bëj të mundur që ata t'ju dojë edhe populli. Ata do t'ju bëjnë mbretër të zemrave."

Mbi të gjitha, para se të fitojmë një status që të meritojmë ndihmën e Tij, para se të na drejtojmë në rrugë të drejtë, para se të arrijmë në gjendje që të meritojmë të kërkojmë diçka prej Tij, duhet të pyesim veten: ku e kemi nevojën për botën e amëshuar? Ku e kemi nevojën për shijen hyjnore? Ku e kemi nevojën për t'ju bërë dhe, për t'ju asgjësuar, për të shtypur egoizmin? Ku është dashuria, ashku dhe përmallimi ynë për Ty? O Zoti ynë, Ti nuk dërgon dhunti pa u ndjerë nevoja. Hz. Pejgamberin (s.a.s.), e paske urdhëruar që të trokasim në derën e urisë. Pikësëpari, kemi nevojë të ëndërrojmë shijen e pakrahasueshme të xhenetit, kemi nevojë të bëjmë bisedë të sinqertë me Ty, kemi nevojë të shohim qeniet e bukura engjëllorë.

Jeta me besim është ajo që kihet frikë nga rreziku i humbjes së afritetit me Zotin e Madhëruar.

Të humbim pëlqimin dhe kënaqësinë e Tij! Ndaj, ne duhet të jemi të zënë gjithnjë me të metat tona dhe të ndjejmë pendesë. Zoti ynë, na jep zakonin të jemi njerëz që bëjmë gjithnjë istigfar dhe dhikër. Që ta kujtojmë kur harrojmë dhe të pendohemi kur bëjmë gabime.

Zoti ynë, na bëj të kemi nevojë për Ty! Kur do të kuptojmë pamundësinë, paaftësinë, pafuqinë tonë përballë Madhështisë dhe Mëshirës Tënde? Kush tjetër përveç Teje, do të na e bëjë të ditur se e vetmja gjë që kemi nevojë je vetëm Ti? Zoti ynë, na bëj të mundur ta kuptojmë, ndjejmë dhe shfaqim nevojën për Ty. O Zot, bëna të mundur të pranojmë aq sa mundemi nevojën për Ty, si krijesa të Tua. Duke e ditur se Ti je i vetmi i fuqishëm, Aziz, Xhelil dhe Kahhar, si mund t'i bëjmë ibadet dikujt tjetër? Si mund të duam tjetër përveç Teje, si mund t'i frikësohemi tjetër dikujt përveç Teje? Ti je rrugëzgjdhja e çdo problemi, Ti je ai që na mbron nga rreziqet dhe nga shejtani, si mund të kërkojmë ndihmë nga tjetër kush përveç Teje?

Ti shoqëron të vetmuarit, Ti u jep fuqi endacakëve, varfërisë sonë i jep nga pasuria Jote, shqetësimeve u jep zgjidhje, difiçitet tona i plotëson. Me mëshirën dhe dhembshurinë Tënde të pakufishme, lotët u bënë pasuria jonë, dobësia u bë zburimi ynë, dhimbja u bë shërimi ynë, gabimet u bënë sevapet tona, përçmimi u bë pasuria jonë, robëria u bë nderi ynë, të metat u bënë shpëtimi ynë.

A nuk e mësuam se të qarit është pasuri, që nga koha e babait të njerëzimit, Hz. Ademit (a.s.)? Të gjithë jemi fëmijët e tij! Po pyes veten: a e ndjejmë brenda zjarrin e ndarjes? A na manifestohen frymëzime hyjnore si të atij? A e ndjejmë entuziazmin e pakufishëm për t'i bërë ibadet Allahut dhe për ta dashur Atë? A nuk e shikojmë se rruga për të mbërritur te Zoti i botëve është e shtruar me pendimin, turpin dhe istigfarin? Kur do ta vërejmë se nuk e ka bërë një njeri që është i syrgjynosur në shkretëtirën e qenies, që është bërë shembull për të gjithë të dashuruarit që janë zbritur nga xheneti. Mevlana Xhelaledin Rumi ka thënë: "Dijeni se keni vlerë për aq sa frikësoheni. Ndaj dhe zemra e ashikëve është më e madhe se froni hyjnor." O Zot, ktheje në të vërtetë falsitetin tonë. Bëna të mundur t'i përhapim lotët e pendesës dhe dashurinë e zjarrtë të Hz. Ademit (a.s.), që u detyrua të ndahet.

O Zot, thyena kafazin e qenies, pengona nga shqetësimi i angazhimeve të përkohshme të botës, nga dëshira tokësore dhe nga dashuria për dynjanë.

Largona nga tundimi i egoizmit. Bëna që të arrijmë në prehje shpirtërore, qetësi dhe çlodhje. Dua aq shumë të largohem nga egoja ime, ta braktis atë, të jap gjithçka që ka të bëjë me të, të kaloj në trans kur bëj ibadet, ta bëj veten të vdekshme kur lutem. Dua të shmangem nga egoja ime dhe të dëgjoj heshtjen e zemrës sime. Çasti që ndihem më mirë dhe më e qetë është çasti kur Ty të bëj sexhde. Atëherë lëvizja përfundon, bota qetësohet, gjithësia më kaplon. Fshihemi në gjirin e dhembshurisë së pafundme dhe të strehës së singërtë.

Namazi... Kur kryejmë këtë ibadet universal, jemi ne ata që i japim hapësirë dhe kohë. Jemi ne ata që shtojmë apo pakësojmë vlerën e tij. Kurrë të mos harrojmë, jemi ne ata që kryejmë detyrën. Duhet të jemi mjaft të kujdesshëm. Në këtë ibadet, i cili është ibadeti më i përsosur, arrijmë në vendin më të afërt me Prehjen Hyjnore dhe shijojmë në maksimum kohën më me vlerë të të qenit në Audiencën Hyjnore. Kështu duhet të mendojmë mbi shenjat (ajetet) hyjnore, duhet të zgjerojmë horizontin tonë të vetëdijes hyjnore, duhet të hapim kraharorët tanë dhe të marrim frymë drejt pikave më të thella, duhet t'i përdorim këto mjete deri në pikën maksimale të tyre. Duke dhënë veten me gjithë shpirt, arrijmë në Audiencën Hyjnore.

Kuptimi i mihrabit është drejtimi nga i dashuri. Kibleja e të pafeve është një sofër e bollshme; kurse kibleja e besimtarëve je Ti! Dëshirojmë që Ti të jesh mendimi ynë i vetëm, dashuria e vetme, qetësia e vetme, drejtimi i vetëm. Dëshirojmë që të na e shtosh dashurinë dhe entuziazmin kur kryejmë namazin, si ibadetin më të mrekullueshëm dhe të na e shfaqësh dashurinë, duke u drejtuar nga Qabja, Shtëpia Jote e shenjtë dhe jo të të duam përmes fjalëve dhe duave. Duam të arrijmë në vendin ku do të takohemi përjetësisht me Ty, duke pritur me padurim namazin e radhës.

Njeriu i veçantë i Zotit, Rabia Adevijje, ka një fjalë të shquar: "Qenia jonë është një gjynah i madh, sa që të gjitha gjynahet mbesin të vogla kur krahasohen me të."

I Dërguari i Zotit, Muhamedi (a.s.), ka thënë: "Çdo njeri është ushqim për zjarrin, përveç vendeve të sexhdes." Në Kuran thuhet: "**Pastaj e çuam atë** (kur nuk beson) **në gjendjen më të ulët.**" O Zot, të gjithë kemi faje dhe borxhe, ndaj dhe jemi njerëz. Bëna të mundur të kuptojmë gabimet tona, të metat tona, nivelin tonë të ulët, paaftësinë tonë dhe shkujdesjen tonë dhe na ndihmo të shtojmë vlerën tonë dhe të shpëtojmë nga gjendja e poshtëruar dhe e ulët ku gjendemi dhe bëna të mundur të arrijmë fisnikërinë, vlerën dhe lartësinë e vërtetë të njerëzimit.

O Zot, nëse pluhuri i këmbëve të të Dashurit tonë (s.a.s.), është i mjaftueshëm, nëse pluhuri i gjurmëve të këmbëve të pejgamberëve ka mjaftuar të ndriçohet shpirtërisht Mevlana, njëri nga njerëzit më të veçantë të Zotit, çfarë do të thotë për ne një gjë e tillë? O Zot, na ndihmo ta shkatërrojmë kafazin e qenies sonë, të bëhemi pluhur të pragut të derës Sate dhe të bëhemi pluhuri i gjurmëve të këmbëve të të dashurit Tënd (a.s.).

Muhidin Arabiu (k.s.), ka thënë: "Për ata që i kushtojnë vëmendje botës materiale, jeta i ngjan ujit të detit: sa më shumë të pijnë, ndjejnë etje dhe sa më shumë që ndjejnë etje, pijnë." A kanë një fund dëshira dhe ambicia për dynjanë? O Zot, ndihmona të arratisemi në drejtimin Tënd, të vrapojmë tek Ti, ndihmona t'i ikim tërheqjes që ka kjo botë vdekatare.

Në burim ekziston thesari i pashtershëm i dashurisë. Nuk ka kohë, nuk ka hapësirë, nuk ka individë, nuk ka objekt, nuk ka përdim, nuk ka lindje, nuk ka fillim, nuk ka fund, nuk ka formë, nuk ka ngjyrë, nuk ka ditë, nuk ka natë, nuk ka germë, nuk ka zë. Kur pijmë ujë nga çezma, mirësitë, dhuntitë do të rrjedhin vrullshëm mbi ne. O Zot, Ti je Fettah, Ti i hap ato që janë të mbyllura, lejona të hyjmë në vendin e shenjtë të afrimitetit Tënd. Ti je Kadiul-Huxhat, që zgjidh të gjitha problemet. O Zot, largona etjen përmes ujit nga burimi i kulluar, mos na lër pa ndihmë. "**Zoti i tyre do t'u japë të pinë pije të pastër.**" (Insan, 21)

*Jeta me besim
është ajo që kihet frikë
nga rreziku i humbjes së afrimitetit
me Zotin e Madhëruar.
Të humbim pëlqimin dhe kënaqësinë
e Tij! Ndaj, ne duhet të jemi
të zënë gjithnjë me të metat tona
dhe të ndjejmë pendesë.*

Rruga drejt shpresës

Durmush Koç

Jeta është e mbushur përplot me surpriza, nga fillimi deri në fund. Për ta kuptuar dhe për ta jetuar ashtu siç duhet atë, duhet të mbahesh fort pas pemës së shpresës. Të kapesh fort pas litarit të Allahut që vuajtjet, vështirësitë, dhimbjet, zhgënjimet dhe përpëlitjet, të cilat përjetohen gjatë gjithë jetës, të mos na bëjnë të pashpresë në rrugën drejt Allahut. Gjemb i është zbulurim i trëndafil, vuajtja është boja shpirtërore që i jep kuptim jetës, ndërsa shpresa është kapitali i paçmueshëm i jetës.

Duhet të dimë se aty ku shpresa është duke humbur, dalin në pah shumë shpresa të reja. Ashtu siç kërcasin rrufetë, siç bie shiu, siç rrjedhin lumenjtë, siç ecin retë dhe siç zogjtë rrahin krahët për të arritur në qëllimin e tyre edhe ne, me pasion dhe entuziazëm duhet të ecim drejt qëllimit tonë të vërtetë pa u lodhur dhe pa u lëkundur.

Edhe nëse rrëzohemi, edhe nëse vuajmë, edhe nëse ndonjëherë jemi të pasuksesshëm, kurrë nuk duhet të jemi të pashpresë. Ashtu siç kalbet fara për të çelur përsëri, siç çel pema lule për të dhënë fruta edhe ne duhet të përparojmë drejt qëllimit tonë me këmbëngulje dhe pa u ndalur.

Edhe nëse para nesh vendosen gurë, dalin male apo përballemi me armiq që na presin rrugën, edhe nëse në derën tonë nuk troket asnjë fllad mëngjesi, edhe nëse bilbilat nuk qëndrojnë kurrë në degën e pemës së shpresës sonë dhe të këndojnë, ne duhet të ecim përpara me shpresë. Ashtu siç nuk rritet një pemë menjëherë, siç nuk çel përnjëherë një lule, siç nuk ngrihet një ndërtesë në një çast dhe siç nuk bëhet burrë për një moment një fëmijë edhe ne duhet të përparojmë duke u munduar e përpjekur. Duhet ta dimë mirë se rruga e gëzimit dhe lumturisë kalon nga zjarri i vuajtjeve, nga deti i vështirësive dhe nga lotët e derdhur.

Nuk duhet të harrojmë se rruga drejt fitores ndodhet në besimin tek fitorja, rruga e suksesit, tek puna e palodhur dhe rruga për në shpëtim, tek nënshtrimi ndaj Allahut dhe mosrënia në gjendje të pashpresë. Lumturinë nuk mund ta arrijmë kurrë pa derdhur djersë, pa na shpuar ndonjë gjemb, pa kaluar nga rrugët e vuajtjeve dhe pa luftuar në mënyrë të dhimbshme në këto rrugë. Britmat, errësirat verbuese, furtunat dhe kurthet tinëzare nuk duhet të na mposhtin kurrë dhe as të na frikësojnë. Duhet të marrim mësim nga peshqit që luftojnë me dallgët në oqeanet e stërmëdhenj, nga pulëbardhat që përleshën me furtunat në ajër, nga durimi i gjallesave që ngelin të ngujuara për një kohë të gjatë nën dëborë, nga përpjekjet e jashtëzakonshme të milingonave dhe sukcesi i tyre.

Shpresa është një thesar dhe kapital i pashtershëm i njeriut. Ai njeri që ka humbur shpresën, ka humbur gjithçka. Nëse duam që lulet të mos vyshken, që trëndafilat të mos qajnë, që manushaqet dhe luledet të mos hidhërohen, që zambakët të mos ulin kokën, që bilbilat të mos qëndrojnë mërziur në degën e trëndafil, që luleborës të mos i digjet shpirti, që gjumi i shkujdesjes të mos na rrudhë, që kryengritjet tona të brendshme dhe të jashtme të mos shpërthejnë si vullkan, që faja e dheut të mos përgjaket dhe që drita e syve tanë, fëmijët, të mos qajnë, duhet të ecim drejt shpresës me gjithë shpirt, me trup dhe me entuziazëm, duke mos u kthyer kurrë mbrapa. Në këtë mënyrë, do të realizohen shumë ëndrra dhe dëshira që kemi. Atëherë, kurrë të mos na mbarojnë dhe të mos na konsumohen shpresat. Le të vazhdojnë të rrjedhin si përrenj dhe burime. Në zemra le të çelin filiza të rinj shprese. Të mos qajnë as toka, as qielli, as gjithësia dhe as njerëzit. Le të shtohet e të buçasë brenda nesh dashuria, e cila i jep shpresë shpresës...



FAKTORËT QË LIGËSHTOJNË ZEMRËN

Mustafa Juna

Dijetari i famshëm Hasan El-Basriu, përmend gjashtë faktorë që ligështojnë zemrën: *“Bëjnë mëkate duke shpresuar për pendim. Mësojnë dituri, por nuk veprojnë sipas saj. Veprat nuk i kanë të sinqerta. Ushqehen nga mirësitë e Allahut, por nuk e falënderojnë Atë. Nuk janë të kënaqur me caktimin e Allahut. Varrosin të vdekurit, por nuk nxjerrin mësim nga vdekja.”* (Ibn Haxher El-Askalani, Munebbihat.)

Në terminologjinë fetare, sëmundja e zemrës nënkupton humbjen e shkëlqimit dhe ndjeshmërisë ndaj normave fetare, ngurtësimin e saj ndaj urdhrave dhe ndalesave të Allahut, për shkak të mëkateve.

Një zemër që është larg Allahut, i sjell probleme njeriut, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër, sepse një zemër që është larg mëshirës së Allahut është destinuar të bëjë një jetë të mjerueshme. Hasan Basriu (r.a.), përmend këta gjashtë faktorë në ligëshkrimin e zemrës, duke u tërhequr vëmendjen myslimanëve për rrezikun që përmbajnë.

NJERËZIT KRYEJNË MËKATE DUKE SHPRESUAR NË PENDIM

Pendimi është një nga dhuratat më të mëdha të Allahut për njeriun. Sepse pendimi pastron zemrën nga ndotja dhe ndryshku duke e nxjerrë atë nga errësira në dritë, nga humbja në udhëzim. Pendimi e pastron besimtarin nga të gjitha mëkatet.

Mosshfrytëzimi dhe mospërfitimi nga kjo mirësi e madhe e pendimit, më së paku është një marrëzi diabolike. Bërja e mëkateve, duke shpresuar te pendimi, është hapi i parë drejt sëmundjes së zemrës dhe, njëkohësisht, hapi i parë drejt xhehenemit. Pikërisht për këtë rrezik Allahu tërheq vëmendjen në Kuran: **“O njerëz! Premtimi i Allahut është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtroni kurrësesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtroni djalli për Allahun.”** (Fatir, 5.)

Allahu kërkon prej nesh të jemi vigjilentë ndaj kurtheve dhe dredhivave të shejtanit. Shejtani u afrohet besimtarëve sa majtas, djathtas për t'i devijuar nga rruga

e drejtë. Ai përpiqet t'i mashtrojë ata duke i ushqyer me shpresa të kota për shpëtim. Nga dredhitë e tij më të rrezikshme janë lajkat për të krijuar përfytyrime të shtrembëruara mbi mëshirën e pakufishme të Allahut, përmes së cilës i mashtron njerëzit, duke i bërë përfundimisht prej banorëve të xhehememit. Shejtani i josh njerëzit me fjalë të bukura, si: jetoje jetën ashtu si të vijë, jeta është ytja, prandaj shijoje sa të mundesh, se në fund Allahu me mëshirën e Tij të pakufishme do të të falë. Këto joshje janë thjesht iluzione.

Prandaj duhen njohur mirë dredhitë e shejtanit, për të mos u bërë pre e tyre. Besimtarët duhet të qëndrojnë sa më larg nga veprat e këqija. Kur gabimisht kryejnë ndonjë veprim të ndaluar, menjëherë duhet të vrapojnë për pendim, sepse asnjëherë nuk dihet se kur vjen vdekja dhe si të gjën.

MËSOJNË, POR NUK VEPROJNË SIPAS SAJ

Dituria është dritë që ndriçon errësirën, udhëzues për gjithë njerëzimin, recetë shpëtimi për botën tjetër dhe manual për veprim. Pyetjes se çfarë është dituria, Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj "udhërrëfyes i veprave". (F. Razi, Tefsiru El-Kebir)

Feja islame kërkon që dija të mësohet vetëm për hir të Allahut. Dituria duhet t'i shërbejë njerëzimit, jo vetëm në ngritjen materiale, por edhe shpirtërore. Nxënësit e dijes vazhdimisht lëvdohen në Islam. "*Kush del për të kërkuar dituri, Allahu i lehtëson rrugën për në xhenet.*" (Muslim). Por Allahu i dënon me forcë ata që, megjithë diturinë që kanë, nuk veprojnë sipas saj. Dija është përgjegjësi dhe, nga kjo pikëpamje, dijetarët duhet të jenë shembull për të tjerët, duke e bashkëshoqëruar diturinë me vepra të mira. Allahu e ka përngjasuar me kafshën që mbart libra, dijetarin që nuk punon me dijen e fituar. "**Shembulli i atyre, që iu besua Teurati, por pastaj nuk e zbatuan atë, i shëmbëllen gomarit, që vetëm sa i mbart librat. Sa i keq është shembulli i atyre që mohojnë shpalljet e Allahut! Allahu nuk i udhëzon (në rrugën e drejtë) keqbërësit.**" (Xhuma, 5.)

Sipas Fahrudin Raziut, gjendja e tyre që kanë dituri, por nuk veprojnë sipas saj, është si gjendja e devesë, e cila mbart ujë në shpinë, por që vdes në shkretëtirë

nga etja. Siç e shpreh edhe fjala e urtë "f'lu'l- ulema, delilu'l xhuhela"(Veprat e dijetarit janë argumente për injorantin), prandaj mospunimi sipas diturisë është një fatkeqësi e madhe për gjithë shoqërinë.

KUR PUNOJNË NUK JANË TË SINGERTË

Sinqeriteti është veti e njeriut që është i pastër nga zemra, që shfaqet ashtu siç është, pa shtirje. Kurse në terminologjinë fetare është kryerja e punëve vetëm për hir të Allahut. Pra, qëllimi i çdo lloj akti duhet të jetë kënaqja e Allahut. Nëse qëllimi nuk është i pastër, vepra ndotet nga hipokrizia, syfaqësia dhe përfitimi. Sinqeriteti është një veti e vyer që e mbron njeriun nga hipokrizia dhe hilet e shejtanit dhe për pasojë edhe nga dënimi i xhehenemit. "**Sigurisht, ju do ta provoni dënimin e dhembshëm dhe do të shpërbleheni vetëm sipas asaj që keni bërë! Kurse robërit e**

sinqertë të Allahut, do të kenë mirësi të caktuara dhe fruta të ndryshme e do të jenë të respektuar, në kopshtet e lumturisë" (Saffat, 38-43.)


Hipokrizia e dërgon njeriun në xhehenem.

USHQEHEN ME MIRËSITË E ALLAHUT, POR NUK E FALËNDEROJNË ATË

Falënderimi ndaj Allahut është shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi për mirësitë e dhuruara. E kundërta është mosmirënjohja, e cila është një vepër shumë e ulët përballë njerëzve, jo më ndaj Allahut.

Falënderimi është një mjet i rëndësishëm për shumimin e të mirave: "**Nëse tregoheni mirënjohës"** (Ibrahim, 7) **Unë do t'ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia. Ne i shpërblejmë ata që falënderojnë.** (El-Kamer, 35)

Falënderimi duhet të realizohet me gjuhë, me zemër dhe me shprehje. Falënderimi i gjuhës arrihet përmes përmendjes së mirëbërësit, falënderimi i zemrës arrihet përmes njohjes së Allahut dhe refuzimit të çdo lloj forme të shirkut, kurse falënderimi fizik arrihet përmes bindjes së organeve për të kryer urdhëresat dhe distancimit të plotë prej ndalesave. Muhamedit (a.s.), shpesh i enjteshin këmbët nga qëndrimi i gjatë në namaz. Kur shokët i thanë përse e mundonte veten kaq shumë, përderisa Allahu ia kishte falur të gjitha mëkatet, ai u përgjigj: "Pse të mos jem një rob që falënderon Allahun?" (Buhari)



Siç falënderon Allahun për mirësitë e dhëna, myslimani falënderon edhe njerëzit për të mirën që i kanë bërë. *"Kush nuk falënderon njerëzit, nuk falënderon as Allahun"* (Ebu Davud, 4811) *"Të mirën kthejani me të mirë, nëse nuk mundeni lëvdoni mirësinë e tij, sepse kush lëvdon mirësinë, ka falënderuar bamirësin dhe kush e fsheh mirësinë, është treguar mosmirënjohës."* (Ebu Davud, 4813)

Muslimani duhet të jetë i vetëdijshëm për vlerën e begatave që i ka dhënë Allahu. Ai nuk duhet të kryejë kurrë mëkate, përderisa ushqehet me to.

Falënderimi e shpëton zemrën nga zjarri i xeheneimit dhe e nxjerr nga vuajtja në gëzim. Gjuha, zemra dhe trupi që nuk falënderon, megjithëse biologjikisht janë gjallë, shpirtërisht janë të vdekura.

NUK JANË TË KËNAQUR ME CAKTIMIN E ALLAHUT

Muslimani duhet të jetë i kënaqur me atë që i ka caktuar Allahu. Ai duhet ta presë me qetësi çdo gjë që i vjen prej Allahut. Asnjëherë nuk duhet të mendojë diçka më të mirë se ajo që Allahu ka caktuar për të. **"O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ji i kënaqur me Atë dhe Ai do të jetë i kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!"** (el-Fexhr, 27-30)

Kënaqja me caktimin e Allahut është pasuria më e madhe e njeriut në këtë botë dhe botën tjetër *"kënaqu me atë që të ka ndarë Allahu, që të bëhesh njeriu më i pasur."* (Ibn Maxhe, 4217) Nga hadithi profetik mësojmë që pasuria e vërtetë nuk është pasuria materiale, por pasuria shpirtërore. Të preferosh pëlqimin dhe kënaqjen e njerëzve kundrejt asaj të Allahut, është shkak për vërtetëshkrim. Varja e shpresave te njerëzit, pa marrë në konsideratë caktimin e Allahut, është shenjë e besimit të dobët. *"Kush kërkon pëlqimin e Allahut kundrejt pëlqimit të njerëzve, Allahu nuk e lë në mëshirë të njerëzve dhe kush preferon pëlqimin e njerëzve kundrejt pëlqimit të Allahut, Allahu e braktis në mëshirë të njerëzve."* (Tirmidhi, Zuhd)

Muhamedi (a.s.), thotë: *"Kush është i kënaqur me Allahun si Zot, me islamit si fe dhe Muhamedin si Pejgamber, ka shijuar shijen e vërtetë të besimit."* (Muslim)

VARROSIN TË VDEKURIT, POR NUK MARRIN MËSIM PREJ VDEKJES

"Vdekja prej së cilës po ikni, do t'ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, i Cili e di të padukshmen dhe të dukshmen dhe Ai do t'ju njoftojë ju për atë që keni bërë." (El-xhuma, 8)

Vdekja është stacioni i parë i kthimit nga kurbeti për në atdhe. Çdo njeri që ndahet nga kjo botë për të shkuar në botën tjetër, do të ndalojë në këtë stacion. Në stacionin e vdekjes njerëzit vijnë së bashku me veprat e tyre. Nëse veprat janë të sojit të mirë, të pëlqyera nga Allahu, rruga për në ahiret është e lehtë dhe e sigurt, në të kundërt, rruga është e vështirë dhe vendmbërritja është skëterrë. Siç vihet re lehtësisht, nga ky stacion njerëzit nisen në njërën nga këto dy rrugë. Zgjedhja e rrugës është në vullnetin e lirë të njeriut. Për çdo gjallesë vdekja është e pashmangshme.

Ajo është caku i fundit në këtë botë.

Kohëmbërritjen e di vetëm Allahu, prandaj njeriu duhet të jetë i gatshëm për çdo të papritur.

Nuk duhet të marrë me vete gjëra të panevojshme; më keq akoma kur merr gjëra që i sjellin probleme. Vdekja është një element i rëndësishëm në përkujtimin e botës tjetër dhe vetëkontrollin e njeriut për veprimtarinë e tij në këtë botë. Duke u nisur nga ky fakt, Muhamedi (a.s.), thotë *"Kujtojeni vdekjen që ju ndërpret kënaqësitë."* (Ibn Maxhe)

Kurse në një hadith tjetër, thotë: *"Si kur të dinin kafshët atë që dini ju për vdekjen, nuk do të mund të hanit mish të shëndoshë prej tyre."* (Bejhaki)

I mençur është ai që nxjerr mësim nga pësimet e të tjerëve. Do të vijë një ditë që, siç varrosim të afërmit tanë sot, do të na varrosin ne nesër. Për të mençurit nuk ka këshillë më të mirë se vdekja. Atyre u mjafton vdekja si këshillë. Imam Rabbani thotë *"Vdekja nuk është fatkeqësi, fatkeqësi e vërtetë është të dish çfarë të pret pas vdekjes."*

Vdekja duhet përmendur shpesh, sepse ajo e sjell njeriun ballë për ballë me të vërtetën. Kur u pyet Pejgamberi (a.s.), se cili është njeriu më i zgjuar, u përgjigj: *"Ai që më së shumti kujton vdekjen dhe përgatitet për të. Këta janë njerëzit më të mençur."* (Ibn Maxhe)

I mençur është ai që nxjerr mësim nga pësimet e të tjerëve. Do të vijë një ditë që, siç varrosim të afërmit tanë sot, do të na varrosin ne nesër. Për të mençurit nuk ka këshillë më të mirë se vdekja.

Çfarë është pasuria?



Abdullah ibn Abbasi, radijallahu anh, transmeton se i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Nëse në zemrën e një robi zë vend dashuria ndaj kësaj bote, atëherë, zemrës së tij i ngjiten këto tri gjëra. Sigurisht se këto tri gjëra, i ngjiten zemrës së tij dhe e pushtojnë atë:

Gjëja e parë është preokupimi i atillë, saqë hallet dhe problemet nuk ndahen prej tij.

E dyta është varfëria dhe frika që i ngjitet në zemër, saqë është e pamundur ta pasurojë atë (zemrën).”

Domethënë, fama e kësaj bote dhe lakmia për pasuri, nuk i dalin nga zemra. Ndërkohë që pasuria e vërtetë, është pasuria shpirtërore. Pasuria e shumtë nuk e largon ngopjen e zemrës.

Gjëja e tretë: *“Në të vërtetë, besimtarët që mjaftohen me atë pasuri që kanë, janë të pasur, edhe nëse janë të uritur apo të paveshur. Ndërsa njeriu lakmues, përsëri është i varfër, edhe nëse zotëron botën dhe çdo gjë që ka në të.”*

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Sëmundja shpirtërore, është një cilësi afër kufrit.”

Shejh Sadi Shirazi, kuddise sirruh, ka thënë:

“Pasuria është për ta kaluar jetën në qetësi. Jeta nuk është për të mbledhur mall dhe pasuri.”

Sa bukur e përkufizon pasurinë e vërtetë Gasvu'l-Azam, Abdulkadir Gejlani, kuddise sirruh:

“Pasuria është lidhja me dashurinë e Allahut, xhelle xhelaluh dhe mpleksja me atë dashuri. Ndërsa varfëria është largim nga Allahu Teala dhe konsiderim i vetes si i pasur me krijesat që ka krijuar Ai, duke mos ndjerë nevojë për Të.”

I pasur është ai që korr fitore shpirtërore duke iu afruar Allahut Teala.

Ndërsa i varfër është ai që nuk arrin të formojë afërsi shpirtërore me Allahun Teala dhe privohet nga kjo fitore.

Kush dëshiron pasurinë e vërtetë, ai duhet ta nxjerrë nga zemra dashurinë ndaj çdo gjëje përveç Allahut Teala,

domethënë, dashurinë ndaj kësaj bote, dashurinë ndaj ahiretit dhe dashurinë ndaj atyre që janë në këtë botë e në ahiret. Çdo gjë duhet ta nxjerrë një nga një prej zemrës së tij. Aty (në zemrën e tij), le të lërë vend vetëm për Allahun e Madhëruar.

Mos u lidhni me mirësitë e kësaj bote të vogël që keni. Allahu Teala i ka krijuar ato për ju vetëm që të jenë si ushqim përgjatë udhëtimit për në ahiret. Përfitoni prej tyre në udhëtimin për te Allahu (xh.xh.), por kurrë mos i bëni ato synim. Ato nuk janë synimi juaj. Ato janë thjesht mjete për t'i përdorur në udhëtim. Allahu i Madhëruar i ka dhënë mirësitë e kësaj bote, në mënyrë që t'u jepni edhe të tjerëve në rrugën që shkon drejt Tij dhe për t'i udhëzuar ata në atë rrugë. Dijen e ka dhënë për të punuar me të dhe dritën e ka dhënë për të gjetur rrugën e drejtë.

Islami është i ndërtuar mbi një synim të logjikshëm. Ai e inkurajon tregtinë, madje, i lavdëron ata që e ushqejnë vatrën e tyre me fitim hallall.

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, është shprehur se një tregtar i ndershëm, do të tubohet me dëshmorët dhe me të sinqertët në kiamet.

Nëse të pasurit e japin një pjesë të kohës dhe të pasurisë së tyre fi sebilillah, domethënë, për hir të Allahut Teala, lakmia, brenga dhe dashuria e kësaj bote që kanë në zemër, do t'u largohet nga ajo me lejen e Allahut, xhelle sha'nuhu. Po ashtu, Allahu i Lartësuar u jep atyre një qetësi dhe pastërti shpirtërore, për shkak të atyre veprave të mira që kanë bërë.

Në këtë mënyrë, ngurtësia që ata kanë në zemër dhe animet e këqija, shndërrohen në cilësi dhe mendime të mira. Ata që kanë një zemër në të cilën nuk gjendet lakmia ndaj kësaj bote, mendimi i keq dhe brengosja për të, natën dhe ditën e kalojnë të qetë dhe në paqe.

Për fat të keq, në ditët e sotme, ka shumë të pasur që dhunojnë të drejtat e të varfërve, duke mos dhënë zekatin që e kanë farz e jo më, që të shpenzojnë për mirësi.



Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Të qenët me Allahun mes takvasë dhe ihsanit

Synimi kryesor i Islamit është rregullimi i marrëdhënieve të njeriut me Allahun, me njerëzit dhe me botën. Në një farë mënyre, qëllimi është të mbretërojë në jetën e njeriut vetëdija e ibadetit ndaj Allahut.

Për arsye të robërisë që ka në përbërjen e tij, njeriu bën luhatje mes robërisë ndaj Allahut, ndaj njerëzve, ndaj materies dhe ndaj dynjasë. Është e vështirë të ruash gjithnjë statusin e të qenit rob i Allahut. Këto luhatje të robërisë, shpeshherë e bëjnë mjerim jetën e dynjasë dhe të ahiretit.

Rrugëtimi i besimtarit, i cili nis me bërjen mysliman, kur ushqehet me vepër të mirë dhe me takva, merr drejtim për tek trajta "ihsan". Forma e imanit është ihsani; pra, të jetuarit me vetëdijen që Allahu e vëren robërinë e njeriut ndaj Tij. Ndaj, Allahu i Madhëruar bën të ditur se grupi i parë i besimtarëve, që kryeson në klasifikim si "*sabikun-i evvelun*", janë muhaxhirët dhe ensarët, pastaj vijnë ndjekësit e tyre, që u besojnë në nivel të ihsanit. (Tevbe, 100.)

Imani ka dy shtylla: shtylla e marifetit (njohjes) dhe shtylla e muhabetit (dashurisë). Imani fillon me shprehjen e pranimit dhe miratimit, përfshirjen e të gjithë detajeve më të vogla të mundshme, deri tek gjërat më kapitale të mundshme. Njeriu duhet të miratojë me zemër të gjitha të vërtetat hyjnore, që bëhen të ditura përmes Kuranit dhe Sunetit. Do të thotë që,

është problem të aprovohen njerëzit që guxojnë të drejtohen ndaj gjërave që ka ndaluar Allahu. Kryerja, plotësimi dhe detajimi i imanit varet nga gërshetimi që i bën përmes miratimit.

Fenomeni i takvasë, që theksohet më shumë në Kuran, imanin e shpie në ihsan. Takvaja rrjedh nga rrënja "*vikaje*", që ka kuptimin "të mbrosh". Në Kuran, fjalët që kanë rrjedhur nga kjo rrënjë kalojnë 270 herë. Kjo shifër është tregues i rëndësisë që i kushtohet takvasë në Kuran, për të mbrojtur zemrën. Vetë Kurani tregon se ai është udhëheqës për besimtarët e devotshëm, njerëzit e takvasë. Në ajetet e para të sures Bekare dhe në shumë vende të tjera, është theksuar një gjë e tillë.

Ndërkohë që Kurani fton në xhenetin, gjerësia e të cilit është sa qiejt e toka bashkë dhe i përgatitur vetëm për njerëzit e takvasë, ai mundëson të bëhen bashkë veçoritë e përbashkëta etike të njerëzve të takvasë me ato të njerëzve të ihsanit. Në këtë ajet kuranor, Allahu i Madhëruar na tregon se njerëzit e takvasë dhurojnë nga pasuritë e tyre, qoftë në kohë që kanë mundësi, qoftë edhe në kohë që nuk kanë mundësi, për të mos u mashtruar nga dynjaja, me frikën që të mbrojnë zemrat e tyre. Për arsye se fjala "infak" (dhurim) dhe "nifak" (dyfytërsia), janë të së njëjtës rrënjë, ato kanë një marrëdhënie mes njëra-tjetrës. Ai që mund të dhurojë, shpëton nga dyfytërsia. Ai që tregon dobësi në dhurim, bie në dyfytërsi, pasi dhurimi është një tregues

i besimit.

Në vazhdimin e ajetit, ashtu sikurse u është kush-tuar vëmendje njerëzve të takvasë, të cilët mbajnë nën kontroll me sukses zemërimin e tyre, po ashtu ka njerëz që dinë ta menaxhojnë zemërimin, si një ndjenjë epshore. Gjithashtu, vihet në dukje se është një virtut i rëndësishëm falja e njerëzve duke i toleruar ata që bëjnë gabime, për shkak të dobësisë njerëzore.

Kurse në ajetin në vazhdim, bëhet e ditur se janë penduar duke u ruajtur nga gjynahet që përfshijnë të drejtën e tjetrit, duke përdorur fjalën "*fahsha*" për njerëzit e takvasë. Pastaj, pendimi dhe istigfari, që vjen pas dhunimit dhe gjynahut, që ka kuptimin e keqbërjes ndaj vetvetes, që kanë mbetur mes njeriut dhe Zotit, bën të ditur që rregullon zemrën edhe sjelljet. Këto katër ajete kuranore tregojnë për elementet që duhen bërë kujdes për takvanë, që të meritohet shpërblimi me xhennetin e përjetshëm tek Zoti. (Shih. Ali Imran, 133 – 136)

Një prej kushteve të shëndetit të njeriut, është veçoria e të qenit mes frikës dhe shpresës. Kjo gjë, do të thotë që imani duhet të bartë ekuilibrin frikë - shpresë. Ashtu siç dihet, sjelljet e njeriut ndikohen nga ndjenja e frikës dhe e shpresës. Frika është para shpresës. Njeriu dëshiron të jetë i sigurt nga ato, prej të cilave frikësohet dhe të arrijë ato çfarë ai shpreson. Ndaj dhe sipas ligjeve të Mexhel-lesë është "*Def-i mefsedet, xhelb-i maslahattan akdemdir.*", që do të thotë: ruajtja nga ndjenjat e këqija vjen para se të vishesh me ndjenja të bukura.

Në Kuranin Famëlartë, për konceptin frikë janë përdorur fjalë të ndryshme, si "*khauf, khashjet, hejbet dhe rehbet*". *Khauf* është një frikë që krijohet tek njeriu, pasi merr miratimin dhe pranimin e lajmeve që i jep një njeriu të besueshëm. *Khauf* është emri i frikës që krijohet në zemrën e një njeriu, që nuk e njeh mjekësinë, i cili ndikohet nga fjalët e një mjeku, të cilit i beson fjalët dhe profesionalizmin e tij.

Khashjet do të thotë t'i druhash asaj gjëje, fundi i së cilës është i dëmshëm dhe që nuk është i pëlqyer. Dituria lind një frikë të llojit *khashjet*. Ruajtja me vetë-

dije nga gjërat e dëmshme që bën një mjek, i cili e di dëmin dhe dobinë e ushqimeve, është po ashtu *khashjet*. Ndaj dhe Allahu, në Kuranin Famëlartë shprehet: "**Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët,** (që e dinë se) **Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.**" (Fatir, 28.)

Hejbet është ekzistenca e njëkohshme e frikës dhe e respektit, kurse *rehbeti* është një frikë në kuptimin e motivimit. Dihet veçoria ndikuese e diturisë, ndjenjave dhe frikës tek sjelljet e njeriut. *Istihzar-i*, që është në kuptimin e të mbajturit të gjallë në mendje të të dhënave që japin Kurani dhe Suneti, është një veçori që e përgatit njeriun për takva. Një njeri që beson tek shpërblimi që do t'i dhurojë Zoti, mbajtja gjallë në mendje dhe zemër e këtyre ndjenjave e ndihmon të ruajë imanin dhe zemrën e tij. Ai që përpiqet të bëjë një gjë të ndaluar nga Zoti, nëse do ta gjallërojë në zemrën e tij dënimin që ka për atë vepër, atëherë nuk do të tentojë ta bëjë një gjë të tillë. Ndaj, i Dërguari i Allahut (s.a.v.), ka thënë: "*Një njeri që bën zina, nuk bën zina duke qenë edhe besimtar.*" (Ibn Maxhe, Fiten, 3.) Në këtë hadith theksohet ndikimi dhe rëndësia që ka gjallërimi në zemër i ndëshkimit të një gabimi. Sikur të mbahet i gjallë në mendje ndëshkimi që do të japë Zoti për këtë gabim dhe përçmimi që do të kalojë njeriu, atëherë njeriu nuk do të guxojë të bëjë një vepër të tillë të shëmtuar.

Në fakt, takvaja është një gjë e tillë. Është pikërisht mbrojtja e imanit që është vendosur në zemër, është mbajtja gjallë e frikës dhe pasqyrimi i saj në sjellje. Ndaj dhe i Dërguari i Zotit (s.a.v.), kur ka pyetur Harise-në (r.a.): "*Si ke gdhirë?*", ai i ishte përgjigjur: "*Si një besimtar i vërtetë!*". Atëherë, i Dërguari i Zotit i kishte thënë: "*Çdo e vërtetë ka shpjegimin e saj. Cila është e vërteta e imanit tënd?*" Atëherë, Hariseja i ishte përgjigjur: "*Nefsi im e njohu dynjanë. Në syrin tim, tashmë ari, gurët e çmuar dhe dheu i tokës më janë bërë të njëjtë. Unë sikur vërej *arsh*-in e Zotit. Sikur arrij të shoh popullin e xhenetit brenda dhuntive të xhenetit, si dhe popullin e xhehenemit, brenda vuajtjeve të xhehenemit.*" Atëherë, Pejgamberi iu drejtua duke thënë: "*Ti e ke kuptuar mirë çështjen, përqafoje fort.*" (Hindi, Kenzul Ummal, XIII, 351)



Mbajtja gjallë e përshkrimeve të xhenetit dhe xhehenemit dhe arritja për të parë *arsh*-in e Allahut, bëhet shkak që të ndërtohet bota e zemrës dhe t'i hapet syri i mendjemprehtësisë (*basiret*). Ndaj dhe Imam Aliu (r.a.), ka thënë: "Sikur të më ngrihej perdja që kam në sy, nuk do të më shtohesh dija e mprehtë (jakini)."

Kurani Famëllartë, pasi i rreshton ndalesat e ihramit për besimtarët që do të shkojnë në haxh, urdhëron që të marrin ushqim për dynjanë dhe ahiretin dhe tregon se ushqimi më i mirë është "*rroba e takvasë*". (Bekare, 197.) Sepse ushqimi dhe rroba e takvasë është rroba më e nderuar që e mbron dhe ushqimi më i vyer. Ndaj dhe Husejn el-Kashi ka thënë kështu:

Një njeriu që del jashtë pa rroba,

I vënë menjëherë damkën e të çmendurit.

Kush e damkos tjetrin për shkak se nuk ka rrobat e jashtme,

Të bën rezil dhe të turpëron para njerëzve.

Mendo se, nëse nuk e ke rrobën e takvasë dhe të vera-së,

Atëherë ç'do të bësh atë ditë të trishtueshme?

Përpiqu të jesh gjithnjë me rrobën e takvasë,

Derisa të bëhesh i pranuar dhe i nderuar në të dy botët.
(Ruhul-bejan, I, 451)

Allahu i Madhëruar u urdhëron takvanë njerëzve të imanit dhe që ta vazhdojnë atë derisa të vdesin si besimtarë. Kuptimi i jetës është të jetosh si besimtar dhe të vdesësh si i tillë. Për shkak të efektit të takvasë, për të qëndruar si mysliman deri në frymën e fundit dhe për ta mbrojtur imanin, Allahu i Madhëruar ka thënë: "**O besimtarë! Kijeni frikë Allahun, ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!**" (Ali Imran, 102)

Takva do të thotë të ruhesh nga të këqijat e nefsit, që mund të dëmtojnë ahiretin dhe kjo takva ka lloje të ndryshme:

Të qëndrosh larg shirkut dhe të ruhesh nga vuajtja e përjetshme. Ajeti "**Allahu bëri që besimtarët të mbështeten fort në fjalën e takvasë**" (el-Fet'h, 26.),

në këtë kuptim është.

Të ruhesh nga të gjithë gjynahet. Takvaja që përmendet në ajetin "**Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve...**" (10), në këtë kuptim është.

Të heqësh dorë nga gjithçka që të bën të largohesh nga Zoti i Madhëruar. Takvaja e vërtetë, që kërkohet në ajetin "**Kijeni frikë Allahun, ashtu si i takon Atij.**" (Ali Imran, 102.), është pikërisht kjo.

Me sa thuhet, një ditë një vezir vjen pranë Dhunnunit. Ia bën të ditur se i frikësohej Sulltanit dhe kërkoi ndihmën e tij. Dhunnunu Misriu i thotë: "Sikur të frikësohesha nga Allahu, aq sa ti frikësohesh nga Sulltani, do të isha nga njerëzit e veçantë të Zotit." Këtë ndodhi, një poet e ka shprehur në këtë mënyrë:

Sikur të mos ishte shpresa për xhenet dhe frika ndaj xhehenemit,

Këmba e dervishit do të ishte mbi gjithçka.

Sikur të frikësohej veziri nga Allahu,

Engjëll do bëhej, aq sa i frikësohet Sulltanit.
(Ruhul-bejan, II, 196 – 197)

Takvaja është si një parzmore që mbron imanin. Ndaj dhe njerëzit e takvasë jetojnë me kujdesin dhe delikatesën e një njeriu që ecën në rrugë me gjemba, duke preferuar takvanë në vend të fetvasë dhe *azimetin* (vështirësitë), në vend të *ruhsatit* (lehtësisë). Të rënit në preferencën e fetvasë në vend të takvasë dhe të *ruhsatit* në vend të *azimetit*, dhe veçanërisht ta bësh praktike, bën që të dobësohet kujdesi fetar.

Imani, si një dritë e një pishtari, është një nur që ndriçon zemrën e njeriut. Porse një nur me ndikime të jashtme, mund të jetë gjithnjë i gatshëm që të fiket. Që të ruhet, duhet që zemra të jetë me Allahun, që zemra të jetë me Allahun, duhet që gjithnjë të mbeten të gjalla parimet fetare të arsyes, frika ndaj ahiretit. Ajo që mbahet e gjallë në mendje, me organet që në zemër transformohen në ndjenja, besimi që ushqehet me vepra, arrin në ihsan në sajë të takvasë. Si përfundim, arrihet qëllimi i dynjasë dhe i ahiretit.

*Rrugëtimi i besimtarit,
i cili nis me bërjen mysliman,
kur ushqehet me vepër të mirë
dhe me takva, merr drejtim
për tek trajta "ihsan".
Forma e imanit është ihsani;
pra, të jetuarit me vetëdijen
që Allahu e vëren robërinë
e njeriut ndaj Tij.*



Besimi ka nevojë për veprim

Prof. dr. Enbija Jëlldërëm

Sipas përkufizimit të Kuranit, për nga ana e aftësive dhe cilësive, Allahu e ka krijuar njeriun në nivelin më të lartë të vlerave. Në sajë të shikimit, dëgjimit, fjalës dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, të mendimit, ai është në gjendje të ndryshojë botën. Për shkak të virtyeteve më të larta që ka në krahasim me çdo krijesë tjetër, Allahu e ka vënë çdo gjë në tokë në shërbim të njeriut. Por nuk duhet harruar, se Krijuesi i Madhërisëm e vendosi njeriun në tokë si halifen (mëkëmbësin) e Tij, prandaj dhe ekzistenca e tij në tokë, është në emër të Allahut dhe gjithashtu, ai vepron në emër të Tij. (El-Bekare, 30)

Për këtë arsye, Allahu i kujton njeriut se për çfarë është krijuar, se duhet të zbatojë detyrat që i janë ngarkuar dhe se jeta s'është gjë tjetër veçse një provë: **"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë."** (Edh-Dharijat, 56) **"Ai ju ka bërë pasardhës të njëri-tjetrit në Tokë dhe ka ngritur në shkallë disa nga ju mbi të tjerët, për t'ju provuar në atë që ju ka dhënë..."** (El-En'am, 165) **"Pastaj ju bëmë juve pas tyre zëvendës në Tokë, për të parë sesi do të veproni."** (Junus, 14)

Ashtu siç e kuptojmë edhe nga Kurani, e vërteta e vetme prej së cilës jeta fiton kuptim, është fakti se në krye të shkaqeve të krijimit të njeriut, zë vend adhurimi i Allahut. Pasi e arsyeton në këtë mënyrë shkakun e krijimit të njeriut, Kurani e ngarkon atë me përgjegjësi dhe pret që ai të bëjë atë që duhet. Prandaj, pikësëpari, ajo që pritet prej njeriut, është të besojë, pas kësaj të zbatojë detyrat morale dhe adhurimet që e forcojnë besimin e tij. Kjo, sepse besimi nuk përbëhet vetëm nga pohimi, por kërkohet që të veprohet në përputhje me atë që besohet. Pra, e bën të domosdoshëm realizmin e kërkesave të besimit.

Kur e shqyrtojmë Kuranin dhe hadithet, shohim se detyrat, të cilat kërkohet të zbatohen nga ata që e kanë pranuar islamin si fe, nuk janë të vendosura në kategori të ndryshme. P.sh., ato që kanë të bëjnë dhe nuk kanë të bëjnë me moralin, nuk janë të mbledhura nën një temë të vetme. Urdhëresat, të cilat kanë për qëllim të vendosin të gjithë jetën njerëzore në një disiplinë të caktuar, ndonjëherë bëhen me moral, ndonjëherë me adhurim dhe ndonjëherë

me diçka tjetër. Islami, me specifikën e vet që nuk lë asnjë vend bosh në jetën e njeriut, në çdo fushë të jetës vendos rregulla të përgjithshme. Kur feja e reformon shoqërinë brenda këtij kuadri, atëherë urdhëron myslimanët të zbatojnë urdhrat dhe këshillat e Allahut Teala dhe të të Dërguarit të Tij. Ndërsa besimtarëve nuk u ngelet gjë tjetër veçse t'i zbatojnë këto urdhra.

Kur përgjegjësia është zbatimi i urdhrave, atëherë çdo detyrë, si një urdhër i Allahut apo i Profetit, bëhet në emër të fesë. Prandaj, ato kërkojnë vendosmëri dhe nënshtrim, sepse njerëzit, motivet e zbatimit i marrin nga feja, e shprehur ndryshe, nga libri i Allahut dhe Profeti (a.s.). Allahu Teala, i Cili nuk ka bërë asnjë klasifikim të urdhrave të Tij, duke u shprehur: **“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”** (El-Hixhr, 99), ka treguar edhe detyrimin edhe vazhdimësinë e përgjegjësisë së njeriut.

Kur shohim nga pikëpamja e kërkesës për punë-veprim ndaj besimit të Kuranit, vëmë re se besimi asnjëherë nuk është mbajtur veç nga puna dhe se asnjëherë nuk bëhet fjalë për mundësinë e besimit pa punë. Dhe në fakt, kur Kurani flet për besimin ose për besimtarët, besimin dhe punën (veprën), i përmend së bashku. Përmendja e besimit pa folur për punët e mira, ndodh vetëm atëherë kur bëhet krahasimi midis “besimtarëve dhe jobesimtarëve”.

Duke u nisur nga kjo, na bëhet e qartë se qoftë Kurani, qoftë Profeti (a.s.), çdo gjë që kanë shfaqur në lidhje me besimin dhe veprën, nuk janë shpikje, pra zbatime të cilat nuk kanë vend në jetën sociale. Këtë kërkojnë të shprehin edhe ajetet kuranore, kur e lavdërojnë punën (veprën) dhe ata që punojnë (veprojnë). Gjithashtu, kjo është ajo që kërkon të pasqyrojë edhe ajeti, i cili urdhëron që më parë të adhurohet Allahu, pastaj të qëndrohet larg prej shirkut dhe më në fund, të zbatohen çështjet që kanë të bëjnë me moralin e bukur:

“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, fqinjët e afërt dhe të largët, me

atë që keni pranë, me udhëtarin (që ka mbetur ngushtë) dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj. Në të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburraveçë.” (En-Nisa, 36)

Kurani Kerim na ka këshilluar diturinë (El-Enbija, 7), ndërsa ata që nuk i vënë në jetë ato që dinë, i ka ngjasuar me gomarët që bartin libra. (El-Xhum'a, 5) Gjithashtu, edhe Profeti ynë (a.s.), ka kërkuar strehim tek Allahu prej diturisë së padobishme (Muslim, Dhikr, 19) dhe na ka njoftuar se robi nuk do të ndahet nga audienca e Allahut pa dhënë llogari se ku e ka përdorur diturinë. (Tirmidhi, Sifatu'l-kijame, 1)

Shkurtimisht, faktet (ajetet dhe hadithet) në lidhje me adhurimet dhe moralin, nuk janë paraqitur që të ngelen thjesht një imazh pa praktikë në mendjen e njeriut. Qëllimi përfundimtar është arritja e përsosmërisë së njeriut. Dhe kjo do të realizohet me veprim. Prandaj, përgjegjësia që bie mbi njeriun, është zbatimi.

NËSE BESIMI NUK REFLEKTOHET NË JETË...

Njerëzit e mendojnë moralin dhe fenë si dy gjëra të pandashme. Për këtë arsye, njerëzit, ata që i zbatojnë me përpikëri urdhrat fetare në jetën e përditshme, i njohin si fetarë dhe prej tyre presin që të jenë më tepër të moralshëm se kushdo tjetër. Prandaj, kur i shohin ata të cilët i njohin si fetarë, që tregojnë dobësi në vlerat morale, u bën shumë përshtypje dhe për këtë shkak ata reagojnë ndjeshëm. Pra, të tilla raste bëhen shkak që vetë fetarët dhe ndonjëherë –megjithëse gabim-edhe feja të kritikohen ashpër. Ata akuzohen si dyfytresh dhe mashtrues. Prandaj është e mundur të themi se një nga çështjet në të cilat kritikohen më së shumti njerëzit besimtarë, është mospërputhshmëria e besimit me veprat e tyre. Ndërsa një fakt i vërtetë sociologjik, është edhe ai se kur personat të cilët nuk konsiderohen si fetarë tregojnë të njëjtat dobësi morale, ata nuk shihen me sy të keq dhe as kritikohen.

Nëse një njeri, i cili në jetën e përditshme u jep rëndësi çështjeve të cilat pranojnë si simbole fetare,

Fetari, është përpjekja për të rregulluar të gjitha fushat e jetës sipas shembullit të paraqitur nga Kurani dhe jeta e Profetit (a.s.). Sipas kësaj, një jetë e cila nuk i bart këto cilësi, sado që të jetë e mbushur me adhurime, mund të themi se nuk e meriton të quhet fetare.

bën sjellje të pahijshme gjatë tregtisë ose i bën padrejtësi një personi që ka përballë, bëhet shkak i dyshimit të fetarisë së tij dhe i mendimit se ai nuk është një njeri i cili e jeton plotësisht fenë e tij. Personi që ka përballë, formon paralele midis veshjeve dhe fesë së tij dhe pret prej tij sjellje të cilat përputhen me fenë e tij. Një gjë e tillë ndodh edhe me personin i cili tregohet i kujdesshëm në përmbushjen e detyrave fetare, por që nga ana tjetër shfaq sjellje të cilat e shqetësojnë shoqërinë. Ai bëhet objekt kritikash, për shkak se nuk i ka përvetësuar siç duhet vlerat morale. Prandaj dhe fetaria e dukshme, është bërë element i vlerësimit të sjelljeve njerëzore.

Është e qartë se një mënyrë e tillë jetese, që përmban në vete kundërshti dhe dyzime, nuk është mënyra e jetës që kërkon feja dhe nuk e meriton aspak të quhet një jetë fetare. Kjo, sepse shprehja "fetari", në përbërjen e saj, është një term që bart edhe moralin. Dhe fetaria me moralin as që mund të mendohet e ndarë. Për këtë arsye, as që mund të mendohet që një njeri të jetë edhe fetar edhe i pamoralshëm.

Në kuptimin e vërtetë të fjalës, *fetar* nënkuptohet njeriu që besimin dhe moralin i ka bërë mbizotërues në jetën e tij dhe të gjitha këto i jeton edhe në praktikë. Jeta e tij fetare dhe morale është formuar plotësisht nën çatinë e fesë dhe janë bërë dinamika themelore e jetës së tij. Duke u nisur nga kjo, kur njeriu t'i ketë bërë mbizotërues të jetës së tij besimin, adhurimin dhe moralin, atëherë ai e meriton të quhet fetar. Pa i bërë mbizotëruese në jetë rregullat morale, nuk është e mundur të flitet për fetari.

Fetaria e një njeriu, i cili bën një jetë të mbushur me kundërshtime dhe hezitime, është një fetari që mbetet vetëm në formë dhe në fjalë. Prandaj dhe nuk e meriton të quhet një fetari në kuptimin e vërtetë të fjalës. Fetari, është përpjekja për të rregulluar të gjitha fushat e jetës sipas shembullit të paraqitur nga Kurani dhe jeta e Profetit (a.s.). Sipas kësaj, një jetë e cila nuk i bart këto cilësi, sado që të jetë e mbushur me adhurime, mund të themi se nuk e meriton të

quhet fetare. Madje, nëse dashuria për Allahun dhe vetëdija e asaj që pret Ai prej robërve të tij nuk zë vend në mendjen e njeriut me gjithë kuptimin e plotë të fjalës, mund të thuhet se edhe adhurimet që bën ai janë thjesht formale. Pra, një njeri i cili i jep rëndësi namazit, duhet të jetë i vetëdijshëm se midis zbatimit të urdhrat për faljen e namazit dhe zbatimit të urdhrat për ndalimin e gënjeshtërisë, nuk ka asnjë ndryshim.

Në lidhje me dilemën e personave që shfaqin një jetë kontradiktore, mund të themi se ata nuk janë shkrire ashtu siç duhet me përmasat e besimit, adhurimit dhe moralit të fesë, kanë dobësi në nivelin e vetëdijes dhe motivi kryesor i adhurimeve që bëjnë, është imitimi.



Profeti ynë, Muhamedi (a.s.), na ka treguar se në ditën e kijametit, në peshoren e veprave të mira nuk do të vendoset asgjë më e rëndë se morali i bukur (Tirmidhi, Birr, 62), se virtyti më i dobishëm për besimtarin, është devotshmëria (Ibën Maxhe, Nikah, 5) dhe se frikë-respekti ndaj Allahut dhe morali i bukur janë vlerat themelore që e çojnë njeriun në xhenet. (Tirmidhi, Birr, 62) Në bazë të këtyre, mund të themi se tek personat për të cilët folëm më lart, ka një dobësim në besimin, në dashurinë dhe në afërsinë ndaj Krijuesit të tyre.

Megjithatë, përkrah këtyre fakteve që sollëm këtu dhe me gjithë dobësitë në çështjet morale, mund të themi se përpikëria ndaj adhurimeve që tregojnë ata persona mund t'i ndihmojë ata t'i korrigjojnë sjelljet e tyre problematike në drejtim pozitiv. Kjo, sepse njeriu, me kalimin e kohës, adhurimet për të cilat tregojnë aq përpikëri mund t'i bartë nga përmasat formale, në përmasat shpirtërore dhe të kuptojë se midis kryerjes së adhurimeve dhe zbatimit të urdhrave morale nuk ka asnjë ndryshim. Pra, pas një periudhe të caktuar, mundet që njeriu të ndryshojë në drejtim pozitiv. Këtë e vërtetojnë edhe shembujt e shumtë të ndikimit pozitiv që kanë mbi njeriun, haxhi, umreja dhe agjërimi i muajit të Ramazanit...



Sami Byjykajnak

Në ajetin 36 të sures Kijamet, Allahu (xh.sh.), i drejton këtë pyetje të gjithë njerëzimit: “Mos vallë njeriu mendoi se do të lihet ashtu kuturu?” Kjo pyetje bën të qartë se në natyrën njerëzore ekziston specifika e “jetës së pavarur nga varësia ndaj të tjerëve”. Kjo specifike shoqërohet edhe me pengesa dhe me mosbindje në lidhje me përgjegjësinë që ka njeriu ndaj Krijuesit. Mosbindja dhe rrëshqitja nga rruga e drejtë, që rrjedhin nga dashuria për liri, mund ta shtyjnë njeriun drejt indiferentizmit, drejt egoizmit, madje edhe drejt refuzimit që ka treguar Allahu dhe në kundërshtim të urdhrave të Zotit. Njeriu mund të shpëtojë nga asgjëja në jetën e tij në sajë të “adhurimit”. Mbrujtja me adhurim e shpie njeriun tek Allahu, e shpëton nga mungesa e kuptimit të jetës dhe Allahu e do. Në një hadith kuds, Zoti i madhëruar urdhëron dhe thotë: “Kur robi im më afrohet mua duke bërë adhurime, atëherë Unë do të jem dora e tij që prek, syri i tij që sheh, veshi i tij që dëgjon dhe këmba e tij me të cilën ecën.” (Buhari, Rikak, 38, Ibn Hanbel, Musned, 6/256), duke e cilësuar kështu adhurimin si mjetin më të rëndësishëm “që të çon tek Zoti”. Gjithashtu, ajeti fisnik ku Zoti urdhëron dhe thotë: “Unë i kam krijuar njerëzit dhe xhindët vetëm që ata të më adhurojnë Mua.” (Dharijat, 56.) shpreh qartë se arsyeja e krijimit të njeriut është “adhurimi i Zotit”.

Kjo do të thotë se gjëja që e bën njeriun më të vlefshëm tek Allahu, pra adhurimi, i disiplinon të gjitha organet e trupit të njeriut, atëherë kur kryhet vetëm për hir të Zotit. Adhurim në kuptimin e ngushtë të fjalës, janë ibadetet kryesore, si namazi, agjërimi, haxhi dhe zekati, ndërsa në kuptimin e gjerë, është një fenomen me shumë dimensione. Kjo do të thotë se çdo organ i njeriut kryen

Mbrujtja
e zemrës
me adhurim

një adhurim të caktuar për të. Për shembull, adhurimi i gjuhës është dhikri (përmendja e Zotit), fjala e mirë, ftesa për punë të mira, shmangia e gënjeshtrove, mospërgojimi, fjalët e kota, distancimi nga çdo lloj gjëje e gabuar dhe e keqe, që mund të bëhet duke folur. Adhurimi i syve është vrojtimi i krijesave të Zotit dhe lavdërimi, kur sheh sa të përkryera janë krijuar ato, shmangia e shikimit nga ato gjëra që janë të ndaluara fetarisht të shihen, largimi i shikimit nga gjërat e panevojshme. Korniza e adhurimit është aq e gjerë, saqë edhe të largosh nga rruga një objekt apo send që i pengon dhe i mundon njerëzit kur kalojnë aty, konsiderohet adhurim.

Allahu (xh.sh.), kërkon nga myslimani që ai ta adhurojë Zotin me sinqeritet, që të ruhet në këtë mënyrë në jetën e tij nga shejtani dhe bashkëpunëtorët e tij. Myslmani që mbruhet me adhurim, është përherë së bashku me Allahun në çdo situatë dhe gjendje. Siç thuhet edhe në ajetet e Kuranit, shejtani nuk u afrohet atyre myslimanëve që janë pranë Allahut. Myslmani duhet të fokusohet shumë në adhurimet e tij ndaj Allahut, në mënyrë që, në sajë të kënaqësisë që merr prej namazit me të cilën nuk di të ngopet, të mos sjellë ndërmend apo të fusë në zemër asnjë gjë që ka lidhje me këtë botë. Ta shndërrosh adhurimin në veprimin më të rëndësishëm të jetës tënde të përditshme, bën që çdo veprim që myslimani e kryen me qëllim fitimin e kënaqësisë së Allahut, të shndërrohet dhe të konsiderohet ibadet për të. Kur njeriu vjen në këtë shkallë, është ngritur lart në gradën e besimtarit të përsosur. Besimtar i përsosur do të thotë besimtar cilësor. Kur një krijesë është me cilësi, kjo do të thotë se është bërë për t'u marrë shembull. Ai besimtar që është për t'u marrë shembull, është një besimtar i mirë (salih) dhe i afërt me Zotin.

Të mbrush zemrën me adhurim, bëhet e mundur vetëm duke përgatitur mendjen, zemrën dhe të gjitha organet e trupit për kryerjen e adhurimit dhe, duke i nxitur ato që të përmbushin detyrën e tyre të adhurimit. Kjo arrihet duke përmendur Allahun dhe duke ndjerë harenë që të fal besimi. Nuk është e mundur të matet tek Allahu vlere e adhurimit që bëhet me një zemër të qetë (mutmain). Përgatitja për "ditën kur nuk do të ketë vlerë as pasuria dhe as fëmija, por do të ketë vlerë vetëm zemra e pastër"

(Shuara, 89.), është e mundur vetëm duke e përhapur jetën e adhurimit në të gjitha organet e trupit dhe në të gjitha fushat e jetës. Njeriu është një krijesë me dy anë. Ai zotëron kapacitetin për të bërë mirë, ashtu siç është i prirur edhe nga e keqja. Ai zotëron një nefsi që e urdhëron atë, por njeriu e ka në dorë të mbetet përherë i azhurnuar në vepra të mira. Ai mund ta shndërrojë në nefsi levvame (qortues), nefsin që e urdhëron për të bërë keq, madje ta shndërrojë atë në nefsi të qetë, duke e mbrujtur me adhurim dhe bindje ndaj urdhrave të Zotit. Pikërisht atëherë, atij do t'i drejtohet kjo thirrje nga ana e Zotit: "Kthehu tek Zoti yt. Ti je i kënaqur me Të dhe Ai është i kënaqur me ty. Bashkohu me robërit e Mi, që të hysh edhe ti në xhenet." (Fexhr, 27-30.) Po kështu, në qoftë se njeriu është nën urdhrat e nefsit dhe nuk i kujton nefsit të tij Allahun, atëherë do të largohet nga adhurimi dhe

adhurimi do të largohet nga të gjithë organet e tij të trupit. Tashmë, nga ky person do të shfaqet çdo lloj veprimi dhe akti që bie në kundërshtim me kënaqësinë e Zotit. Në këtë mënyrë, do të prishet edhe personaliteti tij dhe ai do të bëhet "esfel-i safilin".


Kjo është arsyeja përse njeriu duhet të ketë një jetë të ekuilibruar. Kur zemra fillon të lëshojë sinjal atëherë kur ne e tejkalojmë me të ushqyerin dhe nuk tregojmë kujdes për yndyrat dhe kripën që konsumojmë, njeriu tregohet i kujdesshëm të ruajë shëndetin e tij. Po kështu, ne duhet të mbajmë në ekuilibër edhe jetën tonë të adhurimeve, siç tregojmë kujdes për atë që hamë,

që pimë dhe që fitojmë. Vetëm në qoftë se veprojmë në këtë mënyrë, do të mund të shijojmë ëmbëlsinë e adhurimit. Do të jemi në rrugën e zemrës së kënaqur. Çfarë qëllimi tjetër mund të ketë njeriu, përveçse të bëjë përpara në rrugën e tij drejt fitimit të kënaqësisë së Allahut? Të ecësh kësaj rruge, është e mundur vetëm duke jetuar një jetë të ekuilibruar me adhurimet, duke mos neglizhuar jetën e natës, gjatë së cilës duhen falur namazet e natës dhe duke treguar kujdes se çfarë fusim në stomak. Jeta është e shkurtër, ndërsa distanca që duhet të përshkojmë në të është e madhe. Për këtë arsye, duhet të hipim mbi mjetin e adhurimit. Mjeti i adhurimit të shpie vetëm tek një destinacion, tek Allahu, ndërsa adhurimi dhe bindja ndaj Zotit të mundësojnë një jetë të mbushur me qetësi. Përse nuk urdhëroni të hyni brenda kësaj jete?

Gjëja që e bën njeriun më të vlefshëm tek Allahu, pra adhurimi, i disiplinon të gjitha organet e trupit të njeriut, atëherë kur kryhet vetëm për hir të Zotit. Adhurim në kuptimin e ngushtë të fjalës, janë ibadetet kryesore, si namazi, agjërimi, haxhi dhe zekati, ndërsa në kuptimin e gjerë, është një fenomen me shumë dimensione. Kjo do të thotë se çdo organ i njeriut kryen një adhurim të caktuar për të.



Bazar



PAMJA E PËRGJITHSHMEE PAZARIT
DHE URA E BUNËS - K. MARUBI 1895 - 1910

FOTOJA E MUJAJIT



Një Ajet

*Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!*

“Por ju doni këtë jetë (kalimtare) e për jetën tjetër nuk kujtoheni!” (el-Kijame, 20-21)

Kurani nuk e mohon rëndësinë e të mirave materiale në rrugën e pjekurisë shpirtërore, por as nuk e pranon si thelbësore duke përjashtuar botën shpirtërore. Kurani ka vendosur një ekulibër ndërmjet shpirtërores dhe materies pa anashkaluar asnjërën. Si rrjedhojë e kësaj filozofie, Kurani i fton besimtarët të dëshirojnë të mirat tokësore dhe botës tjetër. Kurani i nxit besimtarët të përfitojnë nga të mirat e kësaj bote. Çdo e mirë në këtë botë është krijuar për njerëzit. Kurani e shpall të gabuar idenë e braktisjes së plotë të të mirave materiale. Por në të njëjtën kohë, Kurani nuk lë pa theksuar edhe anën joshëse dhe të rreme të kësaj bote. Njeriu ka një lakmi të pashuar për të mirat e kësaj bote. Të mirat tokësore, duke qenë tërheqëse dhe magjepsëse, mund të bëhen shkak që njeriu të largohet nga adhurimi i Allahut e për pasojë, të humbë lumturinë e përjetshme. Kurani shpesh u tërheq vëmendjen besimtarëve për rrezikun që përbën lakmia e madhe mbas jetës së kësaj bote. Vazhdimisht u kujton atyre të mos shesin jetën e përhershme në këmbim të të mirave të përkohshme të kësaj jete. Kur nevojat materiale dhe biologjike janë dominante, njeriu në përgjithësi përvetëson një jetë hedoniste, të bazuar në kënaqësitë e kësaj bote, duke e mohuar ose duke mos e marrë seriozisht botën e përtejme. Kënaqësinë e kësaj bote e bën moto të jetës së tij. Në periudhat kur kanë jetuar pejgamberët, kanë dominuar vlerat shpirtërore dhe e gjithë jeta ishte rregulluar sipas këtyre vlerave. Ata nuk e konsideronin botën qëllim në vetvete, por mjet për të arritur lumturinë e përhershme në xhenet, duke mos lejuar në asnjë mënyrë që joshja e kësaj bote t'i pengonte nga adhurimi.

Shekullarizmi është karakteristikë e natyrshme e atyre që nuk besojnë në botën tjetër. Sepse, sipas tyre, lumturia, gëzimi dhe kënaqësia është vetëm në këtë botë. Por kjo sëmundje prek edhe ata që besojnë, siç e evidenton edhe Kurani me rastin e Jahudive, të cilët nga njëra anë besonin se parajsën e meritonin vetëm ata, kurse nga ana tjetër ishin më të dhënë mbas kësaj jete se sa idhujtarët. Fatkeqësisht, sekularizmi ka prekur edhe myslimanët si një sëmundje epidemike. Kjo ndodh sepse praktikimi dhe zbatimi i ajeteve kuranore në jetë është bërë diçka e rrallë. Njerëzit, megjithëse besojnë në botën tjetër dhe shpërblimin në të, jetojnë në këtë botë sikur nuk besojnë në ekzistencën e saj. Nuk respektojnë normat kuranore mbi të lejuarën dhe të ndaluarën. Shqetësimet e kësaj bote i pengojnë nga kryerja e detyrimeve bazë të fesë islame. Kënaqësinë e kësaj bote e kanë pranuar si qëllimin e vetëm të kësaj bote. Njerëzit e sotëm sipas evidentimeve të Kuranit, po digjen e përvëlohen në zjarrin e lakmisë dhe ambicjeve për këtë botë, duke garuar për të mbledhur sa më shumë pasuri me shpresën se ajo mund t'i bëjë të pavdekshëm. Myslimanët janë dhënë mbas kënaqësive të kësaj bote, pa marrë parasysh as një vlerë islame, duke u shndërruar në një turmë konsumatore. Allahu, duke e ditur këtë dobësi të njeriut, vazhdimisht u tërheq vëmendjen besimtarëve për rrezikun që përbën dhënia e plotë mbas kësaj bote. Kurani e konsideron thjesht një lojë dhe argëtim të çastit jetën në këtë botë, prandaj besimtarët nuk duhet të gënjejnë nga kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote.

Një Hadith

*Transmetohet nga Nu'man ibn Beshir (r.a.)
se Resulullahi (s.a.v.s.) i ka thënë:*



“Besimtarët në mëshirë, dashuri e miqësi me njëri tjetrin, janë si një trup i vetëm; nëse sëmuret një organ edhe pjesët e tjera të trupit shqetësohen dhe mbarë organizmi vuan nga dhembjet, pagjumësia dhe temperatura e lartë.”

Pejgamberi (a.s.), i këshillon besimtarët të jenë të mëshirshëm, të dashur e të dhembshur ndërmjet tyre, duke i përngjasuar me një organizëm të vetëm e të gjallë. Është e vështirë të gjesh një frazë që e shpreh në mënyrë kaq lakonike dhe të bukur gjendjen e besimtarëve me njëri-tjetrin. Përsëri në një hadith tjetër, Pejgamberi (a.s.), i ka përngjasuar besimtarët me tullat e një ndërtese që janë të lidhura me njëra-tjetrën për ta mbajtur atë në këmbë.

Në ajete të ndryshme, Kurani deklaron se besimtarët janë vëllezër të njëri-tjetrit. Muhamedi (a.s.), arriti të bashkonte të gjithë arabët në një umet të vetëm, duke zhdukur çdo lloj ndasie që cenonte bashkimin, si dallimet fisnore, etnike etj. dhe për ta ruajtur e mbajtur gjallë vëllazërinë, na këshilloi të kapemi fort mbas Kuranit dhe fjalës Profetike.

Bashkësia islame është e detyruar të jetë si një gërshetim organik. Vëllazëria ndërmjet besimtarëve është edhe një siguri për paqen botërore. Sepse feja islame, ndërsa thekson vëllazërinë ndërmjet besimtarëve, është shumë tolerante edhe me grupet e tjera jashtë saj.

Në iniciativën për të ndërtuar një shoqëri, feja islame nuk ka marrë për bazë dallimet etnike apo sociale, por ka marrë vlerat fetare dhe njerëzore. Kjo është arsyeja që, me gjithë provokacionet e shumta për t'i përçarë, grupe të ndryshme etnike kanë jetuar në paqe dhe harmoni me njëri-tjetrin për shekuj me radhë.

Islami i shikon të gjithë popujt myslimanë si një bashkësi të vetme duke ushqyer dashuri, mëshirë dhe harmoni për njëri-tjetrin, pa bërë asnjë dallim. Për rrjedhojë, një problem i një myslimani, është problem i çdo myslimani. Prandaj, identitetin islam duhet ta mbajmë lart në çfarëdo lloj situatë që të përballemi. Neve si besimtarë na kërkohet të ndihmojmë besimtarët pa kushte dhe parapëlqime, përndryshe shndërrohemi në anëtarë të një organizate dhe kurrë në pjesëtarë të një bashkësie islame. Dashuria, mëshira dhe ndihma ndaj vëllazërve janë tregues të një besimi të fortë.

Një person që nuk e kryen punën e ngarkuar siç duhet, nuk është i mirëpritur as nga Krijuesi, as nga shoqëria.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Besimtarët në dashuri, mëshirë dhe në ndihmë ndaj njëri-tjetrit duhet të jenë si një trup i vetëm.
2. Njerëzit duhet të ndajnë gëzimet dhe hidhërimet së bashku.
3. Bashkësia islame është si një trup i vetëm, kur sëmuret një organ shqetësohet i gjithë trupi.

Nga lulishita e zemrës

Osman Nuri Topbash



Nga morali shembullor i miqve të Allahut

TË SHOHËSH ME SYRIN E URTËSISË PËR TË MARRË MËSIM

Urdhri i parë i Allahut në Kuranin Kerim, është “Lexo”. Për zemrat e ndriçuara, çdo krijesë dhe çdo ndodhi në gjithësi, është një mësim urtësie që duhet lexuar dhe kuptuar. Në fakt, çështja më e rëndësishme e devotshmërisë, është që të mund të fitohet aftësia e të lexuarit sipas urdhrit hyjnor: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka).”** (el-Alak, 1) Kjo përbën edhe diturinë thelbësore. Pra, të fitosh aftësinë e të lexuarit të urtësive hyjnore në çdo gjë.

Ashtu si Kurani Kerim, edhe gjithësia është ligjëratë e mrekullueshme hyjnore, e cila i drejtohet njerëzimit për ta lexuar me sytë e zemrës. Çdo thërmijë e saj, është si një zarf (letër) i urtësisë dhe së vërtetë. Detyra e një besimtarit të përsosur dhe të ditur, është të hapë atë zarf dhe të lexojë mesazhin hyjnor, të fshehtat dhe urtësitë që ndodhen brenda tij dhe t'i kuptojë ato ashtu siç e meritojnë.

Në shumë ajete të Kuranit Kerim, ftohemi të lexojmë mesazhet e urtësive hyjnore që ndodhen brenda në zarf. Në një nga këto ajete, urdhërohet:

“Me të vërtetë, në qiej dhe në Tokë ka shenja për ata që besojnë. Edhe në krijimin tuaj dhe të kafshëve të shpërndara nëpër Tokë, ka shenja për besimtarët e bindur. Edhe në ndërrimin e natës dhe të ditës, edhe në ujin që Allahu e zbret nga qielli, duke gjallëruar nëpërmjet tij tokën e shkretuar, edhe në ndërrimin e erërave, ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (el-Xhathije, 3-5)

Në shumë ajete të ngjashme, Allahu i Madhëruar urdhëron:

- Duke na tërhequr vëmendjen tek krijesat thotë: “A nuk i shohin devetë?”

- Duke na tërhequr vëmendjen në faktet gjeografike dhe atmosferike thotë: “A nuk i shohin retë, shiun, malet dhe bimët, të cilat vdesin në dimër dhe ngjallen në pranverë?”

- Duke na tërhequr vëmendjen tek historia thotë: “A nuk e shohin përfundimin e popujve të shkuar?” Dhe këtë ftesë për të shikuar dhe mësuar, Allahu Teala e përsërit në mënyrë të vazhdueshme.

NË TË VËRTETË, AJO QË LEXON, ËSHTË ZEMRA

Nuk duhet të harrohet se në fakt, është zemra ajo që do të lexojë dhe do të zbulojë urtësitë e Kuranit dhe gjithësisë. Sytë e ballit, janë si syze për sytë e zemrës, sepse syri shikon dhe vëren sipas qëllimit dhe përmbajtjes së zemrës.

Mevlana i nderuar, këtë e shpjegon kështu:

“Sytë dhe shikimet tona, janë në itinerarin e zemrës. Nëse do zemra, syri sheh gjarprin, pra helmin. Por nëse do zemra, syri sheh gjërat prej të cilave do të marrë mësim. Nëse do zemra, syri sheh botën dhe mirësitë e saj (ato që ia ka ënda). Por, nëse do zemra, syri kërkon vetëm të fshehtat hyjnore... Nëse do zemra, llogaritë i bën me gishtat e dorës, nëse do, me ata gishta shkruan libra dhe vepra. Kini kujdes! Dora e shkathët, e cila i bën të gjitha këto, në fakt vepron sipas dëshirës së një dore të fshehtë (zemrës) që ndodhet brenda. Ajo dorë e fshehtë (që

është qendra e ndjenjave dhe mendimit), kryen punë pozitive ose negative duke e përdorur si një mjet dorën e trupit.”

Sipas kësaj, duhet që zemrën ta përgatisim shpirtërisht që të mësohet të marrë mësim prej urtësive hyjnore.

Jusuf Hamedani (Allahu e mëshiroftë), ka thënë:

“Dhikri me zemër, është si pema me ujin. Ndërsa meditimi me zemër, është si pema me frutin. Të presësh që pema të lulëzojë dhe të japë fruta pa e ujitur, është gabim i madh. Edhe sikur të duash, ajo nuk jep kurrë fruta, sepse kjo nuk është koha për të dhënë fruta, por për të ushqyer dhe ujitur pemën. Më parë duhet të ujitet, të pastrohet nga barërat e këqija, pastaj të presë ngrohtësinë e rrezeve të diellit. Kur të jenë plotësuar këto, pema do të gjallërohet dhe do të zbukurohet me gjethe të gjelbra. Pasi pema të ketë arritur në këtë stad, atëherë mund të presim edhe frutat. Kjo pra është koha që ajo të japë frutat e saj.” (Rutbetu’l-Hajat fq. 71)

Ashtu siç syri nuk mund të shohë asgjë nëse mungon drita, pa qenë drita e besimit dhe ndiki-



Nuk duhet të harrohet se në fakt, është zemra ajo që do të lexojë dhe do të zbulojë urtësitë e Kuranit dhe gjithësisë. Drita e besimit në zemra ndriçon me anë të meditimit. Prandaj jemi të detyruar t’i mësojmë zemrat tona të lexojnë jetën dhe gjithësinë, duke medituar dhe duke marrë mësim.

Në lidhje me këta (njerëz), në një ajet tjetër urdhërohet:

“...Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë

mi shpirtëror i Kuranit e i Sunetit, edhe syri i zemrës nuk mund të shohë asnjë të vërtetë. Ndërkohë që drita e besimit në zemra ndriçon me anë të meditimit. Prandaj jemi të detyruar t’i mësojmë zemrat tona të lexojnë jetën dhe gjithësinë, duke medituar dhe duke marrë mësim. Njerëzit e urtë kanë thënë:

“Kush e sheh këtë botë pa marrë mësim, syri i zemrës së tij verbohët aq sa është edhe niveli i pakujdesisë së tij.” (Ibën Ke-thir, I,448)

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“...Thuaj: A barazohet i verbri me atë që sheh? A s’po mendoni?” (el-En’am, 50)

Gjendja e mosmendimit, të cilën Allahu Teala e ka përmendur duke e ngjasuar me verbërinë, është mbulimi i zemrës me perde pakujdesie. Ka shumë sy që shohin, por që zemrat i kanë të ngurtësuar dhe u janë mbyllur ndaj urtësive dhe të vërtetave.

por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.” (el-Haxh, 46)

Njeriut të cilit i është verbuar syri i zemrës, të bukurën e sheh të shëmtuar dhe të shëmtuarën të bukur. Gjendja e Ebu Xhehlit, i cili vepronte i zhytur në errësirën e shirkut dhe injorancës, është shembulli më i mirë i kësaj të vërtete. Dhe kjo përkundër faktit që ai kishte pasur mundësinë ta shihte Profetin (a.s.), kushedi sa herë kur ishte në jetë, ndërkohë që shumë të dashuruar pas Profetit nuk e panë fytyrën e tij të bekuar. Mirëpo, ai mushrik i tërbuar, ishte zhytur në interesa të ngushta të kësaj bote dhe për shkak të errësirës verbuese që kishte në zemër, syri i tij nuk mundi ta shohë dritën e xhenetit që qëndronte para tij. Njëlloj si mënyra e shikimit të iblisit të mallkuar ndaj Adem-it (a.s.)...

Mevlana i nderuar thotë:

“Shejtani, pa baltën e Adem-it (përbërjen e trupit të tij prej balte), por nuk pa lartësinë e tij. Ai vuri re vetëm baltën që i përket kësaj bote dhe u verbua ndaj shpirtërores që i përkiste botës tjetër. Ajo që nuk dinte shejtani, ishte se njeriu ishte halifja (mëkëmbësi) i Allahut në tokë.”



“O njeri, nga kjo botë vijnë dy zëra të kundërt me njëri-tjetrin. Vallë, cilin prej këtyre dy zërave është e aftë të dëgjojë zemra jote? Një nga ata zëra është gjendja e atyre që mundohen t’i afrohen Allahut (të devotshmëve), ndërsa tjetra është gjendja e të mashtruarve (atyre që janë zhytur në gjynahe). Nëse e pranon njërin prej këtyre zërave, tjetrin nuk e dëgjon fare, sepse dikush që do diçka, është i verbër dhe i shurdhër ndaj gjërave të kundërta me atë që do.”

Dikush që në jetë e kushtëzon veten dhe vendos të shohë çdo gjë nga dritarja e neftit (epshit), ngelet gjithmonë i mbyllur në guaskën e vet dhe nuk arrin të shohë kurrë thelbin dhe të vërtetën e gjërave.

Ibën Ataullah Iskenderi thotë:

“Pjesa e jashtme e botës, është e bukur, ndërsa e brendshmeja mësimdhënëse. Nefsi sheh pjesën e jashtme (formën), ndërsa një zemër e stolitur me

ndjesi shpirtërore sheh pjesën e brendshme.”

Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme se çfarë shohim dhe si e shohim. I nderuari Ebu Ali Ruzbari thotë:

“...Dikush që e sheh nefsin e vet, qoftë edhe njëherë të vetme duke i dhënë më shumë vlerë se ç’ë meriton, (pra ai që është peng i mendjemadhësisë dhe mburrjes), nuk mund të shohë asgjë që ndodhet në gjithësi me syrin e urtësisë për të marrë mësim.”

Kjo do të thotë, se ai që ka një ego të fryrë, epih të pacipë dhe është tepër ambicioz, e ka të verbër syrin e zemrës. Prandaj, nëse dëshirojmë që syri i zemrës sonë të forcohet dhe drita e urtësisë sonë të shtohet, është kusht që ta edukojmë nefsin tonë me durim dhe përpjekje në rrugë të Allahut.

Në një hadith fisnik udhërohet:

“Në këtë botë, jetoni si mysafirë! Xhamitë konsiderojini si shtëpi! Zemrat tuaja mësojini me butësi (ndjesi dhe delikatesë)! Meditoni shumë (në shfaqjet e madhështisë dhe fuqisë hyjnore) dhe qani shumë (me shqetësimin që u jep mos falënderimi ashtu siç duhet për mirësitë e Allahut)! Dhe dëshirat e neftit (epshit) tuaj të mos ju ndryshojnë!..” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 358)

Edhe Ebu Bekri zemërbutë (r.a.), e pa Profetin tonë (a.s.), dhe u bë shoku e miku i tij më besnik. Ai e donte aq shumë Profetin (a.s.), saqë përmallohej edhe kur ishte pranë tij. Çdo moment të jetës së tij e jetoi me një dashuri dhe besnikëri të paparë për Profetin (a.s.).

Prandaj, asgjë nuk duhet parë nga dritarja problematike e epshit, ashtu siç bëri edhe shejtani. Përkundrazi, duhet përpjekur që çdo gjë të shihet me dritën shpirtërore si shembulli i Ebu Bekrit (r.a.) dhe besimtarëve të përsosur...

Ashtu siç thotë edhe poeti:

“Ajo që me dashuri shihet si dritë, me urrejtje shihet si zjarr.”

NDODHI MËSIMDHËNËSE

Ebu Sulejman Darani thotë:

“Kur dal nga shtëpia, kudo që më shkon syri, shoh një mirësi që më ka dhënë Allahu. Prandaj dhe (duke meditar në të) marr mësim prej saj.” (Ibën Kethir, I,447)

Edhe Sufjan bin Ujejne, në lidhje me këtë fakt, vazhdimisht përsëriste këtë thënie:

“Nëse mendon, njeriu merr mësim nga çdo gjë.” (Ihja, IV, 764)

Çdo moment i jetës, është i mbushur me ndodhi dhe shfaqje të panumërta, të cilat mund të jenë shkak për të kujtuar dhe për të marrë mësim prej fuqisë dhe madhësisë hyjnore. Në një prej shumë ajeteve fisnike, me të cilat Allahu Teala na fton të marrim mësim prej këtyre ndodhive dhe shfaqjeve, urdhërohet:

“Është Ai që ju tregon shenjat e Tij dhe ju zbret riskun prej qiellit. Por askush nuk e kujton këtë, përveç atyre që kthehen tek Ai të penduar.” (el-Gafir, 13)

Qëkur është krijuar bota e deri më sot, janë shtruar sofra të panumërta hyjnore dhe vazhdojnë të shtrohen çdo moment, duke mos u neglizhuar furnizimi i asnjë krijese. Nëse mendojmë për një çast; tre të katërtat e tokës janë të mbuluara me ujë. Ndërsa një e katërta e tokës përbëhet nga shkëmbinj ose shkretëtira, ku bimët nuk mund të zhvillohen. Një pjesë e vogël që mbetet është tokë e përdorshme. Mirëpo, fuqia madhështore e Allahut Teala, ka bërë që toka me anë të një lloj metamorfoze (ndryshimi i stinëve), të jetë burim ushqimi për të gjitha gjallesat.

Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Allahu Azze ue Xhel-le, ka urdhëruar: “Dhuro dhe unë do të dhuroj ty”. Thesaret e Allahut janë të mëdha. Asgjë prej asaj me të cilën furnizon krijesat, nuk e pakëson thesarin e Tij. Ai dhuron dhe furnizon ditë e natë pa ndërprerje. Mendo pak për ato që ka dhuruar

Allahu qëkur ka krijuar qiellin dhe tokën! Ato nuk kanë pakësuar asgjë nga pasuria e Tij.” (Buhari, Tefsir 11/2, Teuhid, 22.)

Sa i mahnitshëm është fakti që, kur bie borë dhe mbulon gjithçka, shumë gjallesa strehohen në gjirin e tokës dhe qëndrojnë të gjalla e të shëndetshme për një kohë të gjatë me mbrojtjen e Krijuesit të tyre. Me mëshirën e Allahut, toka bëhet si një djep i vërtetë për ta. Prandaj dhe nuk shohim kufoma të atyre gjallesave pasi shkrin bora, sepse ato dalin përsëri mbi tokë dhe vazhdojnë jetën e tyre.

Për ata që shohin me syrin e urtësisë për të marrë mësim, edhe këto fakte mjaftojnë për të kuptuar se sa i mahnitshëm është ekuilibri dhe rregulli hyjnor i gjithësisë, në të cilën jetojmë dhe veçanërisht urtësinë, diturinë dhe fuqinë e pafundme të Allahut Teala.

Përsëri, në një ajet fisnik, Allahu Teala urdhëron:

“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! Allahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka.” (el-Ankebut, 60.) Me anë të këtij ajeti, Allahu thekson se ambicia dhe shqetësimi i njeriut në lidhje me çështjen e riskut (furnizimit), është e kotë.

Hafiz Shirazi, në një poezi të vetën, e ka përkufizuar njeriun me këto fjalë:

“Një pikë gjaku, mijëra shqetësime.”

Nëse shohim me qëllim për të marrë mësim, në vitrinat hyjnore përreth nesh shohim lloje të ndryshme lulesh të cilat duken si barëra të thjeshta, por që nxjerrin prej tokës ngjyra, aroma dhe gjethe të ndryshme, të cilat mahnitin sytë dhe lodhin mendjet e shumë njerëzve të shkencës.

Ndërkohë që një kafshë e kthen barin në mish dhe në qumësht, njeriu i cili është më i përsosuri i krijesave, me të gjithë teknologjinë që ka në dispozicion sot nëpër laboratorët më të përparuar të kimisë, nuk arrin të prodhojë qoftë edhe një gram mish apo qumësht nga tonelata bari.

Nëse do të na ishte lënë në dorë për një ditë pro-

grami hyjnor i trupit të njeriut, që punon me një rregull të mahnitshëm, i ndonjë organi ose edhe i një qelize të vetme, ku zhvillohen me qindra reaksione kimike, nuk do të kishim duruar qoftë edhe disa minuta. Kushedi se sa dëme mund të shkaktonim!?

Sa e mahnitshme është kur shohim se nga një anë, një elefant dhjetëra tonësh mund të komandohet nga një fëmijë dhjetëvjeçar (nëse Allahu i jep aftësinë) dhe nga ana tjetër shohim se një virus i vogël, aq sa nuk mund të shihet me sy të zhveshur mposht trupa me fuqi të madhe!..

Kjo nënkupton se njeriu asnjëherë nuk duhet të mburret dhe nuk duhet t'ia atribuojë vetes forcën që ia ka falur Allahu Teala, nuk duhet të harrojë pronarin e vërtetë të mirësive dhe për këtë gjithmonë duhet të jetojë me ndjenja mirënjohjeje dhe falënderim. Gjithashtu, duhet të kuptojë se nuk është as sa një thërmijë pluhuri përpara fuqisë hyjnore dhe se duhet të kërkojë strehim tek Krijuesi i tij, sepse edhe fryma që jep e merr, është një prej mirësive të mëdha hyjnore.

Nëse bie shtypja atmosferike, ndërsa jemi në lartësi të madhe gjatë udhëtimit me një aeroplan i cili është prodhuar me teknologjinë më të lartë, përpara nesh do bien maskat e oksigjenit dhe jepet lajmërim për përdorimin e tyre. Mirëpo, askush nuk shqetësohet se "mos vallë nesër niveli i oksigjenit ngrihet nga 21 në 25, ose bie në 18 dhe të marrë një bombol oksigjeni". Kjo, sepse të gjithë, edhe ai që beson, edhe ai që nuk beson e vazhdon jetën e tij me një besim të natyrshëm në rregullin hyjnor... Përndryshe, nëse njeriu do të mendonte për çdo lloj rreziku me të cilin mund të përballlet çdo ditë, jeta do t'i bëhej e padurueshme.

Një njeri, i cili mendon rreth këtyre fakteve dhe të tjerave si këto ashtu siç duhet, nuk vonon të kuptojë se si të gjitha gjallesat mbi tokë kanë nevojë për ndihmën dhe mbrojtjen nga një dije dhe fuqi e madhe, qoftë edhe për të mbijetuar. Ai e kupton se të gjitha këto nuk mund të realizohen kurrë vetë dhe se jeton në botën e mrekullive hyjnore. Asnjë

mendje, e cila e kupton e këtë dhe ka logjikë, intuitë dhe ndërgjegje të shëndoshë, nuk guxon t'i ngrejë krye dhe të jetë mosmirënjohës ndaj Allahut Teala, që është Krijuesi i botëve dhe Rregullatori i tyre.

TË SHOHËSH ANËN MËSIMDHËNËSE TË NGJARJEVE

Ashtu si këto shfaqje në librin e gjithësisë, njeriu duhet të lexojë me syrin e urtësisë për të marrë mësim edhe nga ngjarjet me të cilat përballlet gjatë jetës. Sepse çdo ngjarje i jep me mijëra mesazhe një njeriu, i cili zotëron një zemër të ndjeshme dhe të butë.

P.sh., kur shohim një të sëmurë, duhet të mendojmë: "Edhe unë mund të isha në atë gjendje. Ky njeri i sëmurë ka nevojë për dashamirësi, mëshirë dhe in-

teresim nga ata që e rrethojnë. Prandaj edhe unë duhet t'i afrohem dhe të përpiqem t'ia lehtësoj vështirësitë. T'i plotësojë nevojat dhe ta ngushëllojë zemrën e tij të hidhëruar, sepse Profeti ynë (a.s.), shpesh herë pyeste: "A keni vizituar ndonjë të sëmurë sot?..."

Përsëri, kur shohim ndonjë aksident rrugor, duke menduar se "në atë aksident mund të isha edhe unë ose edhe të afërmit e mi", duhet të falënderojmë për mirësitë e jetës dhe shëndetit që

zotërojmë.

Kur të shohim ndonjë jetim, ai jetim duhet të na çojë deri tek Profeti ynë (a.s.) dhe të kujtojmë se edhe ai erdhi si jetim në këtë botë dhe të mendojmë për detyrat tona ndaj tyre...

Nga ana tjetër, nuk duhet të harrojmë se ashtu si çdo mirësi, edhe vështirësitë janë pjesë e sprovave. Nëse Allahu nuk na e ka bërë të mundur një gjë, këtë duhet ta shohim me syrin e zemrës dhe duke menduar se: "Edhe në atë ka një mirësi", e të falënderojmë për çdo gjë.

P.sh., nëse Allahu nuk na e ka bërë të mundur të kemi fëmijë, duhet të mendojmë se në këtë çështje që duket si mallkim, ka shumë mirësi të fshehura.

*Të mos harrojmë se gjendemi
në një botë sprovash të përkohshme
dhe se çështja më e rëndësishme,
është të arrijmë të bëhemi robër
të mirë të Allahut. Prandaj, pa ngecur
në pengesat e thjeshta të jetës,
duhet të ruajmë qetësinë e
shpirtërore.*

Ka shumë prindër, të cilët, për shkak të jetës së keqe ku janë zhytur fëmijët e tyre që merren me vrasje, imoralitet, drogë dhe të tjera si këto, përfetojnë hidhërimi të jashtëzakonshme të cilat të bëjnë të harrosh gëzimin e të qenit prind. Për shkak se nuk e dimë se me çfarë surprizash është e mbushur jeta, duhet të përiqemi që në çdo lloj gjendjeje të jemi falënderues, sepse ndonjëherë, vështirësia që jep Allahu, është e fshehur në mirësi dhe ndonjëherë mirësia është e fshehur në vështirësi.

Të mos harrojmë se gjendemi në një botë sprovash të përkohshme dhe se çështja më e rëndësishme, është të arrijmë të bëhemi robër të mirë të Allahut. Prandaj, pa ngecur në pengesat e thjeshta të jetës, duhet të ruajmë qetësinë e shpirtërore.

Skena më mësimdhënëse dhe më e rëndësishme e jetës është kur shohim ndonjë xhenaze. Njëherë e pyetën të nderuarin Hatem-i Esamin:

“Kur dhe si mund të bëhemi prej atyre që e shohin botën me syrin e urtësisë për të marrë mësim?”

Hatem-i Esam u përgjigj:

“Kur të shihni (kuptoni) se fundi i çdo gjëje në këtë botë është shkatërrimi dhe se toka është vendi ku do të shkojnë të gjithë! Nëse dikush nuk merr mësim nga një xhenaze, e cila del nga shtëpia e tij apo e ndonjë të afërmi, atij nuk i bëjnë dobi as dija, as urtësia dhe as këshilla.”

Prandaj dhe kur të shohim ndonjë xhenaze, të mendojmë: “Sot në atë tabut mund të isha unë” dhe të llogaritim veten për gjithçka që kemi bërë në jetë. Duhet të mendojmë se në varr do të hyjmë vetëm me qefinin si pjesë e kësaj bote, pastaj edhe qefini edhe trupi ynë do të kthehet në origjinë (në dhe) dhe se ato që do të ngelen pas janë vetëm besimi dhe veprat tona. Gjithashtu, të kemi parasysh se trajtimi që i bëhet xhenazes që shohim, një ditë patjetër do të na bëhet edhe ne.

Sa mësimdhënëse janë këto fjalë të Hasan Basriut:

Kur ishte në një ceremoni varrimi, pasi mbaruan të gjitha ceremonitë, Hasan Basriu pyeti dikë që kishte pranë:

“Vallë a mendon më ky njeri që ka vdekur, të kthehet përsëri në këtë botë dhe të shtojë punët e mira, dhikrin e të kërkojë falje për gjynahet?”

Njeriu i thotë:

“Po! Sigurisht që mendon.” Pas këtyre fjalëve, Hasan Basriu thotë:

“Atëherë, po ne pse nuk mendojmë si ky njeri që ka vdekur?” (Ibnu’l-Xheuzi, el-Hasenu’l Basri)

Prandaj, edhe ne duhet ta kuptojmë mirë se pjesa e jetës që na ka mbetur, është një afat të cilin na e ka dhënë Allahu dhe sipas kësaj duhet ta vlerësojmë mirë atë, duke e përgatitur veten për të vërtetën e pashmangshme të vdekjes.

Shkurtimisht, që nga thërmija më e vogël e deri te trupi më i madh qiellor, i gjithë kozmosi dhe çdo gjë që ndodh në të, është një poezi e mrekullueshme e mbushur me urtësi dhe mësim për

zemrat që dinë të lexojnë... Shkollimi më i rëndësishëm në këtë jetë, që është edhe vendi i provimeve hyjnore, është që të gjitha këto t’i lexojë me syrin e zemrës. Siç thotë edhe Shejh Sadi Shirazi:

“Në shikimin e njerëzve të mençur, çdo gjethë peme është një poezi e mrekullueshme që dëfton Allahun. Ndërkohë që për të shkujdesurit, të gjitha pemët nuk vlejnë as sa një gjethë.”

Allahu Teala na i ruajttë zemrat nga ngathësia nëndikimin e harbutërisë së nefsit tonë. Na dhëntë një zemër të ndjeshme, e cila do të mund të lexojë çdo gjë, që nga thërmijat më të vogla e deri tek trupat më të mëdhenj qiellorë,, sipas urdhrit “Lexo!” të të Madhërishmit. Gjithashtu, na e bëftë të mundur të përfitojmë nga fshehtësitë dhe urtësitë e gjithësisë dhe ndodhive në të...

Amin!



Agimi

është koha e pastrimit të besimtarit

Dr. Kerim Bulladë

Në Kuranin Fisnik, në sure të ndryshme, flitet për cilësitë e besimtarëve, për besimin e tyre të fortë, për dhënien pas ibadetit, për përpjekjet që shfaqin në dhënien për hir të Allahut Teala, për konceptimin e nderit, për ruajtjen e amanetit, për respektin që kanë kundrejt Allahut të Madhëruar dhe për largimin e tyre prej gjërave që nuk u interesojnë. (Shih. El-Bekare, 1-5; el-Mu'minun, 1-9, etj.) Në këtë shkrim, do të flasim vetëm për disa cilësi të besimtarëve.

1. Natën e kalojnë duke i bërë sexhde Allahut Teala. Besimtarët bëjnë shumë ibadet edhe natën, ashtu siç nuk i nënvlerësojnë ibadet e ditës,

ndërkohë që punojnë për të fituar dhe për të plotësuar nevojat e shtëpisë. Kurani Fisnik thotë kështu për ata:

“Robërit (e veçantë) të Rrahmanit janë ata që ecin me modesti në tokë. Kur u hedhin ndonjë fjalë injorantët, ata thonë paqe (pa i lënduar ata)! Ndërsa natën e kalojnë duke bërë sexhde dhe kijam (pjesë e namazit që fillon me tekbirin fillestar dhe mbaron në ruku).” Kur besimtarët hyjnë në mbrëmje në shtëpitë e tyre, nuk e kalojnë kohën pa u marrë me diçka. Ata e përmendin gjithmonë Allahun e Madhëruar kur janë duke pushuar, kur janë ulur dhe kur ngrihen. Besimtarët nuk janë neglizhentë në këtë çështje. Ata i drejtohen Allahut Teala, qëndrojnë në audiencën e tij dhe falin namaz në mënyrë të sinqertë.

Besimtarët veprojnë të vetëdijshëm për ekuilibrin e ndjeshëm që shprehet në ajetin kuranor, ku Allahu i Madhëruar thotë:

“A mund të jetë (i njëjtë me mohuesin) ai që e kalon natën duke bërë sexhde e duke qëndruar në kijam, që frikësohet për ahiretin e tij dhe kërkon mëshirën e Zotit?..” (ez-Zumer, 9)

Besimtarët veprojnë duke e kuptuar delikatesën dhe rëndësinë e detyrës që u është dhënë. Qëndrimi në sexhde dhe qëndrimi në kijam, është cilësia themelore e tyre. Besimtarët bëjnë sexhde në orët e vona të natës dhe lexojnë ajetet e Allahut Teala. (Shih. Ali Imran, 111) Besimtarët bëjnë sexhde duke qarë kur përmenden ajetet e Allahut Teala, që është shumë i mëshirshëm dhe ndjekin rrugën që të shpie te

e vërteta dhe rrugën e pejgamberëve të zgjedhur, si Hz. Ademi, Hz. Nuhu, Hz. Ibrahim, Hz. Jakubi, Hz. Ismaili (Shih. Merjem, 58) dhe Hz. Muhamedi, sallallahu alejhi ve sellem.

2. Flenë pak natën. Kurani Fisnik i shpreh kështu cilësitë e bukura të besimtarëve, që e kanë merituar xhenetin në këtë botë:

“Pa dyshim, ata që i frikësohen Allahut do të jenë në kopshte dhe burime duke marrë atë që ua ka dhuruar Zoti i tyre, meqë më parë kanë qenë punëmbarrë. Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu). (edh-Dharijat, 15-18)

Besimtarët bëjnë punë të mira në këtë botë. Nuk u hyn gjumë në sy, për shkak të dashurisë ndaj Allahut dhe ngaqë frikësohen për ahiretin e tyre. Në këtë mënyrë, bëjnë ibadet dhe kryejnë obligimet e tyre. Ata nuk flenë në kohën e agimit dhe i kërkojnë falje Allahut Teala për gabimet e tyre. Agimin që është koha më e përshtatshme për lutje dhe istigfar, e kalojnë me ibadet. Istigfarin që meriton të pranohet nga Zoti, e bëjnë këta njerëz të mirë.¹

Besimtarët bëjnë ato gjëra për të cilat janë urdhëruar dhe i lënë ato të cilat i kanë të ndaluara. Të flesh pak, të bësh shumë ibadet, të kërkoj falje natën, ta zbukurosh atë me lutje dhe përgjërime, janë cilësitë më të dallueshme të besimtarët. Për shkak të këtij sinqeriteti dhe besnikërie ndaj Allahut Teala, arrijnë kënaqësinë e Zotit (xh.xh.), dhe fitojnë xhenetin me mirësinë e Tij.

3. Trupat e tyre qëndrojnë larg shtretërve. Besimtarët qëndrojnë gjatë pa fjetur natën. Ata digjen me dashurinë për të fituar shtretërit e jastëkët e përherëshëm (err-Rrahman, 54; el-Vakia, 34; el-Gashije, 15) dhe qëndrojnë larg shtretërve e jastëkëve të përkohshëm. Kurani Fisnik i thekson kështu cilësitë themelore të besimtarëve:

“Shpalljet Tona i besojnë vetëm ata të cilët, kur u përmenden, bien në sexhde, dhe të cilët e adhurojnë Zotin e tyre, e lavdërojnë dhe nuk bëhen mendjemdhënj. Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ta (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë. Vallë! A është besimtari njësoj si keqbërësi?

1. Elmallëllë, Muhammed Hamdi Yazir, Hak Dini Kur'an Dili. Ata që e kanë thjeshtëzuar: Ismail Karaçam shokët e tij, Gjermani, pa datë, VII, 255.

Jo, ata nuk janë të barabartë. Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë Xhenetin strehim, si shpërblim për punët (e mira) që kanë bërë.” (es-Sexhde, 15-19)

Besimtarët janë gjithmonë ndërmjet frikës dhe shpresës. Ata gjithmonë shpresojnë në mëshirën e Allahut të Madhëruar. (Shih. ez-Zumer, 53) Nga ana tjetër, frikësohen nga zemërimi dhe ndëshkimi i Allahut Teala. Ata shpresojnë xhenetin, por frikësohen shumë edhe nga xhehenemi.

4. Namazet i falin vazhdimisht. Besimtarët i falin gjithmonë namazet e tyre. Ata nuk i lënë pesë vaktet, namazin e xhumasë dhe namazet e bajrameve. Përveç namazeve farz, ata nuk nënvlerësojnë edhe namazet nafle. Besimtarët i falin namazet vazhdimisht, ashtu siç shprehet edhe në ajetin kuranor:

“Ata janë të vazhdueshëm në faljet e tyre.” “Ata që i falin namazet rregullisht.” (el-Mearixh, 23, 34)

Ata janë të kujdesshëm ndaj namazeve, ashtu siç ruajnë jetën e tyre, sepse ua dinë vlerën. Ata kurrë nuk qëndrojnë larg rukusë dhe sexhdes. Në çfarëdo kushtesh që të jenë, nuk e lënë namazin për asnjë lloj pune, pozite, grade, pasurie dhe fame. E pranojnë namazin si një argument real të besimit të tyre. Ata e duan namazin, i cili është një praktikë dhe një argument i jashtëm i fjalës së Teuhidit. Ata ndjejnë dashuri për namazin si për dritën e syve të tyre.

Besimtarët i vazhdojnë ibadetet, namazet dhe lutjet derisa t'u vijë jakini (vdekja). Ata veprojnë brenda kornizës së urdhrave hyjnorë për të cilët bëhet fjalë në këto ajete kuranore:

“Tani, lartësoje Zotin tënd duke e lavdëruar dhe bëhu prej atyre që i përuken Atij duke u falur! Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!” (el-Hixhr, 98-99)

Ata përpiqen të lartësohen pa u vënë rëndësi nënvlerësimeve, talljeve dhe nënçmimeve të askujt. Ata ndjejnë kënaqësi me vetëdijen ndaj ibadetit, i cili u është gdhendur në shpirtrat e tyre dhe përjetojnë qetësi shpirtërore duke falur namaz. Ata e dinë se në jetën e ibadetit nuk ka qetësi, pushim, raport apo ndërprerje dhe në këtë mënyrë përpiqen ta plotësojnë jetën e tyre të përkohshme. Për këtë arsye, në çdo punë të besimtarit ka mirësi.





DUHANI

DUKURI VRASTARE PËR VETEN DHE TË TJERËT

Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi

Thuajse nuk ka vend në botë ku nuk pihet duhani. Në vendet e zhvilluara konsumi mesatar vjetor i duhanit për një banor është rreth 2 kg, ndërsa në vendet në zhvillim rreth 0.8 kg.

Sipas hulumtimeve të bëra mendohet se në tërë botën pinë rreth 50% të meshkujve dhe më tepër se 25% të femrave. Kështu p.sh., në Britaninë e Madhe pinë afro 75% të meshkujve dhe 50% të femrave, në Rusi 70% të meshkujve dhe 40% të femrave. Në përgjithësi në botë edhe tek ne, është në rritje numri i duhanxhinjve me tendenca të përfshirjes edhe të të rinjve dhe të fëmijëve.

MOTIVIMI PËR DUHAN

Pirja e duhanit nuk është vetëm një shprehje (ves) e thjeshtë, por paraqet një kompleks të tërë shprehish dhe situatash shoqërore të duhanxhiut në jetën e përditshme.

Ja vetëm disa nga arsytet më të rëndësishme të pirjes së duhanit: për shkak të nervozizmit, për shkak të relaksimit, për shkak të vetmisë, për shkak të mosaktivitetit, për shkak të dietës, për shkak të shoqërisë, për fitimin e vetëbesimit, për rritjen e kënaqësisë, për zbutjen e moskënaqësisë, nga shprehia, për stimulim, si dëshirë për identifikim, si një dëshmi e forcës dhe pozitës së lartë në shoqëri (pirja e cigareve të shtrenjta), si një formë e lajkatimit, mashtrimit, ikje nga problemet personale, si mjet për pagjumësi (portierët, rojat, etj.).

PËRBËRËSIT E TYMIT TË DUHANIT - FAKTORË TË RREZIKUT

Konsiderohet se në tymin e një cigareje ka rreth 70 mg thërmija të forta dhe 23 mg gaz. Në cigaren e fabrikuar ka rreth 6% nikotinë, 30% hidrokarbur, 17% acide organike, 13% albuminë dhe 2% vajra eterike. Në përbërjen e tymit të cigares ka edhe produkte të tjera helmuese si acid azotik, acid hidrocianid, amoniak dhe cianid, të cilët veprojnë në mënyrë shkatërruese në mukozën e rrugëve të frymëmarrjes

dhe të traktit digjektiv.

Nikotina është elementi më i njohur toksik i cigares. Depërton në gjak dhe përhapet në të gjitha qendrat vitale të organizmit, duke u grumbulluar në mënyrë selektive në organet me rëndësi jetike: në tru, mushkëri dhe gjëndrra seksuale.

Për njeriun nuk është më pak i dëmshëm edhe monoksidi i karbonit, si përbërës i tymit të cigares. Nga një pako cigare lirohen afro 400 mg të këtij gazi, i cili shkatërron rruazat e kuqe të gjakut. Ai kontakton shumë më lehtë dhe më aktivisht me Hb duke e kthyer në kompleks kimik-karboksil Hb. Në këtë mënyrë, shumica e organeve dhe indeve të duhanxhinjve marrin oksigjen në sasi shumë më të vogla (veçanërisht truri).

Në tymin e cigares ka mjaft rrëshirë katrani. Hulumtimet kanë dëshmuar se këto nxisin sëmundjet kancerogjene. Duke pirë 20 cigare në ditë njeriu fut në trup afër 1 gr katran cigareje, i cili kryesisht mbetet në mushkëri.

Cilësi kancerogjene kanë edhe elementet radioaktive që përmban tymi i cigares: izotope plumbi, bismut, polonium. Poloniumi depërton lehtë në pjesët më të imëta të organizmit, veçanërisht në mushkëri dhe gjëndrrat seksuale.

“Duhanaxhiu i vërtetë” merr gjatë ditës dozë të konsiderueshme të rrezatimit, i cili është i dëmshëm për brezat trashëgues.

Cigarja përmban edhe elemente të tjera që janë gjithashtu të rrezikshme për shëndetin. Në cigare janë zbuluar sasi të konsiderueshme të formaldehidit, zhivës, kadmiumit . . .

Regjistri i elementeve të dëmshme të cigares mund të vazhdohet edhe më tutje.

Analizat laboratorike kanë treguar se elementet toksike të duhanit shkatërrojnë një varg vitaminash që janë të rëndësishme për zhvillimin e proceseve metabolike. Vetëm

një cigare neutralizon afro 25 mg të thartinës askorbike (Vitamina C).

PASOJAT E DUHANIT PËR SHËNDETIN

Pirja e duhanit është shkaktar kryesor dhe i veçantë i sëmundjeve dhe i vdekjeve të parakohshme. Duhaxhinjtë vdesin 5-8 vjet më herët se ata që nuk pinë duhan dhe janë të rrezikuar dy herë më shumë nga sëmundjet fatale të zemrës, dhjetë herë më shumë nga tumori në mushkëri, gojë, fyt, kapërcyell, pankreas, veshkë, fshikë urinare, mitër, dy deri tri herë më shumë nga ulçera.

Fëmijët e prindërve që pinë duhan lindin me peshë të vogël, shpesh me infeksione të mushkërive, më shumë infeksione kronike të veshit dhe me shumë mundësi për t'u bërë duhaxhinj më vonë.

Gjithashtu, veprimet e dëmshme të tymit të duhanit vërehen në gjëndrrat endokrine dhe sistemin nervor, që janë rregullatorë të jetës sonë. Tek meshkujt shkakton impotencë, ndërsa tek femrat çrregullim të ciklit menstrual dhe dëmtim të funksioneve germinative dhe sterilitet.

Me kalimin e kohës, nën ndikimin e toksimit me duhan ngushtohen enët e gjakut të organeve vitale me pasoja fatale.

Lindjet e parakohshme, abortimet dhe vdekshmëria e foshnjave pas lindjes janë 2-3 herë më të mëdha tek shtatzënat që pinë duhan.

Praktikisht, të gjitha toksinet e tymit të duhanit depërtojnë në qumësht nëpër gjëndrrat qumështore. Qumështi i helmuar arrin në lukthin e foshnjës dhe shpërndahet në tërë organizmin, kurse materiet e tij toksike veprojnë në dobësimin e mekanizmave mbrojtës të foshnjës. Në gjakun e foshnjës janë gjetur një varg toksinësh të duhanit, që veprojnë në strukturat e trurit të madh.

DUHANI DHE GJENET

Pirja e duhanit, siç është e njohur, është njëri ndër shkaqet kryesore të sëmundjeve të organeve të brendshme p.sh., të sistemit kardiovaskular dhe gastrointestinal, të cilat barten me trashëgim. Analizat gjenetike kanë treguar se nënat që pinë duhan, lindin fëmijë me predispozita për zhvillim më të hershëm të proceseve arteriosklerotike.

Rrezatimi jonizues i duhanit dëmton gjenet, te pasardhësit shkakton edhe zhvillimin e epilepsisë dhe të sëmundjeve të tjera të sistemit nervor.

Pjesëmarrja e anomalive kongjenitale të zemrës te fëmijët e prindërve që pinë duhan, është dyfish më e madhe sesa te fëmijët e prindërve që nuk pinë duhan.

PIRJA PASIVE E DUHANIT

Joduhaxhiu, i cili qëndron në afërsi të duhaxhiut, thith deri 80% të të gjitha materieve të tymit. Ky tym, vetëm për 5 sekonda pasi të futet në organizmin e joduhaxhiut kryen veprimet e veta toksike.

Hulumtimet kanë treguar se në ambientin e ndotur me

tym cigareje tek joduhaxhitë manifestohet me lodhje, marramendje, zvogëlim të aftësive të kujtesës, rritjen e tensionit të gjakut dhe rritjen e sedimentacionit të eritrocitve.

NDALIMI I PIRJES SË DUHANIT

Për të qenë sa më efikase lufta kundër pirjes së duhanit, në këtë aktivitet të madh duhet të inkuadrohet tërë shoqëria.

Lufta kundër pirjes së duhanit është kuptuar më seriozisht në shtetet perëndimore, si Norvegji, Britani e Madhe, Luksemburg, ku organizohen seminare grupore 5 ditore kundër duhanit.

Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet veprimtarisë profilaktike ndaj popullatës së re. Pikërisht në fëmijëri krijohet dhe zhvillohet mënyra e shëndoshë e të jetuarit.

Për gjendjen e tanishme të përhapjes së duhaxhinjëve, OBSH i bën përgjegjës kryesorë në radhë të parë prindërit, pastaj shkollat e në fund shërbimet shëndetësore.

Të mos harrojmë se roli i predikuesve fetarë është tejet i madh.

Prandaj, është e nevojshme që sa më herët të fillojë luftimi i kësaj shprehje me masa parandaluese.

Masat parandaluese më të rëndësishme janë: arsimimi i nxënësve në të gjitha shkollat fillore e të mesme, duke futur orë të mësimit të detyruar, arsimimi shëndetësor i qytetarëve përmes mjeteve të informimit masiv, ligjëratave, etj., themelimi i shoqatave ose i klubeve të joduhaxhinjëve, për terapi grupore, informimi detal mbi dëmet që pasojnë nga pirja e duhanit dhe mundësitë e shërimit.

Meqë shëndeti i qytetarëve të çdo shteti është pasuria më e madhe, në luftën kundër pirjes së duhanit duhet të angazhohen të gjitha organizatat shoqërore dhe politike.

OBSH propozon strategjitë kundër pirjes së duhanit në nivel ndërkombëtar dhe nacional (kombëtar).

STRATEGJIA NË NIVEL NDËRKOMBËTAR

Aktivizimi i tërë sistemit të OBSH-së.

Aplikimi dhe përparimi i bashkëpunimit me të gjitha organizatat kombëtare që merren me shëndetësi.

Shkëmbimi i përvojave ndërkombëtare në eliminimin e epidemisë së pirjes së duhanit.

Koordinimi dhe matja e studimeve bazike dhe të aplikuar në këtë lëmë.

Formimi i grupeve të ekspertëve për përpunimin e problemeve sanitare legjislativë, etj.

Organizimi i seminareve regjionale për nxitjen e aksioneve kundër duhanit.

STRATEGJIA NË NIVEL KOMBËTAR

Futja dhe aplikimi i përpiktë i masave legjislativë, edukative, etj.

Vendosja dhe zbatimi i masave kufizuese në prodhimin



e duhanit.

Ulja e të gjithave subvencioneve në prodhimin e duhanit.

Masat e nevojshme në uljen e eksportit dhe importit të duhanit.

Rritja e të gjitha taksave fiskale.

Mobilizimi i të gjitha shoqatave: vullnetare, mjekësore, profesionale, arsimore, humanitare, dhe formimi i shoqërive dhe fondeve për luftë kundër pirjes së duhanit:

- t'i ndalohet shitja e duhanit rinisë,
- ndalimi i duhanit në vende publike,
- ndalimi i reklamimit dhe zbatimi i masave të tjera represive.

TAKTIKA SHOQËRORO-MJEKËSORE DHE STRATEGJIA E LUFTËS KUNDËR PIRJES SË DUHANIT

Taktika globale kundër pirjes së duhanit hartohet në programe të përgjithshme dhe specifike.

Me rastin e programit të përgjithshëm, metoda më e suksesshme është terapia grupore.

Ndërsa variantet themelore të trajtimit specifik janë: aplikimi i medikamenteve (placebo ose trankvilizorët - Nicostop, Nikobrevin), zëvendësimet nikotike, çamçakëzë nikotink, terapia elektro - averzive - cigaret elektronike.

Trajtimi specifik është më pak i suksesshëm sesa trajtimi i përgjithshëm.

Njëri ndër shkaqet e pirjes së madhe të duhanit është që masat shëndetësore të luftës kundër duhanit kanë ndikim shumë më të kufizuar në krahasim me fuqinë që kanë masat shtetërore që stimulojnë prodhimin e tij. Këtu gjen shprehje interesi ekonomik, i cili në esencë, është kauzi ekonomik.

OBSH ofron dy receta për ndërprerjen individuale të pirjes së duhanit.

Me këtë metodë 95-97% e kanë lënë duhanin pas 5 ditëve.

RECETA 1

Vendosni të pini vetëm një cigare gjatë një ore.

Nëse pini duhan e mbani cigaren në dorën e djathtë, provoni ta mbani në dorën e majtë.

Filloni të pini cigaret që nuk ju pëlqejnë.

Nëse keni pirë cigare me kafe, filloni të pini lëng frutash në vend të kafesë.

Merruni me gjimnastikë.

Thirrni miqtë dhe u tregoni atyre qëllimin për lënien e duhanit.

Nëse do të mund të duroni pa pirë duhan vetëm një ditë, do të mund të mos pini edhe ditën tjetër. Provojeni këtë!

Kurseni paratë që keni planifikuar për blerjen e duhanit dhe në vend të cigareve blini ndonjë gjë për vete. Këtë e keni merituar.

Mos u dëshpëroni nëse nuk keni mundur të duroni dhe e keni ndezur cigaren. Disa bëjnë shumë përpjekje para se ta lënë përfundimisht duhanin.

RECETA 2

Mos pini duhan në prani të fëmijëve dhe të gruas.

Mos pini duhan esëll, sepse kjo dëmton shpejt mukozën e lukthit.

Mos pini duhan as para se të flini, as natën.

Mos pini duhan kur ecni, sepse rritet veprimi i produkteve të tymit të duhanit në funksionimin e organeve më të rëndësishme.

Mos pini duhan në lokale të mbyllura.

Mos pini $\frac{1}{4}$ e fundit të cigares, sepse aty bëhet koncentrimi më i madh i elementeve të dëmshme për jetën.

Përpiquni ta pini duhanin pa e futur tymin brenda në organizëm, sepse gjatë thithjes 95% e nikotinës arrin në gjak.

Mos pini cigare me lagështi.

Mos pini duhan, nëse vuani nga sëmundjet kronike.

Mos pini duhan kur keni për të kryer punë të rëndësishme, ku nevojitet fuqia mendore e fizike.

Nëse arrini t'i zbatoni në jetë këto, mund të shpresoni se për disa muaj do të mblidhni forcat tuaja dhe do t'i thoni lamtumirë duhanit, si një shprehi shumë e dëmshme për shëndetin tuaj dhe të tjerëve (tregimi për duhanxhinjtë).

FJALA PËRMBYLLËSE PËR DUHANIN

Motra, vëllezër të dashur, të rinj e të mos-huar, djalosh e vajzë dhe ti vogëlush, nëna dhe baballarë të nderuar!

Kjo që u cek më lart le të jetë mësim për ju që e pini duhanin, që të shpëtoni nga kjo shprehi e rrezikshme, përbuzni dhe flakni këtë dukuri të dëmshme individuale dhe kombëtare.

Ajo që është e dëmshme, ajo që shkatërron shëndetin, pasurinë tuaj e bashkë me këtë edhe fatin tuaj, nuk mund të jetë as moderne, as kulturë e as civilizim.

Përkujtoni vazhdimisht fjalët e Zotit të dashur: **"Mos e mbytni veten tuaj . . .", Mos hidhni veten në rrezik . . ."**, si dhe fjalët e të Dërguarit të Tij: **"Askujt (as vetes dhe as tjetrit) s'guxohet t'i bëhet dëm!"**

I drejtohem Zotit Hirmadh me fjalë të sinqerta:

"O Zot i madh dhe i vërtetë, largoji besimtarët shqiptarë nga ky kob, shkatërrues i vërtetë, i cili dëmton shëndetin pasurinë dhe ndot ambientin.

Vetëm kështu duke mos pirë duhan bëhemi të shëndetshëm, të përparuar dhe të kulturuar!"





Dynjaja

gjërat e tjera të përkohshme

M. Sami Ramazanogllu

Përderisa në një zemër të ketë dashuri ndaj gjërave të përkohshme, do të thotë se në atë zemër nuk ka dashuri për Allahun e Madhëruar, sepse Allahu Teala, në Kuranin Fisnik, thotë:

“Allahu nuk i ka dhënë asnjë njeriu dy zemra në kraharor..” (el-Ahzab 4.) Domethënë, dashuria ndaj Allahut Teala është e pamundur që të bashkohet me dashurinë ndaj gjërave të përkohshme.

Përderisa në një zemër ka dashuri ndaj gjërave të përkohshme, në atë zemër nuk ka dashuri ndaj Allahut të Lartësuar. Fitimi i dashurisë hyjnore arrihet vetëm me pastrimin e zemrës.

Dy gjëra të kundërta nuk mund të bashkohen dhe nuk mund të lartësohen bashkë.

Në një zemër ku ndodhet dashuria ndaj Allahut, është e qartë se nuk mund të ketë dashuri ndaj kësaj bote.

Kur zemra e butë e një saliku (pasuesi të Islamit) pastrohet nga papastërtia e gjërave të përkohshme, pa dyshim që ajo bëhet vend i dashurisë hyjnore dhe i njohjes së Zotit (xh.xh.).

Kur Allahu Teala i bashkoi shpirtat në botën e tyre, engjëjt i thanë:

“O Zot! A do t’i zbresësh në tokë ata? Toka nuk mund t’i zërë të gjithë.

Allahu, xhelle xhelaluhu, u tha:

“Unë zbrës një pjesë prej tyre dhe i bëj të vdesin një pjesë prej tyre. Në këtë mënyrë vazhdon jeta në tokë.”

Engjëjt i thanë:

“O Zot! Nëse këta (njerëzit) e shikojnë vdekjen, nuk mund të bëjnë asnjë punë atje (në dynja) prej frikës së saj (vdekjes).”

Allahu, subhanehu ve teala, u tha:

“Unë do t’u jap atyre një dashuri për dynjanë, saqë nuk do t’u bjerë ndërmend vdekja.”

Durimi i Allahut Teala nuk ka fund. Njerëzit si Faraoni, pohojnë se janë zot, por përsëri Allahu i duron.

“Turpi është prej besimit.” (Muslim, Keshfu’l-Hafa, 1443.)

“Turpi i vërtetë, të ndalon nga bërja e mëkateve edhe kur gjendesh në një vend i vetëm, duke besuar se Allahu i Madhëruar ndodhet në çdo vend me dijen e Tij, dëgjon çdo gjë dhe shikon çdo gjë.”

Turp vetjak kanë edhe qafirët. Një qafir turpërohet nga zbulimi i vendeve të turpshme pranë një njeriu tjetër, kështu që nuk i zbulon.

“Mos e refuzo lypësin, edhe nëse është qafir.”

Lypësi është dhuratë e Allahu të Madhëruar. Refuzimi i tij do të thotë se nuk ke nevojë për Allahun Teala.

Nëse nuk gjeni gjë për t’i dhënë, atëherë largojeni duke i thënë një fjalë të mirë. Veçanërisht, duhet të kemi kujdes ndaj lypësve që vijnë pas namazit të akshamit.

Allahu (xh.sh.), ka robër të çrregullt në paraqitje, por që janë aq të vlefshëm, saqë, nëse betohen në çështje të rëndësishme, kanë të drejtë.

“Dhënia e lëmoshës, e largon fatkeqësinë dhe e zgjat jetën.” (I njëjti libër, II/28.)

Mëshira e Allahut Teala është e bollshme, por në këtë kohë ka pak njerëz që e kërkojnë. Për këtë arsye, me pak mundim, fal shumë mirësi.

Përgojimi është haram, por ka edhe përgojim që është synet, mustehab, vaxhib dhe i lejuar.

Përgojimi i mëkatarëve nuk është mëkat.

Përgojimi i atyre që nuk falin namaz, që vjedhin, që mashtrojnë dhe që pijnë alkool, nuk është haram.

Tregojini ata që mashtrojnë, në mënyrë që të tjerët të bëjnë kujdes prej tyre.

Të supozojmë se njëri prej dijetarëve pi alkool. Nëse përgojohet dhe ka mundësi që ta lërë, ky përgojim është synet.

Atyre që vijnë për t’u konsultuar për ndonjë mangësi që mund të ketë vajza e fqinjët në lidhje me martesën, u konsiderohet vaxhib.

“Politeistët janë të papastër.” (Surja et-Teube, 28.) Ajeti fisnik synon aspektin shpirtëror të tyre.

Pastërtia e jashtme e politeistëve është e shkëlqyer, por Allahu i Madhëruar i quan ata të “papastër”, për shkak se zemrat e tyre janë të papastra.



Ringjallja e rrugës shpirtërore të Islamit

Vehap Kola

I. Tradita si rrëfim (hadith)

Në ligjërimin fetar islam modern vërehet një retushim i rrezikshëm i traditës profetike. Aq i guximshëm është ky retushim, saqë arrin të censurojë dhe të ndryshojë edhe përmbajtjen e veprave të dijetarëve tradicionalë islamë që kanë një bosht shpirtëror solid, por fatkeqësisht krejt të papranueshëm nga logjika legaliste dhe e fjalëpërfjalshme e shkencave islame në epokën e modernitetit. Kjo logjikë shfaqet si paaftësi e mendjes së studiuesit apo publikut mysliman bashkëkohor për të dalë nga një kuadër i stisur që kufizon islamit në një grup rregullash të jashtme - ligj, ideologji dhe identitet socio-politik. Duke mos e dëshiruar përhapjen në këto diskutime që meritojnë vëmendje të dedikuar dhe punë mirëfilli studimore, të qëndrojmë në mënyrën si na është paraqitur tradita profetike nga kjo mënyrë e të menduarit dhe jetës.

Librat e mëdhenj të *hadith*-it janë vepra me rëndësi qendrore për vijimësinë e Islamit. Ato kanë ruajtur të indeksuar dhe të kualifikuar sipas kriteresh të rrepta shkencore gjithë fondin e porosive dhe veprimtarive të Profetit. Në këtë mënyrë, ato garantuan një mbështetje të fortë dhe një filter të hollë për trashëgiminë e traditës së jetuar, që u vu në jetë nga Profeti dhe u ruajt, po duke u vënë në jetë, nga të gjithë brezat e besimtarëve gjatë shekujve. Megjithatë këtë rol madhështor të literaturës së hadithit, shumë shkencëtarë tjerë patën fatin e tyre të lëvrimit dhe sistemimit disiplinuar nga korpusi i dijetarëve të shumtë që njohu historinë e Islamit. Interpretimi i Kuranit (*tefsir*), shkencë e bazave të të kuptuarit (*usul el-fikh*), jurisprudencë (*fikh*), udhëtimi shpirtëror (*tesawuf*) u zhvilluan nga koha në kohë dhe përbëjnë sot arkivën e shkencave fetare islame. Për këtë arsye, ato duhen marrë si plotësuese të njëra-tjetrës dhe jo si qasje reciprokisht përjashtuese ndaj të kuptuarit të fesë. Për fat të keq, përgjatë kursit të historisë ka ndodhur kjo e dyta.

Ajo që bashkësisht botërore myslimane (*ummeh*) ka trashëguar si traditë profetike, është një tërësi rrëfimesh mbi fjalët dhe veprat e Profetit, por jo mbi mënyrën se si e fitonte ai energjinë e duhur shpirtërore për t'i kryer ato. Është fjala për ato qëndrime dhe veprime të vështira për t'u përqafuar nga njeriu, pasi bien ndesh me logjikën afatshkurtër të interesit, egon, pasionin dhe prirjen për të qenë i padrejtë.

Si e fitonte Profeti forcën për të qenë i drejtë me të gjithë, për të toleruar sjelljen torturuese të fqinj të tij hebre, për të qenë i dhembshur ndaj armikut dhe për të mos rënë pre e pasionit për përfitim personal?

Ligjërimi fetar bashkëkohor na thotë se ai ishte Profet dhe se nuk kishte asnjë sekret në përmbajtjen e tij nga ligësia e padrejtësia si dhe në ngulmimin e tij për të mbrojtur të vërtetën dhe mirësinë: ai thjesht vepronte ashtu si urdhërohej. Mirëpo, secili prej këtyre dy pretendimeve përjashton dy të vërteta shumë të rëndësishme: (1) që Zoti e kishte dërguar Profetin si shembull njerëzor që të ishte i mundshëm për t'u ndjekur dhe arritur dhe (2) që Profeti kishte në themel të mënyrës së tij të të jetuarit një disiplinë shpirtërore, një metodë të mësuar nga Zoti dhe të realizuar me përpjekje të palodhshme nga ai. Nëse Profeti nuk do të kishte asnjë meritë në plotninë e shembullit të tij (*insan el-kamil*), pra nëse niveli i tij nuk do të arrihej përmes përpjekjes njerëzore, por të ishte thjesht një pritës pasiv i dhuratës hyjnore, ç'dallim do të kishte ai nga një engjëll dhe si mund të shërbente ai si model i jetës për çdo mysliman?

Veprat dhe fjalët që na rrëfohen përmes veprave të hadithit dhe ligjërimin fetar bashkëkohor, janë rezultate të natyrshme të përpjekjes së pandalur të Profetit për të fituar forcën e nevojshme për t'i vënë në jetë ato. Në qoftë se Profeti nuk kishte një udhëzim të hollësishëm për mënyrën e organizimit të ushtrisë në betejën e Bedrit, e cila është përcaktuese e fatit të Islamit në shoqërinë njerëzore, por i duhej të mendonte dhe të gjykonte se çfarë të bënte, atëherë çfarë mund të themi për durimin e tij ndaj një beduini që desh i mori frymën duke i kërkuar pasuri? A mos ishte i shtrënguar ai vetëm nga disa urdhëresa dhe kërcënime dhe nuk kishte asnjë burim tjetër energjie që ta mbushte me durim për të përmbajtur veten brenda profilit të të Dërguarit në çfarëdolloj gjendjeje? Si arrinte Profeti të përmbahej nga mëkati? Si arrinte t'i vinte të tjerët mbi veten? Të braktiste kënaqësitë dhe të zgjidhte sakrificën? Përgjigjja duhet kërkuar në metodën e tij shpirtërore. Ligjërimi modern fetar mjaftohet me rrëfimin e rezultateve të kësaj metode, në krijimin e një figure të admirueshme dhe të dashur për Profetin, por kontribuon po aq edhe në krijimin e një largësie torturuese ndërmjet tij dhe be-

simtarit modern. Arsyeya? Ai mohon metodën shpirtërore të Profetit ose e redukton atë në një grumbull aktesh të paorganizuara.

II. Rruga shpirtërore (tesawuf)

Historiani Ibn Khaldūn, duke iu referuar traditës shpirtërore të Islamit, shënon në *Mukaddime*-në e tij:

“Kjo dije është degë e shkencave të Ligjit të Shenjtë, që lindi në mesin e bashkësisë botërore islame (*ummeh*). Edhe në krye të herës, udha e njerëzve të këtille ishte konsideruar rruga e të vërtetës dhe udhëzimit nga komuniteti i hershëm i myslimanëve dhe fisnikëria e tyre, Shokët e Profetit (Allahu i faltë bekime dhe paqe), ata që qenë mësuar prej tyre dhe brezat pas tyre.

Në parim, ai konsiston në përkushtimin në adhurim, përkushtimin e tërësishëm ndaj Allahut, Më të Lartit, mos-përfillje ndaj stolive dhe bukurisë së botës, vetëpërmbytje nga kënaqësia, pasuria dhe prestigji i vërejtur në shumicën e njerëzve, dhe veçimi prej të tjerëve për të adhuruar në vetmi. Ky ishte rregulli i përgjithshëm në mesin e Shokëve të Profetit (Allahu i faltë bekime dhe paqe) dhe myslimanët e hershëm, por atëherë kur përfshirja në gjërat e kësobotshme u përhap gjerësisht që prej shekullit të dytë islam dhe njerëzit u krodhën në materializëm, ata që i kushtoheshin adhurimit nisën të quheshin *Sūfije* ose *Njerëz të Tesawuf-it* (Ibn Khaldun, *el-Mukaddime* [N.d. Ribotim. Mekë: Dār el-Bāz, 1397/1978], 467).”

Rruga shpirtërore e Islamit, pra, është tradita profetike e udhëtimit për të takuar Zotin. Profeti është udhëtari *par excellence*, për të cilin është e sigurt se e ka takuar të Shumëlartit. Shoqëruesve (*sahābeh*) të tij në këtë udhëtim, ai u mësoi si të shkojnë deri në takimin e Zotit të Fortdashur dhe si t’i udhërrëfejnë të tjerët për të arritur deri në këtë takim. Jeta e Profetit dhe shoqëruesve të tij përshkohej nga një bosht shpirtëror, që tërhiqte pothuaj të gjithë angazhimin e tyre në këtë botë. Përkushtimi në adhurim, shpërfillja e stolive dhe bukurisë së botës, vetëpërmbytja nga kënaqësia dhe prestigji dhe veçimi për të adhuruar në vetmi, janë gurë kilometrikë në udhëtimin shpirtëror të tyre. Është kjo arsyeja pse ata nuk ndesheshin me dallimin torturues ndërmjet asaj që duhej dhe asaj që ishin: sepse ata kishin një udhërrëfyes dhe një model të gjallë të atij që kishte arritur të takonte Zotin.

Sigurisht që çdo vepër, fjalë apo qëndrim i drejtë është një ushqyes i shpirtit me energji dhe është pjesë e udhëtimit shpirtëror të Islamit. Respektimi i rregullave të jashtme (*fiqh*) dhe moscënimi i kufijve të Zotit (*hudūd All-llāh*), përbën një minimum të padiskutueshëm në këtë rrafsh. Shumë grupe mistikësh bashkëkohorë i konsiderojnë urdhëresat dhe ndalesat grup rregullash të zbritura për masën e gjerë dhe përjashtojnë veten nga detyrimi për t’i respektuar ato. Ata janë shndërruar në argument të sulmit modern ndaj atij që quhet ezoterizëm apo misticizëm islam. S’do mend se ata nuk ndjekin rrugën e Profetit, i cili ishte zbatuesi dhe respektuesi model i këtij kuadri rregullator. Por, ndërsa ky kuadër përbën shtratin e duhur për nisjen e udhëtimit shpirtëror, ai nuk është vetë udhëtimi. Përkushtimi në adhurim, shpërfillja e stolive dhe bukurisë së botës, vetëpërmbytja nga kënaqësia dhe prestigji dhe veçimi për të adhuruar në vetmi, janë kategoritë kryesore të shkallëve që duhet të ngjysë udhëtari shpirtëror (*salik*).

Ashtu siç dëshmon hadithi kudsij, me kredhjen në adhu-

rim të vazhdueshëm dhe të vullnetshëm, udhëtari i afrohet Zotit aq sa arrin dashurinë e Tij. Që aty, ai fiton cilësi të reja: depërtim në thelbin e gjërave, pavarësi nga kjo botë, neveri për mëkatin, forcë për të kundërshtuar të keqen me gjithë dëshirën e tij dhe mbrojtje nga çdo përpjekje për ta tunduar apo frikësuar. Nëse në terminologjinë islame do të përshtatej termi niçean i mbinjeriut, atëherë ky njeri meriton të quhet kësisoj. Në fakt, në shkencat tradicionale islame, ai quhet *welij*, fjalë për fjalë, i dashur, i afërm i Zotit.

Sekreti është të takosh Zotin. Pranë Tij shkohet duke udhëtuar dhe udhëtimi ka rregullat e tij. Sekreti i këtij sekreti është të mësuarit dhe të ndjekurit e këtyre rregullave dhe shkallëve të udhëtimit. Përmes realizimit të udhëtimit deri në takimin me Zotin, besimtari jo vetëm përmbush kryeveprën e jetës së tij, por edhe fiton lirinë nga brenja që shkakton distanca ndërmjet asaj që duhet të jetë dhe të bëjë dhe asaj që ai është dhe bën. Tradita e Profetit përfaqëson udhëtimin dhe udhërrëfimin *par excellence* deri në takimin me Zotin.

III. Tradita (sunneh) si bashkudhëtim

Sa herë që më sipër është përmendur trashëgimia profetike në literaturën dhe ligjërimin bashkëkohor, është mbajtur parasysh ai grup rregullash morale, porosish për veprime dhe qëndrime, si dhe cilësish e gjendjesh të kërkuara nga besimtari, me qëllim që ai të meritojë të quhet i tillë. Ashtu siç është theksuar, këtij ligjërimi i mungon të kuptuarit e atij procesi ushqyes të shpirtit që besimtari të ketë sukses në realizimin e cilësive dhe gjendjeve të kërkuara prej tij. Cilat janë disa prej këtyre cilësive dhe gjendjeve, atëherë?

Përmbytja nga irritimi, sjellja e fisme me njerëzit pavarësisht sjelljes së tyre ndaj nesh, pranimi i sprovës në fatkeqësi dhe nënshtrimi ndaj vendimit të Zotit, pavarësia nga pushteti, pasuria dhe prestigji, heqja dorë nga pretendimi për madhështi, mëshirimi i të tjerëve, dhënia përparësi të tjerëve ndaj nesh, druajtja vetëm nga Zoti, trimërimi përpara armikut dhe varfërisë, dashuria për Zotin dhe Profetin, sinqeriteti në kryerjen e veprave dhe në të folur, dashuria për bamirësinë dhe ndihmimin e njerëzve, dashuria dhe përkujdesja ndaj krijesave të Zotit, zhveshja nga zilia, smira dhe urrejtja, syfaqësia dhe hipokrizia, të mospasurit frikë nga vdekja, përjetimi i pranisë hyjnore në namaz, përmbytja e gjymtyrëve nga kryerja e mëkateve si shikimi i së ndaluarës, dëgjimi i ligësive, përgojimi, shpifja dhe gënjeshtria, mospërfshirja në polemika etj., janë vetëm një pjesë e vogël e këtyre gjendjeve dhe cilësive. Si arrin njeriu të mundë veten dhe të përsosë këto cilësi e të përjetojë këto gjendje?

Tradita profetike duhet riparë si një udhëtim tek Zoti dhe si bashkudhëtim i Profetit me shoqëruesit e tij (*sahābeh*) në të njëjtën përvojë. Ligjërimet dhe edukimet islam bashkëkohor u duhet dhënë kuptimi i domosdoshëm i këtij udhëtimit. Përgjatë katërmbëdhjetë shekujve, kjo traditë është ruajtur përmes modelit të udhëtarëve shpirtërorë në rendet dhe shkollat e tyre. Nga gjiri i këtyre rrendeve dhe shkollave kanë dalë dijetarët dhe ripërtëritësit kryesorë të Islamit. Nëse ka një mundësi për rikthimin e *umme*-tit në shembullin e Profetit dhe shokëve të tij dhe për ruajtjen e trashëgimisë më të rëndësishme të Islamit, kjo mundësi gjendet në rigjallërimin e kultivimit shpirtëror në epokën moderne.



*Përgjegjësia e njeriut
është të shkojë një jetë harmonike
dhe të ekuilibruar me rrethin e tij,
duke nisur nga vetvetja.
Përgjegjësi është të sillesh
me drejtësi ndaj banorëve të tokës,
të trajtosh çdo krijesë,
si të gjallë edhe ato jo të gjalla,
si një ajet të shpallur prej Zotit.*

Nihat Jyzyn

PËRGJEGJËSIA

Njerëzit janë të prirur të mbajnë qëndrim armiqësor, atëherë kur u kujton përgjegjësitë që kanë. Ashtu si gjithë popujt që mbanin qëndrim armiqësor ndaj gjithë profetëve të Zotit. Njerëzit bëheshin si të çmendur kur personat e dalluar dhe të përzgjedhur, për të cilët deri dje ushqenin dashuri dhe besim të madh, sot u shfaqeshin me misionin e të dërguarit të Zotit. U prishej terezia kur profetët u kujtonin atyre fjalën që i kishin dhënë Allahut. Pretekstet që jepnin për mosaprovimin e profetëve, qenë pothuajse të njëjta tek të gjithë popujt: **“Mos na e prishni rehatinë që kishim deri tani, mos i mësoni fshatit të moçëm gjëra të reja, kështu na kanë mësuar të parët dhe baballarët tanë!”** Me këto fjalë ata refuzonin shpëtimtarët e tyre. Profetët ua vunë veshin hallevë të njerëzve, por njerëzit nuk ua vunë veshin këshillave dhe udhëzimeve të profetëve, sepse ata e kishin shndërruar në fe jetën e ulët dhe pa kufij, privuar nga themelet e së vërtetës dhe të së drejtës. Sistemi i tyre i besimit nuk njihte asnjë kufi. Feja e vërtetë është një përmbledhje kufizimesh të nevojshme për jetën e mbarë, duke u ngarkuar njerëzve përgjegjësi të vërteta mbi supe. Këtu e kishte burimin edhe kundërshtimi që ata u bënin profetëve, sepse dëshironin një jetë pa kufi dhe pa përgjegjësi.

Nuk ka dyshim se njeriu është i prirur drejt jetës pa kufi, ku gjendet nefsi i tij, pra në nivelin më të ulët, që është nefsi emare. Kur njeriu rëmbehet brenda vorbullës së

nefsit urdhërues, atëherë dëshiron të kalojë kufijtë, të hazdiset dhe të mos i vërë frerë vetes. Lëre pastaj kur ka në dorë pushtetin. Atëherë ai nuk njuh kufi për veten e tij. Allahu, Ai që ka krijuar njeriun dhe njuh natyrën e tij, na bën të ditur se Ai do të ndërhyjë në këtë situatë, kur urdhëron dhe thotë: **“A pandeh njeriu se e kemi lënë të shkojë nga të dojë.”** (Kiamet, 36.) Ai sikur dëshiron të thotë me këto fjalë “Ne nuk ia kemi dhënë nefsin njeriut që të hazdiset dhe të bëjë zullum.”

Si rezultat i një urtësie të caktuar, në natyrën e çdo njeriu gjendet shtypa e hazdisjes dhe dhunimit. Ajo ekziston tek njeriu, por Allahu, jo vetëm që i ka dhënë njeriut masat dhe pajisjen e domosdoshme dhe të mjaftueshme për ta edukuar këtë shtypë, por edhe i ka treguar rrugën dhe metodën që duhet të ndjekë për ta edukuar nefsin e tij agresiv. Vetëm se, kur njeriu e harron fjalën që i ka dhënë Allahut, pra edukatorit më të mirë për të, atëherë do të rrokulliset poshtë në nivelin më të ulët, nivelin shtazarak, ku do të mbetet aty deri sa të kujtohet për fjalën e dhënë. **“Betohem se njerëzit janë në humbje të vërtetë.”** (Asr, 1)

Ata që ia kanë frikën më shumë Allahut, janë në mënyrë të pandërprerë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që kanë. Vetë fjala takva (devocion), që në arabisht ka si kuptim të parë “përkujdesjen për qëndrimin larg nga gabimet”, në të vërtetë tregon këtë gjë. Ata që arrijnë ta ndiejnë

në palcë përgjegjësini që kanë, janë persona që ia japin hakun që i takon Allahut, duke përbushur adhurimet ndaj Tij. Ashtu siç u pa në rastin e profetit Muhamed, mëshirës së botëve. Vetëdija rreth përgjegjësisi i pati falur atij një ndjeshmëri të atillë, aq sa e pati devijuar itinerarin e ushtrisë myslimane kur pati parë se rrugës qëndronte një qen femër tek ushqente me qumësht këlyshët e saj të sapolindur, duke pasur frikë se ushtarët mund ta shqetësonin apo edhe t'ia dëmtonin këlyshët. Madje, pati caktuar një ushtar me detyrë që të qëndronte pranë qenit femër me këlyshë, në mënyrë që të garantohej se mos njëri nga ushtarët do ta thyente urdhrin e tij.

Si rezultat i përgjegjësisi ndaj respektit dhe të drejtave të njeriut, ai qe ngritur në këmbë kur pranë tij pati kaluar xhenazja e një jomyslimani dhe, kur njëri nga shokët e tij i pati kujtuar se kufoma nuk ishte e një myslimani, ai i qe përgjigjur: "A nuk është edhe ai njeri?!" Kjo vetëdije përgjegjësie e pati shndërruar profetin në atë gjendje, saqë edhe në momentet e fundit të jetës, i pati thënë së bijës që i rrinte mbi kokë dhe derdhte lot: **"Mos qaj bija ime! Pas këtij momenti yt atë nuk do të vuajë më në këtë jetë."** E vërteta është se kjo ndjeshmëri nuk i jep të drejtën e rehatisë njeriut, por e shndërron atë në person të kujdesshëm gjatë gjithë jetës së tij.

Ebu Ubejde b. Xherrah, të cilin i dërguari i Allahut e pati cilësuar si "besnikun e ymetit", i pati thënë kalifit Umer se devocioni (takva), pra vetëdija rreth përgjegjësisi ngjan me kalimin e një toke të mbushur me ferra. Një truall që të kushtëzon të tregohesh i kujdesshëm për çdo hap që hedh. Njeriu pati nënshkruar një marrëveshje me kushte të rënda për, kur pati pranuar amanetin e vahjit, të cilin nuk e patën pranuar as malet, detyrën e mëkëmbësisë së Zotit në tokë. Njeriu është i ndërgjegjshëm, në sajë të intelektit dhe të shpirtit të tij për fitretin (formatin hyjnor) që Zoti i ka dhënë. Po t'u shtohen këtyre të dyjave edhe vahji dhe të dërguarit e Zotit, ai nuk mund të gjejë arsye që të shpëtojë nga përgjegjësia që ka. Përgjegjësia e tij është të shkojë një jetë harmonike dhe të ekuilibruar me rrethin e tij, duke nisur nga vetvetja. Përgjegjësi është të sillesh me drejtësi ndaj banorëve të tokës, të trajtosh çdo krijesë, si të gjallë edhe ato jo të gjalla, si një ajet të shpallur prej Zotit, të shohësh nga këndvështrimi i Krijuesit, me pak fjalë të jetosh në përputhje me **fitret**-in, që është edhe formati hyjnor. E kundërta e kësaj situatë është zullumi, sepse zullum do të thotë ta përdorësh diçka jashtë natyrës së tij apo ta largosh atë nga vendi që i takon.

Në shtëpinë e njërit prej miqve të Zotit kishte shumë minj, prandaj njëri prej myridëve i solli në shtëpi një mace shumë të mirë për t'i kapur ata. Personi evlija ia ktheu pas macen, duke u treguar shumë i ndjeshëm në lidhje me shqetësimin që i shprehu atij, kur i tha: **"Merre me vete prapë macen, se nga frika e saj minjtë kanë për të ikur nga shtëpia ime dhe kanë për t'u përhapur nëpër**

shtëpitë e fqinjëve." Kjo është e gjitha. Ja pra profili i një besimtari dhe i një myslimani që e përjeton përgjegjësini e tij deri thellë në palcë. Këto nuk janë përralla. Kjo nuk është utopi. Ky ka qenë një njeri si gjithë të tjerët, i cili e ka ndërtuar moralin e tij në tezgjahun e mësimave të Kuranit dhe sunetit të Profetit, i cili ia kujtonte vazhdimisht vetes së tij përgjegjësitë që kishte dhe tregohej përherë i ndjeshëm në këto çështje. Vallë, në cilën shkallë e përjetojnë zemrat tona këtë vetëdije përgjegjësie? Në cilën masë manifestohet kjo ndjeshmëri në vatrën tonë, në banesat tona, në rrugët tona, në vendet tona të punës, në tregtinë tonë? Cilat janë arsyet, në rast se masa e saj është e ulët? Përse nuk arrijnë të ringjallen ashtu siç e meritojnë pasuesit e kësaj feje, që është përherë e gjallë, e freskët dhe e përsosur? Në qoftë se ne jemi të gjallë, përse nuk i ngjallim të tjerët? Nuk duhet harruar se profetët i ftonin njerëzit drejt jetës, pra kërkonin prej tyre që të ishin të gjallë në jetë. Allahu e përkufizon Kuranin si **"burim shërimi për zemrat e vdekura dhe të sëmura."**

Nuk duhet harruar se popujt e humbur kanë qenë në fillimet e tyre në rrugën e tevhidit, por me kalimin e kohës ata e patën deformuar besimin e drejtë, duke shtuar gjëra të paqena në besimin e tyre. Këto deformime të kryera si mungesë e përgjegjësisi ndaj fesë, e bënë të domosdoshme ardhjen e një profeti dhe një sheriati të ri. Meqë pas shpalljes së kësaj feje nuk do të ndodhë asnjë ndryshim apo deformim në akiden e vërtetë, atëherë nuk do të ketë më nevojë për ardhjen e një profeti apo sheriati tjetër deri në ditën e kiametit. Nuk duhet harruar edhe fakti se armiqësia e shejtanit ka për të vazhduar deri në ditën e kiametit gjithashtu. Ky armik i përbetuar i njeriut, i cili ka merituar mallkimin hyjnor në përjetësi, e di shumë mirë se si ta nxjerrë njeriun nga rruga e drejtë. Shejtani, i cili e di shumë mirë se ku të çon kalimi i kufirit si rezultat i harrimit të përgjegjësisi personale, nuk ka dyshim se ka për t'iu qasur njeriut nga ky drejtim. Ai e di shumë mirë se e rëndësishme është vetëm të hidhet ky hap, pasi fundi negativ është i pashmangshëm ashtu siç shpërbëhet çorapi që ka humbur fillin. Rruga e vetme e shpëtimit nga kurthet e shejtanit, është mbajtja gjallë në mënyrë të vazhdueshme e kujtimit të fjalës së dhënë Allahut, pra gjendja e dhikrit. Poeti Sezai Karakoç ka një fjalë kuptimplote. **"Jetoje aq bukur fenë islame, saqë ata që do të vijnë të të vrasin, të ringjallen tek ti."** Ashtu është! I gjalli ta ringjall zemrën. Të gjallë janë ata që i qëndrojnë besnikë fjalës së dhënë Allahut, ai që e mban të gjallë përgjegjësini, besimtarët besnikë dhe të devotshëm. Nuk duhet harruar se të përmirësuarit janë ata që pranojnë mbi supe përgjegjësitë, ndërsa njerëzit e prishur moralisht janë ata që harrojnë përgjegjësitë që kanë. Allahu na bëftë nga robërit e Tij, që e kanë të gjallë në çdo çast vetëdijen e tyre për përgjegjësini që kanë. Amin.

Xhafer Durmush



E vërteta Hyjnor *e paralajmërimit*

Inzar do të thotë: "Paralajmërim i atyre që nuk i zbatojnë urdhrat hyjnorë, duke ua bërë të qartë se i pret një e ardhme e hidhur." Sjelljet e njeriut kanë nevojë të rregullohen me frikësim ose inkurajim. Shpjegimet më të qarta dhe shembujt më të kuptueshëm, që i përgjigjen nevojës së paralajmërimit, janë fjalët e Allahut të Madhëruar.

"Ky (Kuran) është shpallje e qartë për njerëzit, me qëllim që ata të marrin paralajmërim nëpërmjet tij, që ta dinë se Allahu është Një Zot i vetëm dhe që të këshillohen njerëzit e mençur!"

Në ajetin e mësipërm, Allahu Teala shprehet se ky Libër i Lartë, është një "deklaratë paralajmëruese". Në Kuranin Fisnik thuhet se pejgamberët, (prej jetës së të cilëve jepen shembuj), janë "paralajmërues dhe përgëzues". Në ajetin fisnik, në të cilin njoftohet profetësia e të Dërguarit të Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, së pari përmendet cilësia përgëzues.

I Dërguari i Allahut, (sallallahu alejhi ve sellem), e përkufizon veten duke e përngjasuar me një njeri që njofton popullin e tij se po vjen një ushtri armike dhe i paralajmëron për rrezikun që po afrohet.

Megjithëse paralajmërimi është detyrë e profetëve, në Kuranin Fisnik emri "mundhir" është njëri prej emrave të Allahut Teala. Kjo tregon se Allahu Teala është në dijeni për çdo gjë që bëjmë dhe se ka krijuar çdo lloj mundësie për të na shpënë në rrugë të drejtë.

Feja jonë sublime, gjithmonë kërkon nga ne që në çdo fushë të drejtohem nga gjërat e mira dhe të dobishme. Po ashtu, kërkon që të jetojmë brenda kornizave

të urdhrave hyjnorë duke u larguar nga çdo gjë e keqe dhe e shëmtuar. Për këtë arsye, siç shprehet qartë se askush nuk mund të imponohet në çështjen e pranimit të Islamit, po ashtu, bëhet fjalë edhe për orientimin e sjelljeve në drejtimin e duhur dhe për paralajmërimin e besimtarëve me mënyra të ndryshme pasi kanë hyrë në fenë Islame.

Nisur nga kjo, mund të themi se inzari (paralajmërimi hyjnor) është metodë efikase që mund të përdoret për ta tërhequr njeriun drejt sjelljeve të përshtatshme ndaj synimeve të fesë së tij duke ngjallur frikë te ai dhe për të hequr disa pengesa psikologjike.

Në ajetin fisnik, thuhet: ***"Ne i frikësojmë ata (në mënyra të ndryshme)."*** Krahas kësaj, shprehet se paralajmërimi hyjnor, për të cilin po flasim, nuk ka dhënë ndonjë ndikim për mirë te mohuesit, por përkundrazi, ua ka shtuar atyre humbjen. Nga kjo, kuptohet se ndikimi i paralajmërimit hyjnor, vërehet më shumë te njerëzit besimtarë. Një paralajmërim, baza e të cilit mbështetet në besim, e forcon dëshirën e njeriut për t'i zhvilluar sjelljet e tij në anën e mirë.

Për këtë arsye, besimtarët janë grupi që së pari synohen në qindra ajete në të cilat kalojnë foljet "hauf", "inzar" dhe "ittika", në historitë që tregojnë për humbjet që kanë pësuar popujt të cilët nuk ia kanë vënë veshin paralajmërimeve hyjnore. Në këtë mënyrë, Allahu i Madhëruar ka urdhëruar që ata të mos mposhten ndaj vetes dhe shejtanit të mallkuar, sepse shejtani bën dredhi të ndryshme e ngre kurthe, duke ndryshuar gjithmonë petk dhe përpiqet ta vjedhë besimin, duke

penguar nga rruga e drejtë.

Nëse nuk mund ta bëjë këtë, përpiqet ta zbrazë brendësinë e punëve të mira dhe t'i largojë besimtarët nga sinqeriteti. Faktikisht, kjo është natyra e tij. Ndërsa natyra e vetes është dembelizmi. Nisur nga kjo, ajo duhet të paralajmërohet shpeshherë për shkak të këtij dembelizmi që ka në strukturën e saj.

Allahu i Madhëruar e urdhëron kështu të Dërguarin e Tij të dashur, sallallahu alejhi ve sellem: **“Këshilloji me Kuran ata që frikësohen nga kërcënimi Im!”** Ky ajet duhet të ketë një kuptim të veçantë në syrin e besimtarëve që ndjejnë se lëviz diçka nga brendësia e tyre kur lexohet Kuran...

Edhe njëra prej çështjeve që na bën të falënderojmë sa herë që lexojmë fjalën hyjnore, është kjo: Allahu Teala na paralajmëron me këtë dhe qindra ajete të tjera fisnike. Nganjëherë na fton për t'u zgjuar, duke na përkujtuar momentet e tmerrshme të ditës së takimit, nganjëherë duke folur për ndëshkimin përvëlues që do të rrethojë jobesimtarët dhe nganjëherë duke na treguar historitë mësimdhënëse të popujve të kaluar...

Ja, në këtë çështje, një dimension i ndryshëm i paralajmërimit hyjnor, na tërheq vëmendjen: Në Kuranin Fisnik njoftohet se edhe shejtani i frikëson miqtë e tij dhe në fjalinë e fundit të ajetit në fjalë, thuhet:

“Nëse keni besuar, mos kini frikë prej atyre, por frikësohuni vetëm prej Meje.”

I lartësuar është Allahu! Paralajmërimet e Allahut të Madhëruar, nuk janë paralajmërimet të thata e të mbështetura në dyshime si frikësimet e shejtanit të mallkuar. Allahu i paralajmëron robërit e tij për rreziqet që do të ndodhin. Po ashtu, i urdhëron që të largohen nga sjelljet e shëmtuara. Në këtë mënyrë, frikësimi i Tij kthehet vetëm në mëshirë...

Nisur nga aspekti i këtyre shpjegimeve, njerëzit nuk duhet të pandehin se Islami është fe e frikës. Përkundrazi, Islami është një strukturë e përkryer që përmbledh të gjitha specifikat e zhvillimit të një personaliteti psikologjik, ekuilibruet dhe të shëndoshë që dëshiron të nxjerrë në pah. Në këtë mënyrë, Islami i jep përparësi përfitimit sipas nevojës nga motivet që e vendosin në lëvizje dashurinë dhe frikën në edukim.

Nëse dëshirojmë të bëjmë një jetë sipas Islamit, ku frika dhe shpresa janë në masat ideale dhe nëse dë-

shirojmë që në jetën e amshueshme të arrijmë ato që shpresojmë, atëherë duhet të qëndrojmë larg gjërave të këqija prej të cilave paralajmërohem.

LEXO / MENDO

Së pari, pastrimi shpirtëror

Në ajetin fisnik, thuhet:

“Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën! Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë. Ndërsa, kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.”

Kur e lexojmë këtë ajet fisnik, mendoj se gjithmonë duhet ta kemi parasysh pastrimin shpirtëror...

E di se sëmundjet që i ngjiten trupit, më së shumti e privojnë njeriun nga disa mirësi. Ndërsa sëmundjet që i ngjiten zemrës, bëhen shkak për humbjen e përherëshme, nëse nuk bëhet ndërhyrje në kohën e duhur...

Njerëzit e urtë kanë thënë: “Sëmundjet që zënë shpirtin janë shtatë llojesh. Ato korrespondojnë me shtatë dyert e xhehenemit. Për këtë arsye, përdërisa njeriu të mos i shkulë nga shpirti këto shtatë sëmundje dhe t'i hedhë, dyert e xhehenemit nuk konsiderohen të mbyllura për të.”

Sëmundjet për të cilat po flasim, i kanë radhitur kështu: “Pëlqimi i vetes, shtirja, mendjemadhësia, zemërimi, smira, dashuria ndaj pasurisë dhe dashuria ndaj pozitës.”

Për t'u hapur vend në zemër cilësive të bukura që janë të pëlqyeshme te Allahu Teala, së pari duhet të shkulet nga aty cilësitë e këqija dhe të padëshirueshme. Për të realizuar pastrimin shpirtëror, i cili do t'u japë sinqeritet dhe ndershmëri veprave tona, këto dy cilësi duhet t'i kemi primare në jetë.

Nëse synojmë të arrijmë suksesin në provimin e jetës, atëherë jemi të detyruar t'i planifikojmë punët dhe kohën e tyre në një mënyrë serioze. Siç thonë edhe të vjetrit: “Patjetër duhet të respektohet radha nga më e rëndësishmja te e rëndësishmja”...

Referencat:

1. Ibrahim, 52. 2. Nuh, 11/2. el-Hixhr, 15/89, etj. 3. el-Bakara, 119. el-Isra, 105. 4. Buhari, rikak, 26. 5. ed-Duhan, 3. 6. el-Bakara, 257. 7. el-Isra, 60. 8. Shik. T.D.V. Islam Ansiklopedisi, Inzar Maddesi, Hayati Hökelekli. 9. Kaf, 45. 10. ez-Zumer, 71; Ibrahim, 44, etj. 11. Ali Imran, 175. 12. esh-Shems, 7-10.

“Ky (Kuran) është shpallje e qartë për njerëzit, me qëllim që ata të marrin paralajmërim nëpërmjet tij, që ta dinë se Allahu është Një Zot i vetëm dhe që të këshillohen njerëzit e mençur!”



Abdurrahman Xhandan

AVENTURA e njeriut në tokë

Krijimi i njeriut në xhenet dhe dërgimi i tij në këtë botë, sipas sufive, është një mundësi për për t'u lartësuar drejt Allahut të Madhëruar, duke e plotësuar përsosmërinë e tij në këtë dynja. Imam Rabbani, duke u nisur nga të dhënat e Kuranit Fisnik dhe Sunetit, në letrën e tij të nëntëdhjetë e nëntë, shpjegon se përse shpirti i njeriut të nderuar ka rënë në këtë botë të shkretë dhe se si do të lartësohet përsëri drejt Allahut Teala. Sipas Imamit, shpirti i njeriut duhet të hyjë dhe të gjendet në trup në mënyrë që të arrijë përsosmërinë.

I nderuar! Rruga e lartësimit ishte e mbyllur për shpirtin e njeriut, para se të lidhej me trupin fizik. Shpirti i njeriut ishte i mbyllur në një burg, siç shprehet edhe në ajetin fisnik: **"Secili prej nesh, ka një pozitë të caktuar."** (es-Saffat, 164) Por natyrës së njeriut iu vendos xhevahiri (aftësia) për rilartësim me kushtin e zbritjes në tokë. Ja, nga ky aspekt, njerëzit janë më të lartë se engjëjt. Allahu, subhanehu ve teala, me mirësinë dhe bujarinë e Tij, e bashkoi atë xhevahir drite me trupin e errët. Allahu (xh. xh.), që bashkoi dritën e errësirës dhe botën shpirtërore me botën fizike, është i pastër nga çdo lloj mangësie. (Letra e 99)

Sipas Imamit, Allahu Teala së pari i dha shpirtit aftësinë për të ndjekur nefsin, madje, për t'u dashuruar me të, në mënyrë që të bashkoheshin këto dy pole të kundërta. Në këtë mënyrë, në fillim u formua një harmoni ndërmjet shpirtit dhe nefsit. Këtë gjendje e shpjegon ky ajet fisnik:

"Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer, pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët." (et-Tin, 4-5.) Imami mendon se në këtë ajet ka një lavdërim që i ngjan satirës. Domethënë, **"pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët."**, është një satirë, por në të njëjtën kohë është një mirësi hyjnore, për shkak se përfshin edhe rilartësimin e njeriut drejt Zotit (xh.sh.).

Në këtë letër, Imami shpjegon edhe emrat që veçanërisht nefsi i merr në grada të ndryshme. Sipas tij, për shkak se shpirti i është bindur nefsit dhe është bërë i përkohshëm në dashurinë e tij (nefsit), nuk meriton më të quhet shpirt, por nefsu'l-emmare. Imami e shpjegon kështu marrëdhënien shpirt-nefs:

Më vonë, shpirti iu drejtua vetes plotësisht, për shkak të kësaj lidhjeje dashurie. Ai e pasoi aq shumë nefsin, sa që në fund e harroi edhe veten e tij dhe u quajt nefsu'l-emmare. Shkaku i këtij pasimi ishte butësia e shpirtit, sepse shpirti hyn nën sundimin e çdo gjëje që i drejtohet, për shkak se është plotësisht i butë. Kur shpirti e harroi veten e tij, e harroi edhe mbikëqyrjen e Allahut Teala dhe qetësinë shpirtërore që të jep ajo. Ai humbi plotësisht në neglizhencë dhe pasoi sundimin e errësirës. Pastaj Allahu i Madhëruar, me mirësinë dhe butësinë e Tij, u dërgoi profetë robërve dhe me ndërmjetësimin e këtyre personave të lartë, e ftoi njerëzimin te vetja e Tij.

Robërit i urdhëroi që ta kundërshtonin nefsin, të cilin e duan shumë shpirtat. Atëherë, kush i kthehet Allahut

Teala nga kjo humbje (e shpirtit), ka arritur shpëtimin e madh. Ndërsa, kush dëshiron të zhytet (në baltën ku gjendet) duke mos e ngritur kokën, e ka humbur rrugën e tij me një devijim të madh. (Letra e 99.)

Imami e cilëson si neglizhencë të madhe faktin që shpirti ka ndjekur nefsin dhe u është bindur dëshirave të saj. Shpëtimi është në të kundërtën e kësaj gjendjeje, domethënë, duhet ta bëjmë veten që të pasojë shpirtin dhe të pranojë dëshirat e synimet e shpirtit. Kjo gjendje arrihet duke e prishur harmoninë që shpirti ka me nefsin dhe duke iu drejtuar Allahut të Madhëruar. Kur saliku (njeri i lidhur pas një tarikati) e arrin këtë gjendje, shpëton nga neglizhenca që shfaqet në gjumë dhe në gjendje të tjera:

Atëherë, kur të priset harmonia ndërmjet shpirtit e nefsit dhe shpirti të heqë dorë nga dashuria ndaj nefsit, t'i drejtohet dashurisë së Zotit të Madhëruar, të heqë dorë nga pasimi i vazhdueshëm i nefsit dhe të arrijë gjendjen e pasimit në mënyrë të vazhdueshme ndaj Allahut Teala, ja, atëherë, neglizhenca e nefsit nuk mund t'i bëhet pengesë qetësisë së shpirtit. Si mund të ndikojë neglizhenca te një njeri i tillë?! Sepse shpirti i tij ia ka kthyer kurrizin nefsit plotësisht dhe e ka hedhur prapa atë. (Letra e 99.)

Sipas Imamit, ai që e shpëton shpirtin e tij nga kurthi i nefsit dhe e bën atë pasues të urdhrave të Allahut Teala, siç shprehet në tarikatin Nakshibendi, ka arritur gradën "halvet der enxhymen". Prania e tij ndërmjet njerëzve, nuk arrin ta largojë atë nga Allahu i Madhëruar. Madje, edhe kur është i preokupuar me punët e kësaj bote, ai gjithmonë e ka zemrën të përkushtuar ndaj Allahut Teala.

Imam Rabbani e quan "sejri ilallah", domethënë, udhëtim për te Allahu Teala procesin që kalon saliku, deri sa të arrijë në këtë gjendje. Sufitë e quajnë uruxh (lartësim) procesin e edukimit shpirtëror. Ndërsa rikthimin në botën fizike të salikut që e ka arritur këtë gjendje, e quajnë "es-sejru anillahi billah", domethënë "kthim nga Allahu me Allahun". Sipas tij, këta robër që Allahu Teala i ka pranuar në audiencën e tij shpirtërore, i dërgon përsëri ndërmjet njerëzve që t'i ftojnë njerëzit për tek Allahu i Madhëruar. Këta njerëz të dashur të Allahut (xh.xh.), mbjellin te njerëzit dashurinë ndaj Allahut Teala.

Kur ata ndodhen ndërmjet njerëzve, përpiqen të përhapin vetëdijen e besimit në Zot. Këtë udhëtim drejt njerëzve, sufitë e quajnë nuzul, domethënë, zbritje. Sipas Imamit, saliku së pari duhet të plotësojë procesin e uruxhit, që të fitojë të drejtën e detyrës për t'i ftuar njerëzit te Allahu i Madhëruar, pastaj duhet të futet ndërmjet njerëzve me procesin e nuzulit:

Allahu, subhanehu ve teala, e zbret atë njeri që e ka arritur një gradë të tillë, me anë të rrugës es-sejru anillahi billah me sheriatin që ka dërguar, në mënyrë që t'i shpëtojë njerëzit nga errësirat vetjake.

Dashuria e këtij njeriu, i drejtohet plotësisht botës, pa formuar ndonjë lidhje shpirtërore me ato që ka brenda tij, sepse lidhja e tij është me burimin që ka ndërtuar më parë, domethënë me Allahun, subhanehu ve teala. Kështu që, rikthimi i tij ndërmjet njerëzve është bërë jashtë vullnetit të tij.

Sipas Imam Rabbanit, murshidët e tillë që vijnë ndërmjet njerëzve, në dukje janë me njerëzit dhe u ngjasojnë atyre formalisht. Xhynejdi Bagdadi shprehet: "Arritja në fund, është kthim në fillim". Por, në të vërtetë, ndërmjet salikëve muntehi (ata që e kanë plotësuar sejru sulukun) dhe njerëzve të tjerë, nuk ka ndonjë përngjasim, sepse ata që nuk e kanë plotësuar edukimin shpirtëror, i shohin njerëzit vetëm me syrin e nefsit dhe të gjitha lidhjet që kanë me ta, i formojnë në emër të nefseve të tyre. Në çdo gjë që bëjnë, së pari mendojnë interesat e tyre, ndërsa çështjet fetare i lënë në plan të

dytë apo mund t'i nënvlerësojnë edhe më shumë. Ndërsa muntehitë, çdo gjë e bëjnë për hir të Allahut Teala dhe nuk mendojnë as edhe për veten e tyre. Imami e shpjegon kështu këtë gjendje:

Në të njëjtën mënyrë, muntehiu u afrohet njerëzve me vullnetin e Zotit (xh.xh.). Ai nuk e dëshiron këtë lloj afrimi. Shkaku themelor që ai i afrohet botës fizike, është kënaqësia e Allahut të Madhëruar ndaj këtij afrimi. Ndërsa te fillestari ky drejtim buron nga nefsi dhe ai e dëshiron këtë. Në këtë gjendje, nuk ka kënaqësi të Allahut, subhanehu ve teala.

Imami vë në pah një ndryshim interesant që ka ndërmjet salikut që gjendet në shkallën fillestare dhe salikut që ka arritur fundin e kësaj gjendjeje. Sipas tij, saliku fillestar mund t'i lërë njerëzit nëse dëshiron dhe t'i kthehet Allahut Teala, ndërsa saliku që e ka përfunduar edukimin shpirtëror, nuk mund ta bëjë diçka të tillë, edhe nëse dëshiron, për shkak se është i obliguar me detyrën e thirrjes së njerëzve në Islam. Ai (saliku) është i detyruar ta vazhdojë thirrjen e njerëzve për te Allahu i Madhëruar, derisa të kalojë nga kjo botë e përkohshme në botën e përhershme. Siç nuk mund të heqin dorë peygamberët nga daveti (thirrja e njerëzve për në besim te Allahu Teala), edhe ata nuk mund të heqin dorë asnjëherë nga kjo thirrje e shenjtë.

Allahu i Lartësuar, me mirësinë dhe bujarinë e Tij, e përfundoftë aventurën tonë përsëri në xhenet, ashtu siç edhe ka filluar dhe na bëftë prej atyre që nuk e harrojnë qoftë edhe një çast qëllimin e ardhjes sonë në këtë botë të përkohshme!





TË THEMI ALLAH para se të themi obobo

Ali Riza Jemel

Ashtu si zjarri i fshehur në gurin e çakmakut, edhe në brumin e çdo njeriu gjendet aftësia për të besuar dhe për t'u bërë mysliman. Detyra e njeriut, është ta nxjerrë dhe ta zhvillojë këtë aftësi. Natyra e njeriut, është koduar që ai të besojë. Profeti ynë (a.s.), ka thënë: "Çdo i lindur (fëmijë), lind në natyrshmërinë islame." (Buhari, Tefsir, 30.) Ndërsa në Kuranin Kerim, ky fakt shprehet kështu:

"Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pardshtësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes, u tha: 'A nuk jam Unë Zoti juaj?' Ata u përgjigjën: 'Po, dëshmojmë se Ti je.' Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: 'Këtë nuk e kishim ditur.'" (el-A'raf, 172)

Megjithëse në lidhje me komentimin e ajetit ka mendime të ndryshme, sipas njërës prej këtyre mendimeve, marrëveshja e përmendur në këtë ajet, është figurative dhe nënkupton se gjatë zhvillimit organik të njeriut, Allahu Teala ka vendosur në natyrshmërinë e njeriut aftësinë e njohjes dhe besimit të ekzistencës dhe njëshmërisë së Vet. Nëse njeriu pyetet: "Kush është Zoti yt?", duhet të thotë, "Allahu", sepse ai është i pajisur mendërisht dhe psikologjikisht për të thënë ashtu. Përveç kësaj, Allahu i Madhëruar, në botën e jashtme dhe të brendshme, ka krijuar shumë prova dhe fakte që dëshmojnë për ekzistencën dhe njëshmërinë e Tij. Ndërkohë që detyra e profetëve, ka qenë orientimi dhe udhëzimi i njerëzve për të besuar dhe jetuar në përputhje me natyrshmërinë e tyre.

Natyrshmëria nuk gënjen. Besimi është një nevojë thelbësore si uria dhe etja. Ndërsa për mosbesimin absolut, as që mund të flitet. Ajo për të cilën mund të flasim, është degjenerimi i besimit dhe përzierja e teuhidit me shirkun.

Filozofët e vjetër grekë, nuk e mohonin ekzistencën e një krijuesi madhështor. Mirëpo, për shkak se nuk zotëronin një burim të pastër dhe të paprishur të shpalljes hyjnore, ata ishin zhytur në shirk. Ata i atribuon Allahut cilësi, të cilat nuk i kishin hije dhe e kthyen besimin në mitologji, duke shpikur figura zotash të kotë, si zoti i diellit, zoti i hënës, zoti i hekurit, zoti i dashurisë, zoti i verës etj. Për shkak të besimit se nuk ishte e mundur të lidheshin drejtpërdrejt me Krijuesin e Madhërisëm, ata me mendjen e tyre shpikën idhuj të cilët do t'ua siguronin këtë lidhje. Në Kuranin Kerim, gjejmë ajete të cilat e shprehin shumë bukur këtë fakt:

"Nëse ti (o Muhamed) i pyet ata (mekasit paganë) se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën, me siguri që do të thonë: 'Allahu...' (ez-Zumer, 38) 'Vetëm Allahut i takon adhurimi i vërtetë. Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë, përveç Tij, ata thonë: 'Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu!...' (ez-Zumer, 3)

Për arsye se besimi është pjesë e natyrshmërisë, Kurani Kerim, trajton më tepër çështjen e besimit të degjeneruar që është idhujtaria, se sa çështjen e mohimit absolut të Zotit. Më tepër flitet për njësimin e Allahut, se sa për ekzistencën e Tij. Aty vazhdimisht theksohet se Krijuesi i vërtetë është Allahu, se nuk ka nevojë për ndërmjetës, se Allahu është më afër njeriut se damari i qafës dhe se Ai dëgjon e shikon në çdo vend e kohë. Teuhidi është fakt, sepse në gjithësi, çdo gjë dëshmon për njëshmërinë e Allahut. Teuhidi është besimi i vërtetë, ndërsa shirkun është degjenerimi i besimit.

Për shkak se besimi është pjesë e natyrshmërisë njerëzore, Allahu Teala na këshillon të kthehemi në natyrshmëri

dhe të mos biem në kundërshtim me të:

“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit...” (er-Rum, 30)

Ekzistenca e jobesimtarëve gjatë historisë njerëzore dhe në ditët e sotme, nuk mund ta ndryshojë të vërtetën e natyrshmërisë. Ata që thonë se janë ateistë ose më mirë, ata që kujtojnë se janë të pafe, janë ata që nuk arrijnë të kuptojnë se tek ta ndodhet një besim i fshehur.

Ashtu siç është theksuar edhe në shumë ajete fisnike, ky besim del në pah në çastet më të vështira të jetës: **“Ai ua mundëson (njerëzve) udhëtimin nëpër tokë dhe det. E, kur gjenden në anije, që lundron me ta me erën e përshtatshme e ata i gëzohen kësaj, arrin një stuhë dhe i sulmojnë valët nga të gjitha anët e mendojnë se do t’i vënë poshtë, (atëherë) i luten Allahut sinqerisht, duke i premtuar besimin: ‘Nëse na shpëton nga kjo, me të vërtetë, do të jemi mirënjohës! E, kur Allahu i shpëton, ata përnjëherë, pa kurrfarë të drejte, bëjnë turbullira në Tokë. O njerëz! Vërtet, padrejtësia që bëni për t’u kënaqur në jetën e kësaj bote, vetëm ju dëmton...”** (Junus, 22-23)

Në përgjithësi, kur njerëzit gjenden në kamje dhe rehati, vrapojnë pas dëshirave dhe epsheve, duke harruar dhe neglizhuar detyrat që kanë ndaj Zotit të tyre. Madje, aq sa bëhen edhe skllëvër të dëshirave të tyre të përkohshme dhe më në fund, as dëgjojnë dhe as shohin. **“Mendo pak! Kush, përveç Allahut, mund ta udhëzojë atë njeri, që dëshirat e veta i ka bërë zot; atë njeri, të cilin Allahu, duke e njohur për të tillë, e ka shpënë në humbje, duke ia vulosur dëgjimin dhe zemrën e duke i vënë perde para syve të tij?!...”** (el-Xhathije, 23)

Siç u pa, besimi është origjinal (i vërtetë), ndërsa mohimi dhe shirku janë prishje dhe degjenerim i origjinales. Çdo njeri, në ekzistencën e vet, bart një shkëndijë besimi. Ashtu siç thamë edhe më sipër, ky besim është si zjarri i fshehur në gurin e çakmakut. E rëndësishme është që këtë ta zhvillojmë në rrugë normale dhe këtë besim ta kthejmë në një mënyrë jetese. Besimi, i cili nuk silltet në jetë dhe nuk mbështetet me punë, ngelet veç një shkëndijë brenda njeriut dhe nuk i bën dobi askujt.

Përderisa kemi mundësi ta zhvillojmë në mënyrë të natyrshme besimin që ekziston natyrshëm në përbërjen njerëzore, ta kthejmë atë në një mënyrë jetese të drejtë dhe të bukur duke e mbështetur në dashuri dhe ndjenja të thella shpirtërore, atëherë përse neglizhojmë dhe e kujtojmë Allahun vetëm atëherë kur biem në vështirësi? Kjo nuk është aspak logjike! Besimi i vërtetë, është besimi që mbështetet në zgjedhjen dhe vullnetin e lirë. Të gjithë vijnë në vijë kur ngelen të detyruar. Mirëpo, aty ky

bëhen gjërat me detyrim (me forcë), nuk mund të flasim për dashuri, respekt dhe sinqeritet. Nëse largohet detyrimi, largohet edhe bindja. **“Kur njerëzit i godet ndonjë e keqe, ata i luten Zotit të vet, duke iu kthyer me pendesë e pastaj, kur Ai u jep të shijojnë mëshirën e Tij, atëherë një pjesë e tyre i shoqërojnë Zotit të vet diçka tjetër (në adhurim).”** (er-Rum, 33)

Kjo sjellje është dyfytërsë. Nëse silllesh sikur nuk ka Allah, kur i ke punët në vijë dhe strehohesh tek Ai kur ngelesh ngushtë, atëherë kjo është mosmirënjohje. Njerëzit e tillë, Allahu nuk i sheh me mëshirë. Për të kërkuar diçka nga Allahu, duhet të kesh fytyrë t’i dalësh përpara. E njëjta gjë vlen edhe në marrëdhëniet ndërnjerëzore. Allahu është Mëshirues dhe Falës, por në të njëjtën kohë, është edhe Shedu’l Ikab (ka dënim të ashpër).

Në përgjithësi, për shkak se njerëzit janë shumë të shkujdesur dhe mashtruar me dynjanë, bukuritë dhe dëshirat e saj të përkohshme, u vjen mendja vetëm atëherë kur u afrohet vdekja. Në atë moment, japin fjalën se do të bëjnë një jetë të drejtë e të sinqertë dhe kërkojnë prej Allahut t’ua zgjasë jetën. Mirëpo, pendimi i fundit nuk bën dobi, sepse Allahu Teala u ka dhënë robërve të Vet një afat të caktuar jete dhe mundësi të ndryshme, me qëllim që të tregojnë devotshmërinë e tyre ndaj Allahut. Ata që e çojnë dëm këtë jetë dhe këto mundësi, në fund të jetës do të përballen me një pendesë që nuk do t’u bëjë dobi.

Shumë njerëz që e kanë kaluar jetën me kryeneqësi dhe mohim, janë ndarë nga kjo jetë me pendesë të thellë. E gjithë pasuria, fuqia dhe luksi i tyre përfundoi në zero. Për shkak se më parë nuk thanë Allah, ngelën të detyruar që në fund të thonë obobo. Madje edhe Faraoni, i cili më parë thoshte, “Unë jam zoti juaj më i madh”, në fund u dorëzua duke pranuar se ishte veç një rob i thjeshtë. Mirëpo, një besim i mbështetur në detyrim, vetvetiu nuk është i pranuar.

“...kur po mbytej, (Faraoni) tha: Besoj se s’ka zot tjetër përveç Atij që i besojnë bijtë e Izraelit; dhe unë jam ndër myslimanët. Vallë, tani (po beson), ndërkohë që më parë ishe i padëgjueshëm dhe ngatërrestar?!” (Junus, 90-91)

Të gjithë ata që kanë mendje të shëndoshë, duhet të dëgjojnë zërin e natyrshmërisë dhe të përpiqen të bëjnë një jetë të mbështetur në besim dhe vepra të sinqerta, sepse një besim i mbështetur në detyrim (forcë), nuk ka dobi. Atëherë, të gjithë së bashku të themi Allah me vullnet të lirë, pa qenë të detyruar që në fund të themi obobo. Allahu na bëftë prej atyre që e përmendin shumë emrin e Tij dhe që zemrat e tyre janë plot dashuri për Të.

Amin!





Krvengritja e trupit

Bilal Atis

Ora shënonte katër, kur ai mbylli kompjuterin dhe u shtri në shtrat. Pa kaluar shumë, mbylli sytë dhe e zuri gjumi. Nuk e kujtonte që kur ishte ulur në krye të asaj makinerie.

U dëgjua një psherëtimë që prishi gjithë heshtjen që ishte pllakosur pas fjetjes. Sikur dikush kishte një shqetësim të madh apo ankth. Thoshte:

“Mjaft tashmë, mjaft! Gjithnjë e njëjta vuajte, jo një ditë e as dy, por u bënë muaj të tërë. Nuk mësoj më, vetëm po luaj lojërat e kompjuterit. Nuk lexoj as edhe një libër e as që dëgjoj një emision në radio. Kam nevojë edhe unë të dal nganjëherë në rrugë, të frymoj pak oksigjen. S’kam më krijimtari, u bëra i çuditshëm duke menduar me orë të tëra planet e strategjive të lojërave. E kam harruar kënaqësinë që

merrja nga ajetet dhe hadithet. Ndjej mall për një vepër letrare. Sikur e ndjej mungesën e një tingulli të këndshëm. Pa mbaruar një lojë, nis tjetrën. Nuk po më përdor si duhet. Po ma harxhon kohën në punë të kota dhe qelizat po më vdesin kot.”

Pa kryer ankimin si duhet mendja, erdhi dikush tjetër. Kishte një natyrë të sflitur dhe të drobitur. Ia ndërpreu fjalën mendjes dhe tha: “Thuaj ç’të duash, prapë është shumë pak, shumë pak. Po unë ç’të bëj? Pa shiko, sapo u bë mëngjes dhe ra të flerë. U shkatërrova duke parë për orë të tëra ekranin. Nuk kam më fuqi të qëndroj! A të ruhëm nga rrezet që vijnë nga lojërat apo nga dëmi që vjen nga ekрани, s’di ç’të bëj! Ndërkaq edhe unë sikurse sytë e njerëzve të tjerë, do të dëshiroja të shikoja bukuritë natyrore, kaltërsinë e detit dhe të zhytesha në shijen e gjel-

bërimin të fushave e kodrave... Po ku? Rrimë zgjuar deri në mëngjes duke parë kompjuter..."

Ndërkohë, fjalën e syve e ndërpre në veshët:

"Keni të drejtë, shumë të drejtë! Edhe unë jam mërziur shumë. I vendos ato kufje dhe me zhurma të ndryshme dhe të pakuptimta po më shkatërron. Të paktën, sikur të ishte ndonjë gjë e këndshme, po edhe kështu nuk bën, ka një kufi edhe durimi... Nuk do të më besoni, më janë transformuar daullet. Kush mund t'i rezistojë kësaj zhurme?! U çmenda nga zhurma bezdisëse! Kam harruar zërin e dallgëve të detit, cicërimat e zogjve, zërin e erës..."

Sikur të mos mjaftohej nga zhurma e lojërave prej orësh të tëra, një herë në vit që del edhe në rrugë, i vendos në veshë ato gjërat e çuditshme, më çmendi me volumin e lartë!"

Ndërkohë, ndërhy në mushkëria, duke thënë: "Sa të drejtë që keni! Po më mbyty ky njeri! Pa shikoni, pa u bërë as tridhjetë vjeç, jam bërë e zezë katran. Me orë të tëra, kafe cigare, kafe cigare. Më besoni, lutem që të vdes më mirë e të shpëtoj nga kjo gjendje. Jam bërë më keq se një tub shporetit. Prej vitësh vetëm tym, tym, nikotinë. Janë shkatërruar tërësisht edhe venat e as që i bëhet vonë zotërisë!"

Në një gjendje të tillë të sflitur, mendja ndërhy në sërish: "Ju kuptoj. Të gjithë keni të drejtë. Sikur t'i pyesim edhe organet e tjera, po ashtu janë të shkatërruara. Para disa kohësh, stomaku po ankohej: "Nuk bëhet njeri ky! I gjen pikërisht ato gjëra që nuk vlejné e që janë dëmtuese dhe ushqehet me to. Plasa së bluari gjërat që ai ha. Ah, ku janë ato kohë që hante perime, kos, djathë, gjëra të lehta dhe që të japin fuqi...!"

Duhet të gjejmë një rrugëzgjidhje. Ejani, le t'i ankohe mi Krijuesit tonë. Vetëm Ai mund të na shpëtojë nga kjo dhunë. Ne jemi të detyruara të kryejmë detyrën tonë pa asnjë cen, s'mund të mos bindemi."

Fjalët e mendjes i mbështeti edhe zemra, duke thënë: "Keni të drejtë. Ndërkohë që unë duhet të isha e lidhur me Zotin nëpërmjet linjës shpirtërore, u ndota me njëmijë e një pislleqe nga e gjithë bota. U mbusha me ndjenja dhe mendime që nuk vlejné asgjë dhe që nuk kanë asnjë dobi. Kam humbur edhe manifestimin hyjnor. Kam shumë turp, shumë."

Nuk po u vinte fundi diskutimeve. Në këtë diskutim morën pjesë edhe organet e tjera, të cilat shprehën

indinjatën dhe shqetësimet e tyre. Si përfundim, mendja dhe zemra dhanë një vendim që i bënë të heshtnin të tjerët.

"Nuk kemi asgjë në dorë, derisa të vendosë Zoti që shpirti të largohet nga mesi ynë. Deri atëherë, ne do të vazhdojmë me durim punën tonë." Fjalën e mendjes, e plotësoi zemra: "Kur shpirti të ikë, atëherë do të qetësohemi ne, të paktën na mbaron puna. Kur të ringjalllemi, atëherë ia tregojmë shqetësimin tonë dhe do të kërkojmë drejtësi." Sapo heshti zemra, të gjitha organet e tjera njëzëri thërritën:

"Duam drejtësi,

Duam drejtësi,

Duam drejtësi!"

Njeriu u hodh i tmerruar nga shtrati. Ishte bërë i tëri në djersë. Pa orën, kishte vajtur tetë. Për një moment, mendoi se ishte e vërtetë. Falënderoi Zotin që ishte ëndërr. Atë mëngjes nuk e hapi kompjuterin, sikurse bënte çdo mëngjes. Shkoi në banjë dhe bëri një dush. Me ndjenja shumë të ndryshme veshi diçka dhe ashtu doli në rrugë. Kishte nevojë për ajër të pastër...

Disa nga urtësitë e Haxhit

Në Kuranin Famëlartë është një sure, e cila quhet sureja el- Haxh. Pra, kjo sure mban titullin e njërës prej obligimeve dhe shtyllave të Islamit që është haxhi. Asnjë nga shtyllat e tjera të Islamit, nama-zi, agjërimi dhe zekati nuk përmenden në Kuran si emër sureje. Përse kjo sure ka marrë emrin Haxh, megjithëse në të trajtohen edhe tema të tjera? Në fillim të sures flitet mbi Ditën e Kijametit, ndërsa më pas mbi ringjalljen dhe grumbullimin e njerëzve në mahsher. Veç kësaj, flitet mbi xihadin, mbi adhurimin dhe bindjen ndaj urdhrave të Allahut (xh.sh.). Çfarë lidhjeje kanë këto tema të ndryshme me njëra-tjetrën dhe me ritualin e Haxhit? Rituali i Haxhit luan një rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe formimin e umetit mysliman. Çdo mysliman që e kryen Haxhin me pasion dhe dashuri, ashtu siç e ka kryer edhe Pejgamberi (a.s.), do të bindet me zemër dhe me mendje se ky ibadet e formon myslimanin si individ në një mënyrë të çuditshme.

Haxhi të mëson dhe të trajnon mbi mënyrën se si do të mblidhen njerëzit në Ditën e Ringjalljes. Ditët që haxhinjtë lëvizin nga Arafati për në Muzdelife dhe pastaj në Mina, ku do të kryhet riti i gjuajtjes së shejtanit me gurë, e nxjerrin në pah më së shumti këtë trajnim të haxhiut. Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh vetëm njerëz që i luten Allahut me përkushtim dhe përgjërimit. Të gjithë kanë veshur rroba të bardha, temperatura është e lartë, njerëzit të djersitur, por të gjithë i luten Allahut t'ua falë dhe t'ua pranojë lutjet. Kjo situatë do të përjetohet dhe në Ditën e Ringjalljes në të cilën, sipas haditheve profetike, temperatura do të jetë shumë e lartë, sepse dielli do të ulet mbi kokat e njerëzve, do i mbulojë

djersa dhe të gjithë do të jenë duke u lutur me përgjërimit që Allahu t'ua falë gjynahet.

DISA NGA URTËSITË E HAXHIT:

1. Udhëtimi i njeriut drejt Mekës për të kryer haxhin na përkujton udhëtimin drejt Allahut në Ahiret. Gjatë këtij udhëtimi të haxhit, njeriu ndahet nga të dashurit dhe duhet të jetë i pajisur me para dhe furnizime që do t'i përdorë gjatë udhëtimit. Në të njëjtën mënyrë, ai duhet të bëjë vepra të mira për udhëtimin drejt ahiretit, pasi me nisjen e këtij udhëtimi ai ndahet prej të afërmeve dhe shkon në botën tjetër i ngarkuar me punët që ka bërë në këtë botë. Allahu (xh.sh.), thotë: **“Përgatituni me furnizim (për rrugë), por mos harroni se furnizimi më i mirë në këtë botë është devotshmëria”**. (Bekare, 197.)

2. Kur haxhiu vesh ihramin e bardhë, atij i kujtohet qefini me të cilin do të mbështillet kur të vdesë. Ihrami e fton atë të lërë dhe të braktisë gjynahet për t'u zhveshur prej tyre, ashtu sikurse heq rrobat e jetës së përditshme kur dëshiron të veshë ihramin e haxhit.

3. Kur njeriu thotë në Mikat (kufiri i fundit ku haxhiu duhet të veshë ihramin dhe bën nijetin e haxhit): **“Lebejke Allahumme Lebejke – Të përgjigjem o Allah, të përgjigjem”**, ai shprehet i gatshëm për t'iu përgjigjur Allahut, Zotit të tij.

Në qoftë se jep këtë përgjigje ndaj ftesës së Zotit për haxh, kjo nënkupton se nuk mendon më të kryejë gjynahe. Ai sikur thotë: **“Të përgjigjem o Zot që të mos kryej që sot e tutje ato gjëra që Ti mi ke ndaluar ti kryej!”**

4. Moskryerja e gjërave të ndaluara gjatë kohës që është i veshur me Ihram dhe përkujtimi kohë mbas kohe i Allahut, i kujton myslimanit gjendjen në të cilën ai duhet të jetë përherë.

5. Hyrja në Qabe, e shpallur vend strehimi dhe sigurie për njerëzit, i kujton myslimanit sigurinë që do të ketë në Ditën e Kijametit. Ajo që ia garanton njeriut sigurinë më shumë se çdo gjë tjetër, është besimi i sinqertë në Allahun dhe distancimi i tij nga idhujtaria dhe çdo lloj manifestimi i saj. Allahu (xh. sh.), thotë: ***“Atyre që besuan dhe besimin e tyre nuk e ngatërruan me besim të kotë, u takon të jenë të sigurt, sepse janë në rrugë të drejtë.”*** (Enam, 82.)

6. Akti i puthjes së gurit të zi, që shënon fillimin e kryerjeve të ritualit të haxhit, e përgatit haxhiun për zbatimin e sunetit - traditës së Pejgamberit (a.s.) dhe largimin nga çdo akt që konsiderohet shkelje e parimeve të fesë. Omeri (r.a.), ka thënë në lidhje me puthjen e gurit të zi: “Unë e di se ti nuk je gjë tjetër përveç se një gur, që nuk bën dëm, as dobi dhe nuk do të të puthja kurrë, sikur të mos e kisha parë Pejgamberin (a.s.), duke të puthur.”

7. Pirja e ujit të Zemzemit i kujton njeriut begatinë që Allahu (xh.sh.), ua ka dhuruar njerëzve, ujin të cilin miliona njerëz e pinë prej mijëra vitesh dhe ende nuk është sosur.

8. Qëndrimi në Arafat i kujton njeriut grumbullimin e madh të njerëzve në një vend në Ditën e Tubimit, kur ata do të dalin përpara Allahut (xh.sh.).

9. Therja e Kurbanit i kujton njeriut ndodhinë historike të Ibrahimit me Ismailin (a.s.), i cili qe i gatshëm për ta flijuar të birin, Ismailin. Kjo na tregon se kur e lyp nevoja madhore, njeriu nuk duhet të tregohet i plogësht duke mos zbatuar urdhrin e Allahut. Kjo ngjarje historike i mëson njeriut gatishmërinë që duhet të ketë ai për t’iu përgjigjur urdhrave të Allahut (xh.sh.), ashtu siç bëri edhe Ismaili (a.s.), kur tha:

“Babai im, vepro atë që të është urdhëruar, se do të shohësh që unë kam për të duruar, nëse do Allahu!”
(Saffat, 102)

10. Kur haxhiu kthehet në shtëpi dhe takohet me familjen e tij duke u gëzuar pa masë, në këto momente i kujtohet gëzimi i madh që do të ketë, kur do të takohet me ta në Xhenet. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: “... Shpërblimi i vetëm që do të marrë myslimani, nëse haxhi që ka kryer është i pranueshëm tek Allahu (xh.sh.), është Xheneti.” (Buhari, Myslim).



Një raport sekret i vitit 1891 në lidhje me lëvizjen kombëtare shqiptare

Raporti sekret është hartuar nga llogaritari i Karahisarit lindor, Sejti Mehmet Emini, i cili të dhënat i ka mësuar nga goja e kajmekamit të Sushehrit (qytet në Turqinë veriore afër zonës së Trabzonit), Nevzat beut. Raporti ruhet në Arkivin osman të Kryeministrit në Stamboll (BOA) nën kodin Y.PRK.ML 12/15, 1308 Sh 26/6 prill 1891)

Nevzat beu, ishte një shqiptar që rridhte nga familjet me emër të Gjirokastrës, i diplomuar në Shkollën e Nëpunësve Civilë (Mektebi Mylkije), institucioni më i lartë arsimor për përgatitjen e nëpunësve burokratë osmanë në fundin e shekullit XIX.

Raportuesi i informacionit sekret Sejti Mehmet Emini kishte punuar rreth pesëmbëdhjetë vjet në vilajetin e Janinës. Prezantimi i tij i qe bërë Nevzat beut nga ana e një kadiu shqiptar. Fakti që nëpunësi kishte punuar një kohë jo të shkurtër në toka shqiptare dhe e njihte madje edhe greqishten, e shtynë kajmekamin shqiptar që të krijonte një lidhje të ngushtë me të. Pikërisht edhe nëpunësi turk do të përdorte këtë afinitet të krijuar me qëllim mbledhjen e të dhënave në lidhje me lëvizjen shqiptare.

Dokumenti i përket vitit 1891, pra afërsisht dhjetë vjet pasi Porta e Lartë kishte shtypur me forcë Lidhjen e Prizrenit. Megjithatë, lëvizja shqiptare ende nuk e kishte humbur vitalitetin e saj. Ndonëse për një kohë të gjatë shqiptarët i kishin shërbyer shtetit osman, kundrejt së cilës ata kishin përfituar privilegje ushtarake, administrative dhe ekonomike, duke filluar që nga dekadat e para të shekullit XIX, ishte dukur qartë se perandoria osmane nuk kishte më fuqinë e mëparshme dhe po gjunjëzohej për ditë e më shumë përpara shteteve perëndimore dhe perandorisë ruse. Me marrëveshjen e Londrës të vitit 1833, tashmë ishte e qartë se perandoria osmane, nga një perandori që urdhëronte ishte shndërruar në një perandori që urdhërohej nga palët fitimtare. Ma-

rrëveshja e Londrës do të përmbylej duke krijuar një shtet grek të pavarur, si dhe duke i falur një autonomi të madhe pjesës më të madhe të shteteve sllave në Ballkan, Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë, Moldavisë, Rumanisë. Por ky ishte vetëm fillimi i rënies, i cili nuk vonoi të vinte pas katër dekadash e gjysmë kur në luftën ruso-turke e thyer keqas, të gjitha shtetet e mësipërme nga autonomia fituan pavarësinë.

Fjalët e cituara nga Nevzat beu na ndihmojnë të kuptojmë mënyrën e qasjes së shqiptarëve ndaj lidhjes së Prizrenit në një periudhë të afërt që nga shtypja e saj, figurat e njohura në mesin e shqiptarëve si organizatorët e kësaj lëvizjeje, si dhe botë-kuptimin e shqiptarëve atëherë. Dokumenti merr rëndësi aq më shumë kur në kohët e fundit është ringritur edhe një herë teza sllave dhe ajo greke e hedhur pas viteve 20 të shekullit të njëzetë dhe e përforcuar me studimet e studiuesve të këtyre vendeve dhe të disa vendeve perëndimore, sipas të cilëve shqiptarët ishin aq mbrapa dhe nuk kuptonin se çfarë bëhej përreth tyre, prandaj nuk kërkonin të angazhoheshin në zhvillimet e mëdha të dekadave të para të shekullit të njëzetë, të cilat ndryshuan edhe hartën e Ballkanit.

Këto pretendime të veshura me ambalazh historik kanë synuar përherë dy gjëra. E para, të justifikojnë masakrat e grekëve dhe shqiptarëve në tokat e tyre etnike, pasi ato kryheshin ndaj nënshtetasve të perandorisë që asnjëherë nuk kishin dashur të shkëputeshin prej saj dhe nga ana tjetër, për të shkurajuar shqiptarët në kërkesat e tyre të drejta etnike për të jetuar të lirë dhe të barabartë si gjithë shtetet e tjera të Evropës.

Pas viteve '90 të shekullit të njëzetë, historiografia shqiptare ka mbetur në vend numëro duke mos i çuar më tej studimet dhe hulumtimet historike, por duke u përshtatur më shumë mbi bazat e pragma-

tizmit duke lejuar kështu përhapjen e këtyre ideve edhe në rrethet e studiuesve shqiptarë. Prandaj ky dokument si dhe qindra e mijëra të tjerë, do të ndriçojnë të vërtetën historike.

Në raportin e mësipërm nëpunësi osman nis ta provokojë kajmekamin Nevzat, duke i thënë fjalë të bukura dhe lavdërime në lidhje me Janinën dhe shqiptarët e saj të zgjuar dhe trima. Këto fjalë të bukura duket se e shtynjë kajmekamin që të hapet më shumë dhe t'i tregojë në lidhje me lëvizjen shqiptare të Prizrenit. Mes të tjerash, ai i tregon edhe për Abdyl Frashërin, vëllain e madh të Sami Frashërit:

Abdyl beu ka qenë njeri i mprehtë dhe dinte të mbaronte punë. Për të siguruar të ardhmen e vatanit tonë, ai u pati shfaqur shqiptarëve dëshirën për kryerjen e disa lëvizjeve. Shqiptarët e Janinës e donin pa masë atë, pasi duke qenë edhe deputet i parlamentit osman, u kryente edhe shumë punë dhe u zgjidhte shumë halle, prandaj e përkrahën menjëherë atë. Me qëllim që dëshirat t'i bënte realitet, Abdyl beu shkoi në Evropë. Aty shpenzoi shumë para. Kur gjendej në ishullin e Korfuzit, kabineti grek dëshiroi të bënte disa sakrifica në mënyrë që të fitonin zemrën e shqiptarëve, por qëllimi i vërtetë i shqiptarëve ishte që Shqipëria në të ardhmen të bëhej si Bullgaria, prandaj nuk e pranuan ndihmën financiare që u ofronte Greqia. Pasi kthehet në Janinë, qeveria osmane e arreston Abdyl beun, ndërsa bashkëpunëtorët e tij i syrgjynos. Falë vëllait të tij, Sami beut, Abdyl beu lirohet nga syrgjynosja dhe emërohet anëtar i këshillit të bashkisë së Stambollit.

Gazi Muhtar pasha që dërguar për të verifikuar situatën e Shqipërisë dhe pasi e kreu me sukses këtë detyrë, arriti në përfundimin që Shqipëria dhe shqiptarët kanë nevojë për ndihmë, prandaj edhe u dha fjalën disa shqiptarëve se do t'i mbështeste, në qoftë se ata do të krijonin një organizatë të fshehtë për pavarësinë e Shqipërisë.

Këtë shoqëri e formuan Vaso pasha, mytesarifi aktual i Libanit, Turhan pasha, ambasadori shqiptar në Madrid, Samiu (Frashëri), sekretari i dytë i komisionit për inspektimin ushtarak, vëllai i tij Naimi, kryetari i komisionit që varej nga Ministria e Tregtisë, Ibrahim beu (Temo) doktori i Shkollës së Mjekësisë, Omer efendi nga Narta, babai i Besim beut nga e njëjta

shkollë, Abdyl beu dhe nja dy të tjerë.

Qëllimi i tyre ishte të bashkonin tre vilajete, atë të Manastirit, Shkodrës dhe Janinës dhe qendrën e këtyre tre vilajeteve të caktonin Elbasanin, që ndodhet në qendër të Shqipërisë, e cila nga kaza me punën e bërë nga komiteti në fjalë, u ngrit në rangun e mytesarifllëkut. Aty do të sundonte edhe gazi Muhtar pasha me titullin e valiut të përgjithshëm të Shqipërisë.

Për mësimin e gjuhës shqipe komiteti çeli një shkollë shqipe në Korçë. Librat dhe traktatet që patën përgatitur Naim dhe Sami beu nuk mund të botoheshin lehtësisht këtu në Stamboll, kështu që u vendos që ato të shtypeshin në Rumani nëpërmjet shqiptarëve që gjendeshin aty dhe më pas, të futeshin në tokat shqiptare nëpërmjet doganës së Selanikut me njerëz të posaçëm.

Kur një traktat i vogël në gjuhën shqipe, i përgatitur nga Vaso Pasha, në të cilën shkruante se shqiptarët duhet të bashkoheshin dhe të unifikoheshin dhe në rast nevojë edhe të jepnin jetën për vatanin, ra në dorë të autoriteteve, u ndalua botimi i këtyre gjërave, por sot ende vazhdojnë të botohen në Rumani.

Sami Frashëri ka qenë njeriu besnik dhe i besueshëm i Muhtar pashës. Kunata e tij është e martuar me një bir pashai, i diplomuar me shkallën jyzbashë nga Shkolla e Mjekësisë dhe kanë formuar në Këzëlltoprak të Yskydarit një shoqëri në të cilën ftojnë të gjithë studentët shqiptarë që gjenden aty. Në kuvendimet që bëheshin aty, studentëve u fliste rreth bashkimit dhe unitetit, të cilën nuk ka fuqi njerëzore që do të mund ta mposhtë, por që të arrihet kjo gjë, duhej përpjekje dhe sakrifica të mëdha.

Komiteti ynë nuk pret ndihmë nga asnjë shtet i huaj sot për sot. Shqiptarët janë të gjithë të një mendimi se nuk ia kanë nevojën kujt. Ata vetëm presin ditën që të marrin urdhrin për të shpërthyer dhe janë gati të sakrifkohen për këtë qëllim. Lëvizja e Abdyl beut dhe bashkëpunëtorëve të tij duke dalë haptazi për pavarësi, që një lëvizje e gabuar që i bëri të pendohej. Tashmë planet tona jemi duke i kryer në fshehtësi dhe me mend në kokë, sepse vetëm kështu do të arrijmë të kemi sukses. Vetëm të lutem, ashtu siç m'u betove edhe ti në fjalën e nderit, që këto që të tregova të mos ia thuash ndokujt tjetër.

Arti i Ebrusë

Ebruja është një art dizajnimi mbi sipërfaqen e ujit, në një enë të posaçme, mbi të cilën hidhen bojëra që nuk shkrihen, duke i përzier me limfë bimësh dhe me ndihmën e furçave të përbëra nga qimet e kalit dhe kërcell trëndafili.

Për arsye se mbi letër formohen forma të ngjashme me retë, këtij arti i është vënë emri "ebri", që në persisht do të thotë "si re". Ky art, deri në fillimshkullin XX është njohur me këtë emër dhe me siguri për arsye të praktikitetit në të folur, ka evoluar nga "ebri" në "ebru". Ka prej atyre që thonë se kuptimi i fjalës "ebru" është "vetull", për arsye se në këtë art, heraherës krijohen forma të ngjashme me vetullën. Disa të tjerë mendojnë se emri i këtij arti rrjedh po nga persishtja, nga fjala "ab-ruj", që do të thotë "sipërfaqja e ujit". Kurse Sami Frashëri, lidhur me etimologjinë dhe kuptimin e kësaj fjale, në *Kamus-i Turki*, ka bërë këtë shpjegim:

Fjala "ebru" rrjedh nga fjala "ebri", që në persisht ka kuptimin e ngjyrës së resë. Megjithatë, etimologjia e fjalës "ebru" është "roba" në gjuhën jagatai, që do të thotë "ana e dukshme e rrobës dhe e pellushit". Ebru është një pëlhurë apo letër, sipërfaqja e së cilës ka pamje të valëzuar apo me damarë, porsimermeri. Ebru është një letër me ngjyrë që përdoret për të bërë kopertinën e një defteri apo fashikujve.

Me siguri, duke u nisur nga ngjashmëria që ka pamja e sipërfaqes së letrave, mbi të cilat bëhet ebruja, që ka përmendur edhe Sami Frashëri, perëndimorët, artit të ebrusë i thonë "marble paper", "paper marbling" apo "marbled paper", që janë në kuptimin e letrës së mermertë. Kurse në botën arabe, ky art është quajtur: "varakul-muxhezza" (letër me damarë).

MJETET E EBRUSË

Tekne

Tekne-ja, ena e ebrusë është afërsisht 1 – 2 cm më e madhe se letra mbi të cilën do të bëhet ebruja. Zakonisht kjo enë është me përmasa 35cm x 50cm dhe 5 – 6 cm e thellë, me një llamarinë të galvanizuar ose prej çeliku që nuk bën ndryshk.

Kitre

Nuk bëhet ebru me ujë të thjeshtë. Për të mos u shkrire boja që hidhet dhe për të qëndruar dizajnimet që formohen mbi ujë, uji përzihet me solucione të veçanta, si pluhuri i shkurreve që mblidhen në vende malore ku nuk ka shumë reshje. Pikërisht kjo lloj shkurreje, që e bën të veçantë ujin e ebrusë, quhet *kitre* dhe ka një procedurë të caktuar përdorimi.

Bojërat

Në ebru janë përdorur pigmente të cilësive të ndryshme. Në ebrunë tradicionale përdoret lahuri me bazë bimore, okside dhe ultramarinë të hekurit, si dhe një sërë pigmentesh, që kanë procedurë të caktuar përpunimi. Duke hedhur një lëng që nxirret nga një gjëndërr e kafshëve të trasha, bën që boja të bëhet edhe më e përshtatshme që të punohet me dizajtime mbi të. Pra, në ebru nuk përdoren bojëra vaji as analine që shkrihen në ujë, por bojëra që nuk shkrihen, me origjinë bimore dhe dheu që nxirren nga dheu dhe shkëmbinjtë me ngjyrë.

Në bojëra përdoret po ashtu edhe naftë natyrore. Kjo lëndë ndikon që të bëhen figura tredimensionale dhe të rumbullakëta mbi ujë.

Në ebru përdoren furça të përbëra nga qimet e kalit dhe



nga kërcelli i trëndafilit. Gjithashtu, përdoret edhe krehër i veçantë, biz, desteseng (mjet përpunues i bojës), limfë bimësh, ujë, masë viskoze, letra të përpunuara enkas për ebru, myhre (mjet që përdoret për të presuar) dhe disa materiale të tjera.

Ebruja, arti i dhikrit vizual

Tekneja e ebrusë është si një libërth i gjithësisë. Për ata që dinë të lexojnë, mbi sipërfaqen e teknesë gjithnjë shfaqen kuptime të thella dhe manifestime të pashoqe për të kuptuar të fshehtën e qenies.

Arti i ebrusë, sadoqë krijohet përmes ligjeve të shkencave ekzakte, si fizikë e kimi, dinamikat shpirtërore ndihen dukshëm mbi sipërfaqen e teknesë. Shpeshherë gjendja shpirtërore e mjeshtrit të ebrusë vërehet qartazi në artin e ebrusë. Kur artisti është i dëshpëruar, vështirë se mund të dalë një ebru e bukur.

Tashmë është vërtetuar shkencërisht se molekulat e ujit janë të ndjeshme ndaj energjive që përcjell muzikaliteti i gjërave apo gjendja shpirtërore e njeriut. Kur dëgjoen tinguj të këndshëm, molekulat bëjnë lëvizje të harmonizuar dhe brenda një rendi të caktuar, kurse kur dëgjoen muzikë e rëndë dhe shqetësuese, molekulat bëjnë lëvizje të pasistemuar dhe pa ritëm. Ndaj, mjeshtrit e mëdhenj të ebrusë, para se të nisin të bëjnë ebru, largojnë nga mendja çdo mendim apo ndjenjë negative. Madje, për të arritur këtë, artistët e ebrusë trajnojnë studentët e tyre me metoda se si mund të largojnë energjitë negative dhe sesi mund të përqendrohen. Kështu, është bërë e traditës tashmë *“lutja e artistit të ebrusë”*, të cilën artisti i ebrusë e bën para se të nisë të bëjë një ebru. Një lutje e veçantë kjo, që fillon me marrjen gusul dhe pastaj i drejtohet Krijuesit dhe Artistit të vërtetë; Allahut të Madhëruar, me një lutje përmes disa *emrave të bukur (esmaul-husna)*, të cilët po ashtu janë vërtetuar kohët e fundit nga shkencëtari japonez Dr. Masaru Emoto për energjitë pozitive që shpërndajnë.

Sipas konceptit islam, nuk ka përsëritje në manifestimet hyjnore. **“...Ai është në veprim në çdo çast.”** – thotë Kurani (err-Rrahman, 29.). Po ashtu, edhe në ebru nuk ka përsëritje. Një artist i ebrusë, nuk mund ta bëjë dy herë të njëjtën ebru, megjithëse përdor të njëjtat mjete dhe të njëjtat bojëra. Vetëm të ngjashmen mund ta bëjë. Ndaj dhe çdo vepër ebruje, është një vepër e pashoqe, e cila

nuk mund të përsëritet.

Një artist i ebrusë, kur merr furçën në dorë, për të spërkatur bojën mbi sipërfaqe, dorës tjetër i bie me furçë në vendin e zemrës. Thuajse bojrat i shpërndan nga zemra.

“Arti i ebrusë është ashtu siç është jeta jonë. Ashtu si njerëzit që lënë gjurmë me gabimet e tyre edhe pasi falen, ashtu dhe në ebru kemi gjurmë” -thotë mjeshtri i ebrusë Ahmet Akgyn në një intervistë të bërë nga një e përditshme shqiptare. (Anila Dushi, *Ebruja, arti që lë gjurmë*, Shekulli, 19 Qershor 2012)

Kur bën ebru, njëkohësisht edukohesh me virtyte të rëndësishme; si durimi, kontrolli i egos, meditimi mbi të vërtetën e krijimit dhe mbi të qenit ekuilibruar në jetë. Edukimi mbi arte të tilla të islamit, ka ndihmuar gjithmonë njeriun që të bëjë *sejri-sulukun* (procesin e edukimit spiritual sipas mistikës islame).

Ebruja është arti i ekuilibrit. Ekuilibër në sipërfaqe, ekuilibër në rënie e furçës, ekuilibër në masën e bojërave, ekuilibër në dorë, ekuilibër në shpirt. Ekuilibri në teknenë e ebrusë, është manifestimi i ekuilibrit kozmik.

Ebruja është arti i ritmit. Rënia e furçës ka një ritëm të caktuar. Një student i ebrusë, fillimisht i duhet të kapë ritmin e rënies së furçës, ndaj dhe për një kohë ai trajnohet mbi ritmin. Në momentin kur mëson ritmin e rënies së furçës, njëkohësisht ai ka mësuar edhe ritmin e jetës.

Ebruja është arti i durimit. Kushti i parë i këtij arti është durimi. Durimi është një vlerë e njeriut, që Zoti shpeshherë ia vë në dukje njeriut në Kuran. Nuk bëhet art pa pasur durim. Durimi është një ndjenjë që mund të zhvillohet, që mund të edukohet. Arti në përgjithësi dhe ebruja në veçanti, jep një kontribut të veçantë për zhvillimin e kësaj ndjenje. Ai që dëshiron të mësojë ebru, kalon përmes edukimit mbi durimin, qëndrueshmërinë dhe përkushtimin.

Lidhja shpirtërore e studentit me mjeshtrin e ebrusë është një tjetër pikë e rëndësishme në artin e ebrusë. Studenti i ebrusë ka një marrëdhënie të veçantë shpirtërore me mjeshtrin e ebrusë, pasi pa këtë raport frymëzues, ai nuk mund të bëhet artist i mirë i ebrusë. (Për më gjerë, rreth artit të ebrusë, shih.: O. Faruk Dere, *Ebru Sanati*, Istanbul, (Botim i Kryebashkisë së Stambollit)



Historia e dheut si dhe shtim'i njerzsis bashkë me ligjet Hyjnore

Për me u bazue mbi gjendjen e Perendis, më parë duhet të marrim para sysh krijimin e gjithësisë, e cilla nuk është tjetër gjë veç se një vepër e Perendis që e krijoj për me treguë fuqinë e tij,

Sikurse thotë Perendija me një "Hadithë Kudsie":

"Unë qesh një thesarë (hazine) e msheft por desha të tregoj njësinë t'ime, prandëj krijova njerzinë".

Por më parë se të krijonte njerinë i duhesh të pregatite vendin ku do të banonte ajo vepër e Perendis.

E për këtë shkak krijoj gjithësinë, e cilla kaloj ndër mjet të shumë metamorfozave.

Dheu në të cillën banojmë në ishte një lamsh i Zjarrt edhe i formuëm me shumë landë djegse, por masandaj tue u ftofë lamshi i dheut toka zûe me vue një përcipje pak a shumë të fortë; por nuk ishte e mundun jetimi për mbi të, pse ajri i atëhershëm ishte i nëxehët dhe i helmueshem, nga shkak se ishte përzie me landë tjera të helmushme. Na mund të thomi dhe cipa e dheut ku jetojmë në është e pa qindrushme dhe é vertetojmë nga lëkundjet e mëdha të vullkanëve tue humbë edhe dhenë. Cipa e dheut në fillim të formimit të historisë mund të thomi se ka qenë tepër e butë, por tue kalue koha zû qi të forcohet dhe pak nga pak zû qi të largohet prej qendrës së dheut, e cila i epte gjith lëkundjet e dheut sa më ftofesh aq e voglonte vullimin. Por kur cipa filloj me u forcue edhe më atëherë nuk e mbajtën ekuilibrimin ndër mjet të tyne, por toka e vogloj vullimin shumë e për këtë shkakë, u ça, dhe prej ksa shofim gjithë këto gërmadha, fusha, kodra, male në sipërfaqen e dheut të cilat formojnë ashpërimin e saj.

Ndermejt të cipës së dheut nuk shkaktoheshin lëkundje të vogla si termete, por lëkundje të mëdhaja qi tue ça token qisnin jashtë shumë gjana si <<llavën>> e me anën e ksaj mblonte tanë dheun. Gjith këto ngjarje

janë për tu pemendë se historiant thonë në kjo koha janë formue shumë gur si <<graniti>> pofiri etj.

Mund të thomi se toka nuk mund të ketë vëjtë vetëm prej lëkundjeve, por edhe prej shinave të cilat binin pa pushim tue formue rrëfeja, gërmadha, gëreshin shkëmbejt më të mëdhaj prej të cilvet është formue toka e posaçme, fryjshin erna të forta dhe i rrembejshin shkëmbejt e mëdhej prej një vendi e i shpijshin në një vend tjetër, mbasandaj kjo shkeme janë mbluë nën dhe edhe mbetën në të, qi sot shumë herë tue gërmue tokën gjemë të tillë shkembe të mëdhej. Të gjith shtresat qi janë në dhe janë vumun njëni përmbi tjetrën pal pal, ato qi janë primitive janë vue poshtë e ato qi janë të reja janë vue sipër. Kët gjë mund t'a vertetojmë me këtë mënyrë: të hapim një pus në dhe aty kû përcipja ka rëjt orizantelitatin e vet, dhe nuk është trazue me tjetër gjë as nga ujnat e as nga lëkundjet e vullkanëve. Nuk vanoj shumë kohë thohet se kjo lëkundje heshten e toka ra në qetsi, pra në at kohë ka ranë krypa në fund të detit e kjo është ajo krypa bardhë qi gjindet në det, u-formuë teleshiri prej rreshtave të shtazve mikroskopike. Në ket kohë u gjindën disa skelete shtazësh të tmershme qi jetoshin at-herë si dhe trupa rëshqansore, flutarake, notore e shumë tjera me forma të çuditëshme me 20 metra gjatsi. Por mbassi u bënë gjith kjo rradhime me një kohë, atëherë u dukën si mbas historijavet dheake, malet Përenej e Alpet dhe në ket kohë u duk fizionomija (pamja) pak nga pak dhe i afrohet kësaj pamjes së soçme, temperatyra qi ishte tepër e njetë filloj me u ftofë nga pak, por jo me këtë temperatyren e soçme se hurmat në at kohë piqeshin edhe në Angli, por tashti nuk bahen më veç se në Ekuatorë. Atëherë bënë ballë sisoret mëdha prej të cillavet kanë rrjedhë sisoret e soçme ishik edhe disa kafsh të tmerrshme si Qinaqeri Torpiri, Meshandentet e mëdha; bashkë me shtresat e posaçme u-çfaqën edhe shëjat e para të gjanavet

organike si shtazët e bimët.

Pra kuptohet se jeta është shumë e veçtë mbi dhë, po me gjithë këtë nuk dihet se kur filloj jeta në këtë tokë e në detë, Atmosfera të pastrohet. Mbetjet e para të shtazvet i gjejmë tue gërmuë tokën felle nder dena të ndryshme. Këto lypsen për me ndaluë njena prej tjetrës dhe me gjetun moshën e tyne. Kta fesile i rujnë ndëpër muzeumet të H. Natyrë, për anë disa mostra gursht t'atyne kohnave.

Nder disa historia thohet se jeta përherë të parë filloj në detë, masandej kur temperatura u bënë e butë dhe e ngroftë u duk ndëpër vendet moçale se filloj gjelbrim i madhë si kundër gjindet edhe sot në brezin e ngroftë. Por edhe ket herë nuk ndejti toka me qetësi, se filluën prap lëkundjet të mëdha ku plasi dhe qiti jashtë llavën, e cila mbuloj gjylberimin e moçalet vet si: drutë, bimët e ma fort hurmat. Këta bime masandej filluën të zbërthehen me ngadalë, e jo plotsishsi drunat thëngjillzuëme. Këta druna të thëngjillzuëme formojnë sot tokën me thëngjillë guri.

Këjo plavë zue qi të forcohet dhe u ba e mirë për jetesën e njeriut. Prandaj i Madhi perendi për ta çue qellimin e vet krijoi njerin, të cilin e qujti Adem dhe pranë tij krijoi të shoqen e Ademit Havan (Evën). Kta janë prindërit e racës së njeriut qi këta të dy organizuën familjen e parë të njerzisë në kohë të këtyne kish vetëm një gjuhë, e cila sa asht mësuë nga Perendija, por mënyra se si u-është mësuë nuk dihet. Disa historikjan thonë se ktyne u-është dhanë shpirtnisht si mbas gjänvet qi panë.

Puna e Profetit të parë që me njisue e me njoftë një Zot e m'u mbëlue qi të mos me ndejë si shtazët, e mos me marrë për grue të motrën qi kishin lë për-njihërë, se në këtë kohë lejnë çift e çift, e kto ishin detyrat e Profetit të parë e smundëte me i detyruë me ardhna të tjera sa do qi ai vetë i dinte, për njerzija nuk kishin arrë në gjendjen e dukër.

Por mbas pak kohësh njerzija u shumue e zuen të bëjnë hapa nga përparimi edhe prandaj nuk i mjafton te ai ligjë hyjnorë e i duhesh një profet tjetër, qi ky profet do të dergohesh me ligjë Hyjnore më të gjanë e më të plotsume dhe detyrat e këti profeti do të ishin: të ndalonte gjithë ato kafshë qi nuk vishin me i hangër e të ziheshin gjithë ato kafshë qi ishin të mira për ushqim edhe për me u marrë me tregti e buqsi e të formojin familje dhe vllaznina të vërteta.

Gjithë ashtu kur duel trupi i shejtë trupi i H. Isajt njerzija ishte shumë në të gjitha anët e botës, të cilvet i'u lypete një ligjë hyjnore tjerë, Unjilli, qi ndër kohnat e këtij Profeti kishte bënë hapa të mdhaja nga kultura e kishte mjaftë ndryshim nga kohnat e për-

parshme; pra këto janë plotsuë si mbas kohës. Mbas të ngrejtmen të trupit të shejt të së H. Isajtë populli në vend qi të marrin e dukat të mira u këthye nga të këqijat. E për me i prue kta në edukatën e përparshme, Perëndijadergoiti statutin Hyjnorë të përgjithmonshëm (Kur-ani Qerim) tue dërgue të dashmin e Tij, të Madhin Muhamed si një rrëfë e jashtë zakonshëm e ja përgatiti rrugën e mbarë qi i duhesh njeriut me e ndjekë sa të jetë gjallë.

Kët Zotni kaqë të madh. Perendija shpirtmisht e kishte krijuë, para se me v'u në veprim punimin e gjithësisë dhe ishte ati i tyne dhe kur u krijuën shpirtinat, ky ishte krijuë para tyne, sadoqi dulën për para tij trupa, ose ma mirë me thanë disa njerz. Në kohën kur gjithësinë e kishte mbulue errësina e trashë gjumi i randë, mjerimi i zi, I Madhi Perendi tue pa me përballëgjim njerzin i erdhi keq me e bënë padritë, prandej dërgoj të dashmin e tij të Madhin Muhamed. Jeta e kti zotni kaq i ndershem nuk mund të kallzohet se duhën me mbushë 10 ose 15 vollyme e jo fletë karte. Po na do të marrim disa pak njoftime mbi jetën: Ky burrë leu në Kantinentin e Afrikës në Meqqe, 572 vjet pas H. Isasë. Emni i tij ish i ndegjuër në Zebur, Teurat, dhe n'Inxhil. Ky tue qenë i vogël, shpalli disa mbrekullina qi bëni të habitun gjithë njerzit e atëhershëm. Edhe u rrit i pa prind, si dhe nga ato qi nuk muj i me marrë as një edukatë, por edhe nuk mundi qi të vazhdonte në shkollë. Mësimet e para i mori nga i Madhi Perendi. H. Muhamedi nuk u dërguë vetëm, por pati edhe statutin Hyjnuër (Kur-ani Qerimin) qi Perendija ja zbriti (Ajet Ajet) frazë si mbas nevojës së kohës.

Ky ish i vetmi qi mundi për një kohë fare të pakët të siellni një përparim një edukatë, në të gjithë botën Trupi i këti Zotni ish aq i hishëm sa nuk mund t'i sjellim shëmbëll. Shguli gjithë shtyllat e kalbëta të fenavet të ndryshme dhe nguli shtyllat e reja të fesës së vërtetë.

Gjithë ku shkoj i porositte qi të përpqeshin në ditunin dhe të mundeshin të bëjnë ç'do qi mëndja ë tyne ishte e zoja me e shpik. Përparimet qi mori Arabija, me lindjen e këti mund të thomi se kanë pasë ari në kulmin ma të parë të botës, së atëhershme. Vetëm ky nuk e pengoj nga ç'do punë të mirë qi mund të sillte nderë e përparim.

Qëllimet t'ona nuk janë tjetër gjë veçse një jetshkrim i krijimit botës nga Perendija dhe si u bënë dhe tu para qitë se qëllimi i jonë drejtohet nga udha e përparimi e dukatës tue shpresue ke i madhi Perendi qi udhtimi i jonë do të dali për së shpejti në dritë, por tue pritun ndihmen e gjithë Shqyptarve vllazen.

Nga Studentat e M. Nalte


I KULLA, I. HIMA

Marrë nga revista "Zani i Nalte" faqja 120

Shkencëtarët zbulojnë 80% të ADN-së

Për herë të parë shkencëtarët kanë publikuar analizën me të hollësishme të ADN-së së njeriut, e cila zbardh 80% të funksioneve të gjeneve. Grupi i shkencëtarëve ka analizuar tre miliard gjenet që përbëjnë ADN-në dhe deri tani ka arritur të kuptojë në detaje funksionin e tre milion gjeneve dhe atyre që cilësoheshin "JUNK DNA", të cilat nuk dihej se çfarë roli kishin. Kjo arritje e madhe shkencore në fushën e mjekësisë, do të bëjë që të kuptohet akoma më shumë biologjia e njeriut. Shumë prej këtyre zbulimeve do të ndihmojnë mjekët në nxjerrjen e diagnozave më të mira për sëmundjet e zemrës, diabetit apo dhe sëmundjeve

nervore. Në projektin "Enikode" të nisur në vitin 2003, kanë marrë pjesë më shumë se 400 mjekë të Britanisë, SHBA-së, Spanjës, Singaporit dhe Japonisë. Kanë qenë këta mjekë, të cilët janë marrë me zërthimin e ADN-së.



Sa të vetëdijshëm jemi në përdorimin e mjeteve të pastrimit!?



Mjetet e pastrimit dhe kujdesit personal kanë përbërës kimikë, emrat e të cilëve mezi i lexojmë mbrapa ambalazhit dhe nuk e dimë se cili është qëllimi i tyre. Ajo çka është e përbashkët për shumicën e këtyre përbërësve, është që ata nuk janë natyralë dhe ndotin natyrën e helmojnë njerëzit.

Askush nuk mendon më se si gjyshet tona dikur i kanë mbajtur shtëpitë dhe ambientet e pastra. Ato përdornin përbërës si uthullën, alkoolin, sodën e bukës, acidin citrik dhe kripën. Sot, në internet mund të gjejmë shumë receta se si të përzihen mjetet personale për pastrim, të cilat janë jotosike, të lira dhe që me siguri i kemi në kuzhinë.

Uthulla është e njohur si dezinfektuese, sepse ngadalëson rritjen dhe vret mikroorganizmat, është largues i shkëlqyeshëm i yndyrës, frenon rritjen e mykut dhe shkrin shtresat minerale të krijuara nga uji. Alkooli (70%) është antiseptik i njohur për dezinfektimin e lëkurës, i cili vret edhe bakteriet e zakonshme në shtëpi. Soda e bukës është lehtësisht abrazive dhe e njohur si mjet për zbutjen e ujit të fortë, ndihmon gjatë pastrimit të gypave (në kombinim me uthullën) dhe është zbardhues i lehtë i rrobave të bardha.

Acidi citrik vret bakteriet, por është edhe largues i shkëlqyer i yndyrës. Zakonisht përdoret për dezinfektimin e dërrasave për prerje në kuzhinë, për pastrimin e tualeteve dhe si një nga komponentët për përgatitjen e detergjentit tuaj për makinën larëse të enëve, por është edhe shtëse e shkëlqyeshme e detergjentit për larjen e rrobave, i cili parandalon zbehjen e ngjyrave. Kripa e jodizuar vret bakteriet dhe kërpudhat në sipërfaqet, siç janë dushet, lavamanët, sfungjerët në kuzhinë.

Përkundër përbërësve natyrorë, të cilëve shkenca nuk u është përkushtuar sa duhet, pasojat e veprimit të përbërësve kimikë shkencëtarët i dinë shumë mirë. Kana-

daja në vitin 1999 e ka shpallur "formaldehidin" kimikat toksik, por ai ende përdoret në mjetet për kujdesin e lëkurës së fëmijëve dhe të të rriturve edhe sot. P.sh., përdorimi i Neutrogenit, Johnsonand Johnson Baby dhe Cleanand Clear në Evropë është ndaluar në disa raste, ndërsa agjencitë ndërkombëtare për hulumtim të kancerit e quajnë kancerogjen. Por ky kimikat nuk është i vetëm. Edhe "dioksina" 1,4 po ashtu, është kancerogjen, ndërsa të dy kimikatet lirohen nga konservantet që gjenden në produkte. Aty futen dhe "ftalatet" që gjenden në ambalazhin plastik, konservantet e njohura me emrin "parabene", përbërësit që japin aroma dhe "triclosani" (në sapunët antibakterialë, pastat për dhëmbë dhe ujërat për shpëlarjen e gojës) – të gjitha kimikate që shkatërrojnë sistemin endokrin të njerëzve.

Tretja "Stoddard", "naftalina" dhe "morfolina" konsiderohen tretje të rrezikshme, ndërsa materialet e kloruara mund të formojnë kompozime organike të klorit, që mund të ruhen në qelizat e yndyrave, përmes të cilave mund të hyjnë edhe në qumështin e nënës.

"Butilglikoli" për shembull, gjendet në shumicën e preparateve për larjen e dritareve, furrave, largimin e njollave, freskimin e hapësirave, pastrimin e tapeteve, ndërsa konsiderohet jashtëzakonisht helmues. Shumë nga përbërësit e përmendur janë neuro helme të cilat reduktojnë punën e sistemit qendror nervor, ndërsa mund të shkaktojnë dhimbje të kokës, mungesë të përqendrimit, hutim dhe simptoma të sëmundjeve mentale. Megjithatë, vetëm këtë vit, ministria amerikane e shëndetit dhe e mirëqenies sociale e ka vënë "formaldehidin" në listën e vet të shkaktarëve të njohur të kancerit tek njerëzit. Trembëdhjetë vjet më vonë se Kanada.


Megjithatë, edhe prodhuesit e mëdhenj kanë filluar të ndërrojnë përbërësit e produkteve të veta. Kështu "Johnsonand Johnson" ka thënë që do t'i largojë të gjithë kimikatet e dëmshme nga produktet për fëmijë deri në vitin 2013, ndërsa nga të gjitha produktet e tjera për kujdes personal deri në vitin 2015.

Dylbitë për të diktuar kërcënime të mundshme

Dylbitë e reja për fushën e betejës do t'i lejojnë ushtarët të përcaktojnë veprimtarinë armiqësore nga disa kilometra larg, duke përdorur mendimet e tyre të ndërgjegjes në lidhje me një kompjuter.

Pasi kanë qenë nën zhvillim e sipër nga Agjencia e Projekteve të Përparuara të Mbrojtjes (DARPA) që nga viti 2007, Sistemi i Teknologjisë së Paralajmërimit të Hershëm (CT2WS) – me nofkën "Dylbitë e Luke Skywalker-it", sipas dylbive të përdorura në filmin "Star Wars"- lexojnë valët e trurit me anë të një aparature, që përdoret nga ushtarët. Një kompjuter skanon një fushë 120 shkallë dhe dërgon imazhe të kërcënimeve të mundshme në kompjuter për t'u shqyrtuar nga ushtarët. Kur shikojnë imazhet, sistemi monitoron valët e trurit P-300, që tregon njohjen. Edhe në qoftë se ushtarët nuk e kuptojnë atë, truri i tyre mund t'i identifikojë objektivat në heshtje dhe sistemi mund ta kapë atë.

DARPA thotë se sistemi CT2WS ka mundur të kapë 91%



të kërcënimeve në testimin e tij. Për më tepër, agjencia njofton se sistemi ka parandaluar alarmet e rremë.

Tani që dylbitë kanë vërtetuar të jenë efektive, teknologjia është dorëzuar në Laboratorin e Ushtrisë për Pajisjet e Natës për zhvillim të mëtejshëm. Me këtë teknologji, kamerat e ardhshme dixhitale do të inkorporojnë teknologjinë për kapjen e momenteve të përsosura edhe duke menduar për të (pavetëdije).



Avatarët robotë kanë bërë një hap më afër të qenit "dopiot" e botës reale për të paralizuarit ose për ata me sindromën e kyçjes (locked-in syndrome).

Shkencëtarët kanë krijuar një lëvizje robotike në emër të një njeriu duke monitoruar mendimet rreth lëvizjeve,

Roboti Avatar

bën me dije New Scientist. Lidhja njeri-makineri bashkoi një person në një skaner truri në Izrael dhe një robot që vërtitej në një laborator në Francë. Personi që kontrollonte robotin mund të shihte përmes syve të surrogatit të tij elektronik. Kërkuesit tani po punojnë për të gjetur mënyrat e duhura për ta bërë më të ndjeshme lidhjen njeri-makineri dhe për t'i lejuar njerëzit të flasin përmes robotit. Projekti kërkimor lidhi një robot me një njeri pasi skanoi trurin e tij duke përdorur FMRI (Functional Magnetic Resonance Imaging). Kjo monitoron rrjedhjen e gjakut në tru dhe mund të dallojë kur zonat janë të shoqëruara me veprime të caktuara, siç janë lëvizjet. Përfundimi, raportuar në revistë, ishte se ai mund të kontrollonte robotin thuajse në kohë reale.

Virusi "Flame": Punë e ShBA-së dhe Izraelit

"Flame" dhe "Stuxnet", janë dy nga viruset më shkatërrimtarë kompjuterikë që janë krijuar ndonjëherë, të bëra posaçërisht për spiunazh kibernetik dhe të aftë për të shkaktuar kërdi në sistemet qeveritare.

Si Flame ashtu edhe Stuxnet janë përdorur nga qeveria amerikane për të bërë luftë kibernetike kundër regjimeve armiqësore. Gazeta e njohur Washington Post citon disa zyrtarë perëndimorë, se SHBA-ja dhe Izraeli kanë zhvilluar bashkërisht virusin Flame, që mbledhi të dhëna për të ndihmuar në ngadalësimin e programit bërthamor të Iranit.

Virusi i ashtuquajtur "Flaka" ka synuar të infektojë rrjetet kompjuterike të Iranit dhe të monitorojë kompjuterët e zyrtarëve iranianë, ka shkruar gazeta. Fushata kibernetike kundër programit bërthamor të Iranit ka përfshirë përdorimin e një virusi tjetër të quajtur Stuxnet, i cili shkaktoi keqfunksionime në pajisjet e pasurimit të uraniumit. "Flaka" është virusi më i ndërlukuar spiun i zbuluar ndonjëherë. Virusit shkatërrimtar Stuxnet besohet të ketë dëmtuar programin nuklear të Iranit në 2010.

Egjipti së shpejti do të njohë shtetin e Kosovës

Pas vizitës së fundit të delegacionit parlamentar të Kosovës, të udhëhequr nga krye parlamenti Jakup Krasniqi dhe vizitave e aktiviteteve të ministrit të Jashtëm të Kosovës, Enver Hoxhaj, për shpejtimin e njohjes nga Egjipti, udhëheqësit e këtij shteti paralajmërojnë njohjen e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur.

Kryetari i Dhomës së Lartë të Parlamentit egjiptian, Ahmed Fahmy, ka deklaruar për gazetën egjiptiane se Egjipti pas Revolucionit të 25 janarit ndryshon nga ai që ka qenë më parë lidhur me shumë çështje botërore. Ai ka theksuar se Dhoma e Lartë e Parlamentit egjiptian, si institucion i zgjedhur nga populli egjiptian, mbështet pavarësinë e Kosovës, duke shprehur simpatinë e plotë të Egjiptit me popullin e Kosovës.

Fahmy ka konfirmuar rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në fushën kulturore e ekonomike, duke shprehur bindjen se qeveria e re egjiptiane, për dallim nga politika e qeverisë së para 25 janarit, do të marrë shumë shpejt vendimin për njohjen e Kosovës.

Ndërsa, Hossam Ghariani, kryetar i Këshillit për të Drejtat e Njeriut dhe kryetar i Asamblesë Kushtetuese, që do të hartojë Kushtetutën e re të Egjiptit, ka shfaqur shpresën se Kosova shumë shpejt do të jetë anëtare në OKB-së. "Kjo do të jetë shtysë e madhe për zhvillimin e mëtejshëm të Kosovës dhe realizmin e ambicieve të popullit kosovar, i cili ka lidhje të ngushta historike e vëllazërore me popullin egjiptian".

Vendet e Ballkanit: Përpjekje për daljen nga stanjacioni

Ekonomia, në kohët e fundit, është një nga temat, për të cilët liderët e vendeve të Ballkanit shpenzojnë më tepër kohë. Pothuajse të gjitha vendet e Ballkanit kërkojnë rrugët për të shpëtuar nga kriza dhe stanjacioni ekonomik që po përjetohet vitet e fundit. Ndër objektivat themelore që mundohen të arrijnë të gjitha vendet e Ballkanit, janë përmirësimi i kapacitetit të prodhimit dhe krijimi i vendeve të punës që varet nga ky kapacitet. Por në rajon nuk ka një opinion të përbashkët se si mund të arrihet diçka e tillë.

Për sa kohë që vazhdon kriza në Evropë dhe në botë, edhe ndikimi i vendeve të Ballkanit nga kjo krizë ekonomike është i paevitueshëm. Por kriza ekonomike në vendet e Ballkanit, është një problem struktural që e vazhdon ekzistencën në mënyrë të pavarur nga kriza ekonomike globale. Një nga problemet themelore me të cilën përballen shumica e vendeve të Ballkanit në ditët tona, është mos konkurrenca në eksport. Kështu që duke vazhduar gjallërinë e importit, vendet e rajonit vazhdojnë të përballen gjithmonë me deficitin e veprimeve të llogarive të rrjedhshme.

Krahas deficitit të llogarive të rrjedhshme, kur hyn në mes edhe deficitin i prerjeve publike që buron nga shpenzimet publike, përjetohet një problem deficitit të dyfishtë. Dalja nga kriza ekonomike, kërkon lehtësimin e deficitit të dyfishtë.

Para së gjithash, dalja nga kriza ekonomike, krahas përgjegjësisë, vizionit dhe përpjekjeve afatgjata, kërkon konsensusin shoqëror. Ky konsensus, duhet të pranojë të vërtetën se dalja nga kriza ekonomike mund të mos jetë e lehtë dhe e shpejtë, e për më tepër duhet të mbështetet në ndërgjegjen për një të nesërme më të mirë. Sot duhen bërë sakrificime. Krahas kësaj, politikanët në vend që të ndjekin politika që shpëtojnë vetëm ditën, me një botëkuptim që ka si objektive përqindje të rritjes ekonomike në kohë afatgjate, duhet të ndjekin politika ekonomike që i përshtaten të vërtetës së vendit të tyre.

Në vendet e Ballkanit, papunësia, vazhdon të mbesë si problemi më kryesor. Për shembull, në vitin 2011 numri i papunësisë së regjistruar në Kosovë ishte rreth 45%, në Maqedoni, 31%, Bosnje-Hercegovinë 28%, Serbi 24%, Greqi 17%, Kroaci dhe Bullgari 13%, Shqipëri 12% dhe në Malin e Zi rreth 12%. Në vendet e rajonit, vetëm Rumania ishte ajo që e kishte përqindjen e papunësisë vetëm me një shifër, rreth 7%. Përqindjet e

larta të papunësisë në Ballkan, i mbajnë gjithmonë të gjalla tendencat për të emigruar. Duhet bërë e ditur se në vendet e Ballkanit nuk përjetohet vetëm emigrimi i jashtëm, por ka edhe një emigrimi të madh të brendshëm për në kryeqytet.

Vendet e Ballkanit, duhet të përqepen kundër papunësisë duke përmirësuar kushtet e punës me kohë afatgjate dhe të nxisin krijimin e vendeve të punës. Për këtë qëllim, është shumë e rëndësishme që të mbështetet zhvillimi i bizneseve të vogla dhe të mesme. Lufta kundër papunësisë, kërkon edhe reformën në sistemin e arsimit. Sepse sistemi i arsimit duhet të krijojë kapitalin human që mund ti përgjigjet nevojave të tregut. Por për fat të keq, sistemi arsimor që ekziston në shumicën e vendeve të Ballkanit me planin e vjetër qendror, vazhdon të krijojë një ushtri të papunësh të shpëputur nga kërkesat e tregut.

Ndërkohë që nga njëra anë duhen ndjekur politika financiare që reduktojnë deficitin buxhetor, mund të bëhet pyetja se a është e mundur që të nxitet prodhimi dhe krijimi i vendeve të punës? Nëse mundësitë edhe më të vogla në buxhet përdoren në mënyrë racionale, kjo mund të jetë e mundur. Krahas kësaj, mundësitë e burimeve natyrore dhe turizmit që zotërojnë vendet e Ballkanit, mund të rivlerësohen në mënyrë që të sigurohen burime të reja të ardhurash.

Ashtu siç është në shembullin e vendeve të Ballkanit, është bërë pothuajse e detyrueshme nxitja e rritjes së prodhimit në vendet që kanë një forcë konkurruese më të ulët në tregtinë e jashtme dhe në përgjithësi. Nëse në vend të prodhimit do të nixitej kërkesa dhe nëse prodhimi i brendshëm nuk do të mund të përgjigjej, atëherë ky proces do të përfundonte me rritjen e importit. Një gjendje e tillë do të rriste edhe më shumë problemin e deficitit të likuiditeteve të rrjedhshme.

Me rritjen e prodhimit dhe krijimit të vendeve të punës, në rrugë të tërthorta sigurohet edhe rritja e eksportit. Por në vend të përpjekjes për të shitur mallra të lira eksporti me qëllim që të rritet eksporti i vendit, do të ishte më me përfitim nëse kjo realizohet me prodhime konkurruese që mbështeten nga politika novatore. Sigurisht që në të njëjtën kohë, brenda këtij procesi, duhet të vazhdojnë edhe përpjekjet për të tërhequr investitorët e huaj.